



Programi Trajnues 2017

Programi Trajnues 2017

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës me datën 06.12.2016.



Publikuar nga Institut Gjyqësor i Kosovës

© **IGJK 2016**, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar IGJK-së si burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa konfirmimin e IGJK-së.

Tabela e përmbajtjes

Fjala e Kryetarit të Këshillit Drejtues	6
Hyrje	7
Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme	9
Penale	10
1. Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë	10
2. Veprat Penale kundër detyrës zyrtare	11
3. Matja e dënimit	12
4. Zbatimi i masave të fshehta hetimore	13
5. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale	14
6. Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale dhe bashkimi kriminal	15
7. Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve	16
8. Krimet e luftës	17
9. Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrantë	18
10. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale	19
11. Krimi i organizuar	20
12. Fillimi i hetimit dhe procedura penale	21
13. Veprat penale kundër ekonomisë	22
14. Dëshmitaret në procedurën penale	23
15. Hetimi i krimeve financiare	24
16. Urdhërkontrolli	25
17. Aktakuza	26
18. Terrorizmi	27
19. Veprat penale sipas Kodit Doganor	28
20. Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale	29
21. Procedurat alternative	30
22. Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale	31
23. Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor	32
24. Veprat penale kundër jetës dhe trupit	33
25. Parashkrimi	34
26. Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore	35
27. Mundësia hetuese e veçantë	36
28. Mjetet e rregullta juridike dhe bazat e ankesës.....	37
29. Përgjegjësia penale e personave juridik.....	38
Civile	39
30. Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së	39
31. Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve	40
32. Palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë	41
33. Renta, llojet dhe caktimi i saj	42
34. Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës	43
35. Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor	44
36. Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit	45
37. Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë	46
38. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj	47
39. Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj	48
40. Shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar	49
41. Sigurimi i kërkesëpadisë	50
42. Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje	51
43. Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes	52
44. Procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës	53
45. Anulimi i kontratave	54
46. Bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë	55
47. Kompensimi i dëmit jomaterial	56
48. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme	57
49. Procedura e vendosjes sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme	58
Drejtësia për Fëmijë - Lëmia penale	59
50. Masat e Diversitetit	59
51. Dënimet që u shqiptohen të miturve	60
52. Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve	61
53. Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor	62
54. Masat edukative ndaj të miturve	63
55. Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë	64
56. Shqyrtimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturve.....	65

57. Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve.....	66
Drejtësia për Fëmijë - Lëmia Civile	67
58. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror.....	67
59. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare.....	68
60. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre	69
E Drejta Komerciale	70
61. Të drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit.....	70
62. Kontratat në ekonomi.....	71
63. Shoqëritë tregtare.....	72
64. Risitë e Ligjit për Falimentimin.....	73
65. Markat tregtare.....	74
66. Zgjidhja Alternative e Kontesteve.....	75
E Drejta Administrative	76
67. Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për regjistrimin civil.....	76
68. Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civilë të Republikës së Kosovës.....	77
69. Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës.....	78
70. Tryezë e rumbullakët “Trajtimi i dilemave aktuale në Ligjin për Konfliktet Administrative”.....	79
Lëmia e Kundërvajtjes	80
71. Administrimi i provave - parimet udhëheqëse.....	80
72. Aktvendimi dhe arsyetimi ligjor.....	81
73. Personat juridik dhe procedura kundërvajtëse.....	82
74. Kundërvajtjet nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, (neni 4, 5 dhe 16 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike).....	83
75. Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje.....	84
E drejta Kushtetuese	85
76. Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës.....	85
Trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme	86
77. Kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.....	86
78. Procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.....	87
79. Pranueshmëria e kërkesës/ankesës në Dhomën e Posaçme.....	88
80. Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe pronësore në procesin e likuidimit.....	89
81. Procedura për privatizimin e subjekteve nga AKP.....	90
KEDNJ	91
82. Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovë.....	91
83. Neni 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe zbatimi i tij.....	92
84. Neni 10 i Konventës Evropiane.....	93
85. Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin.....	94
E Drejta Ndërkombëtare dhe BE-së	95
86. Zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës.....	95
87. Zbatimi Gjyqësor i Konventës së Arhusit (e drejta në informacion, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi mjedisore).....	96
Kompetenca interdisiplinare	97
88. Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve.....	97
89. Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën penale.....	98
90. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile.....	99
91. Menaxhimi i Rasteve.....	100
92. Menaxhimi i stresit.....	101
Programet e Specializuara	102
93. Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit.....	102
Sesioni I.....	103
Sesioni II.....	103
Sesioni III.....	103
94. Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës.....	104
Sesioni I.....	105
Sesioni II.....	105
95. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetikë.....	106
Sesioni I.....	107
Sesioni II.....	107
Sesioni III.....	107
96. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave.....	108
Sesioni I.....	109
Sesioni II.....	109

PROGRAMI TRAJNUES 2017

Sesioni III	109
Programi Orientues për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit të sapoemëruar	110
97. Programi Orientues për gjyqtarët/prokurorët që emërohen në këto pozita për herë të parë (pasi që kanë përfunduar trajnimet në PTF)	110
98. Programi Orientues për gjyqtarët/prokurorët që emërohen në këto pozita për herë të parë (të cilët nuk kanë ndjekur trajnimet në PTF))	111
99. Gjyqtarët/prokurorët e avancuar nga një nivel në tjetrin dhe/apo që ricaktohen nga një departament në tjetrin si dhe ata që ndërrojnë profilet	111
100. Programi Orientues për Gjyqtarë/ prokurorë nga niveli themelor në atë të Apelit	112
101. Programi Orientues për kategorinë që kalon nga pozita e gjyqtarit në atë të prokurorit dhe anasjelltas	112
102. Programi Orientues për Gjyqtarë/prokurorë nga një departament në tjetrin në kuadër të njëjtit nivel	112
Programi i Trajnimit Fillestar	113
Programi për Hulumtime dhe Publikime	114
103. Hulumtimet	114
104. Publikimet	115
105. Biblioteka	115
Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive	116
106. Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë	117
107. Komunikimi në gjykata dhe prokurori	118
Trajnimet për gjyqtarë porotë	119
108. Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore	119
Trajnimet për menaxhmentin e administratës, dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive	120
109. Menaxhimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive	121
110. Komunikimi i jashtëm dhe i brendshëm	122
111. Menaxhimi i rrjedhës së rasteve	123
112. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor	124
113. Kursi hyrës	125
114. Etika dhe sjellja profesionale	127
115. Menaxhimi i stresit dhe kohës	128
Programi për trajnimin e trajnuesve	129
116. Struktura adekuate e trajnimit	130
117. Avancimi i metodologjisë trajnuese	131
Mësimi në distancë (E – learning)	132

Fjala e Kryetarit të Këshillit Drejtues



Të nderuar profesionist të sistemit, gjyqësor dhe prokurorial,

Pushteti në Republikën e Kosovës është i bazuar në parimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit në mes të tre pushteteve. Pushteti gjyqësor/prokurorial në Kosovë është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat/prokuroritë, në pajtim me Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

Sistemi gjyqësor e prokurorial në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me sfida dhe vështirësi të shumta. Raportet e organizatave vendore e ndërkombëtare nuk janë aq pozitive për sistemin gjyqësor e prokurorial, dhe ndikojnë në vazhdimësi në zbehjen e besimit të publikut në gjyqësor. Ngritja e performancës së gjyqësorit dhe forcimi i sundimit të ligjit, shfaqen si nevoja dhe i kontribuojnë proceseve të rëndësishme në të cilat po kalon vendi.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë dhe nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional, në të gjitha fushat dhe profesionet, veçanërisht në gjyqësor ku bartësit brenda tij, me vendimet e tyre të përditshme në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të konsiderueshme ndikojnë në jetën e qytetarëve të vendit.

Instituti Gjyqësor i Kosovës përmes programeve trajnuese mbështet një aplikim konsistent të ligjit, duke ofruar edukim adekuat dhe mundësi më të mira për t'u siguruar që puna e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë, mund të bëhet në mënyrë efikase dhe me nivelin e duhur të cilësisë. Në këtë drejtim, IGJK, pas një procesi gjithëpërfshirës të nevojave trajnuese, ka hartuar Programin Trajnues për vitin 2017. Programi është dizajnuar në mënyrë që të adresoj nevojat dhe sfidat reale për trajnim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë brenda sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës.

Duke ju falënderuar për kontributin tuaj të çmuar për hartimin e këtij programi, miqësisht kërkoj mbështetjen nga të gjithë ju, për realizimin e suksesshëm të programit trajnues në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm profesional të përfitueseve të tij.

Singerisht,
Ymer Hoxha
Kryetar i Këshillit Drejtues

Hyrje

Mbështetur në kompetencat që i jep Ligji për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (Ligji nr. 02/L-25), IGJK është organ i pavarur, i mandatuar si institucioni kryesor i trajnimit gjyqësor në Kosovë. IGJK është kompetentë për hartimin dhe realizimin e programeve trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionist brenda sistemit gjyqësor e prokurorial, si dhe kryen veprimtari të tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet evropiane.

IGJK harton një program trajnues gjithëpërfshirës në baza vjetore dhe fokusohet në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe kompetencës interdisiplinare. Hartimit të programit trajnues i paraprinë një proces gjithëpërfshirës i nevojave trajnuese, ku janë të përfshirë akterë të shumtë me qëllim që programi të reflektoj nevojat sa më reale për trajnim gjyqësor.

Programi i trajnimeve për vitin 2017 përmban aktivitetet që IGJK do të realizoj në mbështetje të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor e prokurorial, me qëllim që të jap kontributin e tij për një gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe efikas. Gjithashtu për realizimin e këtij programi trajnues do të organizohen edhe aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë me pjesëmarrje aktive në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare që kanë në fokus trajnimin për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë të sistemit gjyqësor, si dhe do të vazhdojë bashkëpunimi me donatorë dhe partner implementues të programeve të ndryshme të trajnimit.

Programi trajnues për vitin 2017 përmban trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë ku janë të përfshirë tematika nga të gjitha lëmitë e së drejtës, tema dhe module të karakterit interdisiplinar, trajnime për trajnues, programe orientuese për gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar, trajnime fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, trajnime për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive, stafin mbështetës të gjykatave dhe prokurorive, trajnime nga distanca si dhe aktivitetet që do të zhvillohen në drejtim të ofrimit të mundësive për qasje në burime ligjore, hulumtime dhe publikime në ngritjen e kapaciteteve të përfituesve të IGJK-së.

Qëllimi

Programi Trajnues është hartuar me qëllim të përmbledhjes së temave të përgjithshme të cilat reflektojnë nevojat dhe kërkesat reale për trajnim, të dala si rezultat i zhvillimi të një sërë mekanizmash. Gjithashtu programi synon gjithë përfshirjen në trajnime të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë, përcakton kohën e realizimit të trajnimeve, si dhe ndihmon në planifikimin e saktë të buxhetit. Detajet dhe specifikat e programit trajnues ndihmojnë në përgatitjen e trajnuesit, si dhe stafit të IGJK-së në përgatitjet e adekuate për ngritjen e cilësisë në organizimin dhe zbatimin e trajnimeve.

Objektivat e programit

Si rezultat i zbatimit të këtij programit trajnues synohet:

- * Ngritja profesionale e vazhdueshme e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë;
- * Zbatimi i trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë;
- * Ngritja e kapaciteteve profesionale të trajnuesve;
- * Zhvillimi i shkathtësive të posaçme për gjyqtarët e prokurorët e sapoemëruar apo që janë avancuar;
- * Zhvillimi i trajnimeve të nevojshme për stafin e gjykatave dhe prokurorive;
- * Zbatimi i fushës hulumtuese kërkimore dhe botimi i publikimeve;
- * Zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor dhe ndërkombëtar;
- * Zhvillimi i një metodologjie moderne gjatë zbatimit të programeve trajnuese;
- * Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme për trajnim gjyqësor të karakterit ndërkombëtarë.

Struktura e trajnimeve për vitin 2017 do të jetë si më poshtë:

- * Kompetencat profesionale;
- * Kompetencat ndërdisiplinare;
- * Kompetencat lidhur me personalitetin (sjelljen).

Komponentët kryesore të Programit të Trajnimeve janë:

- * Trajnimet e Vazhdueshme
- * Trajnimet Fillestare
- * Trajnimet për Avancim
- * Hulumtimet dhe Publikimet
- * Trajnimet për Trajnues
- * Trajnime për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive
- * Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistëve tjerë nga fusha e gjyqësisë të identifikuar nga IGJK
- * Trajnimet nga distanca.

Marrë parasysh dinamikën e ndryshimeve legislative dhe zhvillimeve tjera, programi i trajnimeve mund të plotësohet në mënyrë që adresoj nevojat e përfituesve të trajnimeve.

Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Rëndësia e trajnimeve të vazhdueshme në zbatim efektiv të ligjit tani është e padiskutueshme në të gjitha vendet e botës edhe në vendin tonë. Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) i dedikohet gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe varësisht nga tema edhe profesionistëve tjerë funksioni i të cilëve lidhet me punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Përmbajtja e këtij programi përfshinë tema të karakterit profesional nga fushat si: e drejta penale (materiale, procedurale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale), e drejta civile (materiale, procedurale dhe të gjitha ndarjet e fushës), drejtësia për fëmijë (aspekti civil dhe penal), e drejta komerciale dhe financiare, e drejta administrative, e drejta evropiane dhe ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe mos - diskriminim, aspekte materiale dhe procedurale nga lëmia e kundërvajtjeve si dhe tema të karakterit interdisiplinar.

Për hartimin e Programit Trajnues 2017 janë zhvilluar mekanizma të shumtë siç janë:

- * Pyetësorët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues;
- * Pyetësorët për vlerësimin e nevojave të plotësuara nga gjyqtarët dhe prokurorët;
- * Rekomandimet e KGJK, KPK, Gjykata Supreme, Prokurorisë së Shtetit, Shoqatës së Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Prokurorëve;
- * Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive;
- * Rekomandimet e institucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare;
- * Propozimet e trajnuesve të IGJK-së (përmes takimeve të veçanta);
- * Raportet e punës së gjykatave dhe prokurorive;
- * Rekomandimet e Zyrës për Vlerësim të Përformancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- * Analiza e agjendës së institucioneve për hartim dhe amendamentim të ligjeve;
- * Hulumtimi i programeve të institucioneve trajnuese regjionale dhe ndërkombëtare;
- * Propozimet e stafit, Këshillit Programor dhe Këshillit Drejtues të IGJK-së;
- * Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- * Monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike;
- * Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovës 2015-2019 Prishtinë, Mars 2015;
- * Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimtimit 2013-2018;
- * Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së;
- * Raporti i Progresit;
- * OSBE - Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundim ligjit.

Penale

1. Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

Kapitulli i sekuestrimit dhe konfiskimit sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP) paraqet një ndryshim substancial në legjislacionin vendor dhe trendët globale lëvizin në drejtim të asaj që me sekuestrim dhe konfiskim më shumë arrihet në parandalimin e krimit, sepse me heqjen e asetëve nga duart e kriminelëve arrihen efekte të shumta. Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale, është mundësi e mirë për sekuestrim dhe konfiskim.

Cila është rëndësia e sekuestrimit të asetëve si provë, si mjet me të cilin është kryer vepra penale apo si

dobi pasurore e fituar me vepër penale? Cilat masa mund të propozohen për sigurimin e pasurisë dhe cilat masa të ngrirjes pas akuzës? Si mund të ngritet zbatimi i dispozitave të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale?

Përmes krahasimeve të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë, rasteve të praktikës gjyqësore, si dhe prezantimit të trendëve globale në këtë fushë, synohet që të arrihet ngritja profesionale dhe të shpjegohen paqartësitë në kornizën ligjore aktuale.

Përmbajtja

- * Korniza ligjore për gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve të fituara me vepër penale;
- * Metodatat për identifikimin e asetëve dhe procesi i sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve të fituara me vepër penale;
- * Ngrirja e asetëve – urdhrat për konfiskimin e asetëve të fituara me vepër penale;
- * Administrimi i pasurisë së sekuestruar.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejtë legjislacionin ekzistues në lidhje me gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga vepra penale;
- * Identifikojnë metodatat kryesore për zbulimin e asetëve të fituara me vepër penale;
- * Zbatojnë procesin e sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve të fituara me vepër penale.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë të përfshirë në gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e asetëve.

2. Veprat Penale kundër detyrës zyrtare

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, përcakton gjashtëmbëdhjetë (16) vepra penale kundër detyrës zyrtare që kanë të bëjnë kryesisht me persona zyrtar. Këto vepra cenojnë sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe perspektiven e vendit. Në luftimin e këtij krimi që nga hetimi e deri në gjykimin meritor, sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor së bashku edhe me organet tjera hetuese kanë rol qenësor. Kështu që hetimi i suksesshëm i këtyre veprave është kompleks dhe varet nga sigurimi i resurseve të mjaftueshme në hetim dhe bashkëpunim të ngushtë në mes organeve shtetërore kompetente për luftimin dhe gjykimin e këtyre veprave.

Sa është efektive korniza ligjore në vend në luftimin e këtij krimi? Cili është dallimi në mes të veprës penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autorizimit dhe veprës penale marrja e ryshfetit? Çfarë janë vështirësitë dhe problemet në praktikë të veprat penale kundër detyrës zyrtare?

Këto dhe çështje tjera do të jenë në fokus të trajnimit, ku pjesëmarrësit do të kenë rastin që përmes elaborimit të kornizës ligjore, rasteve studimore dhe diskutimeve të avancojnë praktikatat e tyre në implementimin e drejtë të ligjit.

Përmbajtja

- * Hetimi efektiv i veprave penale kundër detyrës zyrtare;
- * Tejkalmimi i kufijve të kompetencës përkatësisht autorizimeve zyrtare;
- * Mos kryerja e detyrës zyrtare;
- * Marrja dhe dhënia e ryshfetit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë tejkalmimin e kufijve të autorizimeve zyrtare;
- * Analizojnë veprat penale kundër detyrës zyrtare;
- * Zhvillojnë hetim efektiv.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë, prokurorë dhe policë hetues.

3. Matja e dënimit

Matja e dënimit paraqet një çështje mjaftë të komplikuar pasi nevojitet që të ekuilibrohen kërkesat të cilat janë edhe divergjente. Në këtë kuptim, nevoja për konsistencë në matjen e dënimit dhe minimizimin e dallimeve të pajustificueshme është e një rëndësie të veçantë. Bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, gjyqtarët gëzojnë diskrecion të gjerë në matjen e dënimit, andaj është e domosdoshme që këto autorizime ligjore të shfrytëzohen në mënyrën e duhur, duke e përdorur metodën analitike në trajtimin e rrethanave relevante në matjen e dënimit. Çdo rrethanë lehtësuese dhe rënduese duhet të vlerësohen veç e veç dhe të analizohet ndikimi i tyre në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Sa po përfillen në praktikë rregullat për matjen e dënimit, në veçanti kur kemi të bëjmë me zbutjen gjyqësore? Sa aplikohen drejtë rregullat e kufijve për zbutjen e dënimeve? Cilat janë dilemat dhe vështirësitë në zbatim e matjes së dënimit kur kemi të bëjmë me dënimin për bashkim të veprave penale?

Përmes analizimit të hollësishëm të rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit pjesëmarrësit do të kenë mundësinë që të zbatojnë një sistem unik të matjes së dënimit dhe individualizimit të dënimit.

Përmbajtja

- * Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit;
- * Rrethanat lehtësuese dhe rënduese;
- * Zbutja e dënimit dhe ashpërsimi i dënimit për recidivizëm;
- * Mundësia e lirit nga dënimi;
- * Dënimi për bashkim të veprave penale të vazhduara;
- * Llogaritja e dënimeve për personat e dënuar dhe në paraburgim.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Interpretojnë drejtë rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit;
- * Vlerësojnë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në veçanti në rastet e recidivizmit;
- * Vendosin drejtë për lirim nga dënimi dhe rastet e dënimit të bashkimit të veprave penale të vazhdueshme;
- * Zbatojnë drejtë llogaritjen e dënimeve për personat e dënuar dhe në paraburgim.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarët e nivelit themelor dhe të Apelit.

4. Zbatimi i masave të fshehta hetimore

Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit janë ndër veprimet më të ndjeshme hetimore. Ndërmarrja e këtyre masave padyshim se prek privatësinë e jetës së individit, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në praktikën gjyqësore vendosja lidhur me këto masa ka hapësira për përmirësim, qoftë në respektimin e parimeve me rastin e dhënies së urdhrave për këto masa por edhe në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në aspektin praktikë.

Kur mund të kërkohen dhe kur mund të lëshohen urdhrat për këto masa? Cilat janë kompetencat e Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës dhe gjyqtarit të procedurës paraprake? Cilat janë kushtet ligjore për lëshimin një mase të fshehtë? Sa ka mundësi teknike të mbikëqyrjes së zbatimit teknik-praktik të këtyre masave?

Trajnimi është dizajnuar në atë formë që të trajtojë në tërësi këto masa duke përfshirë edhe procesin në lëshimin dhe arsyetimin e tyre si dhe ti përgjigjet të gjitha dilemave që ekzistojnë në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja

- * Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit;
- * Kushtet ligjore për lëshimin e këtyre masave;
- * Afatet ligjore për zbatimin e masave;
- * Kompetenca, procedura dhe arsyetimi në urdhërimin e këtyre masave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë kushtet për lëshimin e këtyre masave;
- * Zbatojnë kushtet ligjore për lëshimin e këtyre masave;
- * Respektojnë afatet kohore për lëshimin e këtyre masave;
- * Hartojnë urdhra për zbatim të këtyre masave.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë, prokurorë dhe hetues policor.

5. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale

Kodi i Procedurës Penale parasheh masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale, si instrumente me të cilat bëhet kufizimi i lirisë së lëvizjes, dhe përcakton kushtet ligjore me qëllim të zhvillimit me sukses të procedurës penale. Si masë më e rëndë në kuadër të këtyre masave është paraburgimi, dhe sipas instrumenteve ndërkombëtare por edhe legjislacioni ynë sugjeron që paraburgimi të aplikohet vetëm kur shterren të gjitha mundësitë tjera për ta arritur qëllimin. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë shpeshherë nuk janë zbatuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara me ligj, andaj në praktikën gjyqësore ende ka vështirësi në identifikimin, vlerësimin dhe analizimin e rrethanave lidhur me vendosjen për secilën bazë për këto masa. Në praktikën gjyqësore, po ashtu paraqiten vështirësi në përgatitjen e kërkesave për këto masa e

veçanërisht për paraburgim, ka vështirësi në arsyetimin e bazave për caktimin e këtyre masave sepse dispozitat ligjore kërkojnë që për secilën bazë ligjore të këtë arsyetim konkret e jo abstrakt.

Cilat janë bazat për caktimit-vazhdimin e këtyre masave? Ku janë vështirësitë në identifikimin e rrethanave që e arsyetojnë kërkesën për këto masa dhe që e arsyetojnë caktimin e tyre?

Përmes këtij trajnimi synohet që përfituesit të mund të analizojnë masat e sigurisë së të pandehurit në procedurë dhe të mund ti tejkalojnë dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore. Gjithashtu në fokus do të jetë edhe respektimi i lirisë dhe të drejtave të njeriut në rastet e shqiptimit të këtyre masave.

Përmbajtja

- * Kushtet ligjore për caktimin e masave për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- * Dorëzania dhe arresti shtëpiak;
- * Paraburgimi dhe arsyetimi i aktvendimit për caktimin për paraburgim;
- * Paraburgimi dhe masat tjera në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë drejtë elementet për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- * Përcaktojnë llojin e masës;
- * Vendosin për paraburgimin apo masat tjera;
- * Hartojnë dhe arsyetojnë mjaftueshëm vendimet për shqiptimin e këtyre masave.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe prokurorët e prokurorive themelore.

6. Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale dhe bashkimi kriminal

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh përgjegjësinë penale në situatën kur dy apo më shumë persona bashkëpunojnë në kryerjen veprave penale, marrin pjesë në kryerjen ose i kontribuojnë kryerjes së tyre në ndonjë mënyrë tjetër. Ligdhënësi ka paraparë që varësisht prej cilës formë të bashkëpunimit secili kryerës i veprës penale të përgjigjet për veprimin ose mosveprimin e ndërmarrë duke synuar që gjatë procedurës së zhvilluar penale të sigurohet dhe identifikohet saktë dhe qartë se me cilin veprim ose mosveprim ka kryer veprën penale.

A identifikohen drejt në praktikë format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale? Si duhet të identifikojmë format e bashkëpunimit në rastin konkret? Si të përcaktohet përgjegjësia individuale e secilit kryerës?

Për të gjitha këto pyetje të ngritura do të analizohen hollësisht format e bashkëpunimit përmes diskutimeve dhe ofrimit të rasteve nga praktika gjyqësore, qasjes interaktive me pjesëmarrësit, në situatat kur ka të bëjë me bashkëpunim në kryerjen e veprës penale.

Përmbajtja

- * Bashkëkryerja;
- * Shtytja dhe ndihma në kryerjen e veprës penale;
- * Bashkimi kriminal;
- * Marrëveshja për të kryer vepër penale;
- * Kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë format e bashkëkryerjes;
- * Analizojnë rastet kur ka të bëjë me shtytjen dhe ndihmën në kryerjen e veprës penale;
- * Zbatojnë drejtë procedurën lidhur me bashkimin kriminal;
- * Vlerësojnë kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimit për bashkëpunim.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e çështjeve penale të gjitha instancave si dhe prokurorët.

7. Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

Duke pasur parasysh që KPPK, njuh si kategori të posaçme të dëmtuarin, dëshmitarët dhe palët e tjera në procedurë, mbrojtja e të dëmtuarve dhe e dëshmitarëve është me rëndësi të veçantë. Mirëpo në praktikë ka shumë raste që të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën e tyre dhe anëtarëve të familjes. Andaj, në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur që të njëjtit mos të kenë ndonjë ndërhyrje ose shqetësim eventual nga jashtë dhe brenda.

Çka kuptojmë me rrezik serioz? Çka është anonimiteti? Cili është dallimi në mes të dispozitave të KPP, për masat për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve në raport me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve?

Trajnimi synon që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të dilemave të lartpërmendura të kontribuoj në mbrojtjen më efektive të dëmtuarve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor.

Përmbajtja

- * Kërkesa për masë mbrojtëse apo anonimitet dhe lëshimi i urdhrin mbrojtës nga gjyqtari;
- * Urdhri për anonimitet prej të pandehurit dhe prej publikut si dhe format e tij;
- * Procedura për shpalljen e personit dëshmitar të mbrojtur;
- * Përfitimet e dëshmitarit të mbrojtur sipas ligjit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë urdhrin për anonimitet;
- * Hartojnë kërkesën për masë mbrojtëse apo anonimitet dhe urdhrin mbrojtës;
- * Vlerësojnë procedurën për shpalljen e personit dëshmitar të mbrojtur;
- * Interpretojnë drejtë përfitimet e dëshmitarit të mbrojtur sipas ligjit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe të apelit, prokurorë të PSRK, si dhe zyrtarë policor.

8. Krimet e luftës

Krimet e luftës si shkelja më e rëndë e së drejtës humanitare ndërkombëtare paraqesin sfidën më të madhe të sistemit prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë, për shkak të natyrës dhe ndjeshmërisë së këtyre krimeve, në veçanti pasojave të tyre. Duke marr parasysh se këto krime deri në vitin 2016 ishin në kompetencë të prokurorëve dhe gjyqtarëve ndërkombëtar dhe se prokurorët dhe gjyqtarët vendor nuk kanë ndonjë përgatitje të veçantë për trajtim të këtyre rasteve është më se e nevojshme ngritja e kapaciteteve profesionale të tyre në mënyrë që të njëjtit të jenë në gjendje ti punojnë me profesionalizëm këto çështje penale.

Cila është korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare që trajton krimet e luftës? Cilat janë standardet ndërkombëtare në këtë fushë? Si mund të ngritën kapacitetet vendore në trajtimin e suksesshëm të këtyre rasteve? Si të identifikohet përgjegjësia penale e personit për krime të luftës?

Trajnimi është hartuar me qëllim të zgjerimit të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës.

Përmbajtja

- * Veprat penale të krimeve të luftës;
- * Përgjegjësia penale komanduese në rastet e krimeve të luftës;
- * Hetimi dhe sigurimi i provave për krimet e luftës;
- * Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar lidhur me krimet e luftës;
- * Trajtimi i dëshmitarëve dhe të dëmtuarve në rastet e krimeve të luftës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Klasifikojnë veprat penale të krimeve të luftës;
- * Zbarojnë legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar;
- * Njohin dhe analizojnë elementet e veprave penale – krime të luftës;
- * Zbatojnë procedurat e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar lidhur me krimet e luftës;
- * Analizojnë paraqitjen e rastit në gjykatë.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe prokurorë të PSRK, hetues policor.

9. Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrantë

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen global dhe është shkelje e të drejtave të njeriut. Në Kosovë grupet me të rrezikuara nga trafikimi i qenieve njerëzore janë gratë dhe fëmijët për qëllime të shfrytëzimit seksual. Institucionet përgjegjëse janë plotësisht të vetëdijshme për shumëllojshmërinë e shfrytëzimit të qenieve njerëzore që mund të jenë të ekspozuara ndaj krimit të tillë andaj adresimi dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore kërkon një vëmendje dhe qasje të veçantë për shkak të natyrës së tij komplekse. Bazuar në këtë, është e nevojshme ngritja e mëtejme e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të drejtë të legjislacionit të fuqi, dhe përforsimi i bashkëpunimit me institucionet tjera relevante për luftimin e suksesshëm të kësaj dukurie.

Cilat janë elementet e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore? Si mbrohen viktimat e trafikimit? Si të parandalohet trafikimi me njerëz? Si bëhet rehabilitimi dhe ri integrimi i viktimave të trafikuar? Cilat janë mënyrat adekuate të bashkëpunimit në mes të institucioneve përgjegjëse për luftimin e trafikimit me njerëz? Cilat janë elementet e veprës penale të kontrabandimit me migrantë?

Përmes pyetjeve dhe diskutimeve do të trajtohen elementet e trafikimit të qenieve njerëzore, elementet e kontrabandimit me migrantë, dallimet dhe ngjashmëritë në mes të trafikimit, kontrabandimit dhe veprave tjera penale të ndërlidhura me trafikimin, si dhe të drejtat e viktimave të trafikuar në procedurën penale.

Përmbajtja

- * Mbrojtja dhe asistimi i viktimave të trafikimit;
- * Parandalimi i trafikimit me njerëz;
- * Përforsimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes akterëve kyç;
- * Mënyrat e luftimit efektiv të të gjitha formave të trafikimit me njerëz;
- * Dallimet dhe ngjashmëritë në mes trafikimit dhe kontrabandimit me migrant.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë mënyrat e identifikimit të viktimave të trafikimit;
- * Avancojnë njohuritë lidhur me parandalimin e trafikimit me njerëz;
- * Të vlerësojnë mënyrat adekuate të bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse në vend për luftimin dhe parandalimin e trafikimit me njerëz.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarë, gjyqtarë për të mitur dhe prokurorë të nivelit themelor dhe prokurorë të PSRK, hetues policorë, mbrojtësit e viktimave.

10. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë paraqitet si nevojë, meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtarë. Në këtë botë gjithnjë e më të ndërvarur, asnjë vend nuk mund të luftoj krimin në mënyrë efektive pa bashkëpunim mes shteteve për të parandaluar dhe për të zbuluar krimin. Për shkak të rrethanave në të cilat sot gjendet shoqëria njerëzore, sidomos për shkak të zgjerimit të mundësive që kanë kryesit e veprave penale për tejkalim të kufijve, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të njihen me praktikën efikase të bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë në çështjet penale.

Pse është i nevojshëm bashkëpunimi juridik ndërkombëtar? Sa zbatohen në praktikë dispozitat ligjore lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështjet penale? Çfarë natyre janë kërkesat për ndihme juridike?

Programi është hartuar në atë formë që të jep udhëzimet e nevojshme për përgatitjen në formë adekuate të kërkesave juridike ndërkombëtare, në mënyrë që ato të jenë të pranueshme nga ana e shtetit pranues.

Përmbajtja

- * Ndihma juridike e ndërsjellë;
- * Urdhrat kombëtar të shtetit kërkuar;
- * Format tjera të bashkëpunimit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Identifikojnë problemet e zbatueshmërisë së Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë;
- * Vlerësojnë kërkesat juridike ndërkombëtare për ndihmë të ndërsjellë juridike;
- * Zgjedhin mënyrën e dhënies - marrjes së ndihmës juridike ndërkombëtare;
- * Avancojnë njohuritë për format tjera të bashkëpunimit ndërkufitar në çështjet penale.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha nivelet, si dhe stafi i departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë të Ministrisë së Drejtësisë si dhe zyrtarë të lartë të policisë nga departamenti për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë.

11. Krimi i organizuar

Krimi i organizuar, si formë e kriminalitetit, është ndër më të rëndat, e cila është e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kjo formë e kriminalitetit kryhet nga një grup i strukturuar, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt ose tërthorazi të dobisë pasurore apo financiare. Krimi i organizuar kërcënon seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit. Për këtë formë të kriminalitetit, mundë ti referohemi Konventës ndërkombëtare për luftimin e krimit të organizuar, që nënkupton se kjo vepër penale tangon tregun e brendshëm edhe të jashtëm përkatësisht cenon zhvillimin ekonomik të shteteve. Parandalimi dhe dënimi i krimit të organizuar mbështetet gjerësisht në një njohje të thellë të fenomeneve të krimit të organi-

zuar, me vullnet politik të qartë dhe të vendosur, gjyqësor profesional dhe strategji kundër krimit të organizuar në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Cila është infrastruktura ligjore për luftimin e krimit të organizuar? Cilat janë format apo veprimet që duhet ndërmarrë për parandalimin e krimit të organizuar? Si të zbatohen në mënyrë efektive mekanizmat përkatës?

Gjatë trajnimit do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime të pjesshme teorike dhe diskutime interaktive rreth krimit të organizuar, infrastrukturës ligjore, dhe veprimet që ndërmerren prej paraqitjes së këtij lloji të kriminalitetit.

Përmbajtja

- * Përkufizimin ligjor i krimit të organizuar;
- * Korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare;
- * Elementet identifikuese të kësaj vepre penale.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë dispozitat ligjore të aplikueshme;
- * Ngritin e shkathtësitë profesionale për hetimin e kësaj vepre penale;
- * Demonstrojnë standarde të larta profesionale.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Prokurorët dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.

12. Fillimi i hetimit dhe procedura penale

Fillimi i hetimit është veprim me rëndësi në procedurën penale. Për çdo veprim të kundërligjshëm pasi që të mblidhen provat e mjaftueshme nga organet kompetente dhe pranohet kallëzimi penal, është obligim i prokurorisë që të fillon ndjekjen penale. Prokurori i shtetit pas pranimi të kallëzimit penal, e fillon ndjekjen penale pas nxjerrjes së aktvendimit për fillim të hetimeve në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore. Pasi që të nxjerrët aktvendimi për fillim të hetimeve, i njëjti dërgohet Gjyqtarit të Procedurës paraprake, dhe çështja nëse gjyqtari i procedurës paraprake është i obliguar që nga një kopje tu dorëzoj të pandehurit dhe mbrojtësit të tij është dilemë që paraqitet në praktikë.

Cilat janë veprimet që duhet ti ndërmerr prokurori, pasi që ta nxjerr aktvendimin për fillim të hetimeve? Cilat lloje të vendimeve tjera mund të nxjerr në këtë fazë të procedurës? Çfarë lloje të aktvendimeve mund të nxjerr prokurori pas përfundimit të hetimeve?

Gjatë trajnimit trajnuesi duhet tu shpjegojnë pjesëmarrësve cilat janë veprimet të cilat i ndërmerr prokurori pas fillimit të hetimeve, si dhe cila është korniza ligjore e cila zbatohet në këtë procedurë.

Përmbajtja

- * Aktvendimi për fillimin e hetimeve;
- * Afatet ligjore për zhvillimin e hetimeve;
- * Autorizimet e prokurorit të shtetit pas fillimit të hetimeve;
- * Zgjerimi, pezullimi dhe pushimi i hetimeve;
- * Ngritja e aktakuzës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore për fillimin e hetimeve;
- * Ngritin njohuritë e duhura për këtë fazë të procedurës penale;
- * Avancojnë shkathtësitë profesionale për hetimin e rastit;
- * Vlerësojnë drejtë rrethanat për ngritjen e aktakuzës.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Prokurorët dhe gjyqtarët e nivelit themelor.

13. Veprat penale kundër ekonomisë

Veprat penale kundër ekonomisë kanë për qëllim që të dëmtojnë interesin e individit ose të shtetit, të kufizojnë qarkullimin e lirë të kapitalit, njerëzve, mallrave, shërbimeve, punës apo mjeteve, për përfitime personale duke dëmtuar tjetrin. Përndryshe këto vepra penale ndërlidhen me veprimin i cili shkon në drejtim të dëmtuarit, duke përdorur mashtrimin, keqpërdorimin, falsifikimin, lidhjen e kontratave të dëmshme, falsifikimin e shenjave me vlerë, cenimin e të drejtë së patentave, falsifikimin e parasë etj., me qëllim shmangies së obligimeve ndaj shtetit. Luftimi me sukses i krimeve ekonomike dhe financiare mundëson funksionimin e ekonomisë së tregut dhe konkurrencën e lirë të cilat janë bazë për zhvillimin e një vendi.

Çfarë veprimesh parandaluese duhet ndërmerren për të luftuar ekonominë joformale? Pse ekonomia joformale është një metodë perfekte për tu pasuruar dhe për të krijuar monopol në raport me bizneset legale? Çfarë parakushte duhet krijuar për një kontroll të mjeteve financiare? Cili është roli i gjyqësorit në luftimin e këtyre veprave?

Përfituesit e këtij trajnimi kanë mundësinë që të bashkëbisedojnë dhe ndajnë përvojat dhe sfidat e tyre në luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare. Për me tepër do të trajtohen këto krime që nga format e paraqitjes së tyre, metodat në luftimin efikas dhe roli i institucioneve në parandalimin e tyre.

Përmbajtja

- * Veprat penale kundër ekonomisë;
- * Hetimi i këtyre veprave dhe roli i subjekteve në procedurë;
- * Dëmtimi i interesit të shtetit dhe roli i faktorit njeri;
- * Ekonomia jo formale dhe refleksioni i saj në zhvillimin ekonomik të shtetit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejt dispozitat ligjore lidhur me veprat penale kundër ekonomisë;
- * Avancojnë njohuritë për këto lloje të veprave penale;
- * Zbatojnë metodat efikase për parandalimin e ekonomisë jo formale.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe institucionet tjera relevante.

14. Dëshmitarët në procedurën penale

Duke pasur parasysh që KPPK, njeh si kategori të posaçme dëshmitarët në procedurën penale, të njëjtit janë me rëndësi gjatë procedimit të mëtejshëm. Në këtë drejtim KPPK ka paraparë procedurën përkatëse për procedimin me dëshmitarë. Si dëshmitarë mund të thirret personi, për të cilin besohet se jep informata të duhura për veprën penale të kryer si dhe kryerësit e veprës penale. Personi i thirrur në cilësi të dëshmitarit është i obliguar që t'i përgjigjet thirrjes në të kundërtën ndaj tij mund të merren masat e para para me ligj. Përndryshe dëshmitari i cili dëgjohej, duhet të paralajmërohet për të drejtat dhe detyrimet që i përkasin me ligj. KPPK njeh këto kategori të dëshmitarëve: dëshmitarët okular (pamor), dëshmitarët e privilegjuar, dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar, dëshmitarët e tërthortë etj.

Çka kuptojmë me dëshmitarët e drejtpërdrejt? Çka është anonimiteti? Cili është dallimi në mes të dispozitave të KPP për masat për mbrojtjen e dëshmitarëve, me dispozitat përkatëse ligjore? Cilat janë të drejtat e tyre në procedurë?

Trajnimi synon që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të dilemave të lartpërmendura të kontribuoj në mbrojtjen më efektive të dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor. Përfituesit e këtij trajnimi kanë mundësinë që të bashkëbisedojnë dhe ndajnë përvojat e tyre lidhur me sfidat të cilat i kanë gjatë punës, në cilësinë e gjyqtarit apo prokurorit.

Përmbajtja

- * Dëshmitarët në fazat e ndryshme të procedurës penale;
- * Të drejtat e dëshmitarëve në procedurën penale;
- * Dëshmitarët bashkëpunues;
- * Dëshmitarët e privilegjuar;
- * Kush mund të dëshmojë në cilësinë e dëshmitarit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë dispozitat ligjore përkitazi me pozitën e dëshmitarëve në procedurën penale;
- * Ngritin shkathtësitë profesionale për zbatimin e dispozitave ligjore gjatë punës së tyre;
- * Demonstrjnë standarde të larta profesionale gjatë intervistimit të dëshmitarëve.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarë dhe Prokurorë të nivelit themelor.

15. Hetimi i krimeve financiare

Krimet financiare bëjnë pjesë ndër krimet më serioze, të cilat kanë për qëllim që ta atakojnë zhvillimin ekonomik të shoqërisë. Si formë e kriminalitetit manifestohet në forma të ndryshme si: korrupsioni me të gjitha karakteristikat, pastrimi i parave, evazionet fiskale, prokurimi publik etj. Të gjitha veprat penale që ndërlidhen me krimet financiare, kryhen duke mos njohur sundimin e ligjit, dhe menjëherë shkaktojnë parregullsi brenda vet sistemit. Shtetet i japin hapësirë të konsiderueshme luftimit të këtyre dukurive ngase të gjitha janë shkatërruese dhe vazhdimisht kanë tendencë të shtrirjes për ti atakuar vlerat e shtetit.

Çfarë veprimesh parandaluese duhet ndërmarr për të luftuar ndikimin e krimit financiar? Cila është forma e hartimit të strategjive përkatëse për luftimin e krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave, evazionit fiskal etj.? Si ndikojnë format e paraqitjes së krimit financiar në shtrirjen e mëtejme dhe cilat janë masat parandaluese për luftimin e të njëjtit?

Përfituesit e këtij trajnimi kanë mundësinë që të bashkëbisedojnë dhe ndajnë përvojat dhe sfidat e tyre në luftimin e krimit financiar si dhe formave të paraqitjes.

Përmbajtja

- * Pastrimi i parave dhe ndikimi i elementeve të kësaj forme të kriminalitetit në shoqëri;
- * Prokurimi publik;
- * Evazioni fiskal.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë dispozitat ligjore përkitazi me veprat penale të krimeve financiare;
- * Ngritin njohuritë lidhur me hetimin e krimit financiar;
- * Avancojnë shkathtësitë profesionale për hetimin dhe trajtimin e krimeve financiare;
- * Demonstrjnë standardet profesionale për sukses më të mirë për hetimin e krimit financiar.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, hetues policorë dhe zyrtarë të NJIF-it.

16. Urdhërkontrolli

Kontrolli është veprim hetimor, juridikisht i rregulluar me dispozita të Kodit të Procedurës Penale përmes të cilit sigurohen provat materiale. Me qëllim të sigurisë juridike për qytetarët, gjatë kontrollit, është me rëndësi që kontrolli të zbatohet në përputhje të plotë me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Duke pas parasysh faktin se kemi të bëjmë me qasjen në pronën e tjetrit si dhe rëndësinë e privatësisë, zbatuesit e urdhër kontrollit duhet çdo herë të respektojnë të drejtat e individit ndaj të cilit drejtohet urdhri. Me këtë veprim hetimor synohet sigurimi i provave të cilat do të shërbejnë si bazë për ngritjen e aktit akuzues dhe argumentimin e tij para Gjykatës.

A respektohet çdoherë procedura e kërkimit të urdhër kontrollit? Sa arsyetohet një kërkesë për urdhër kontroll? A tejkalohej urdhër kontrolli gjatë ekzekutimit? A respektohen çdoherë të drejtat e personit të cilit i drejtohet urdhri? Sa respektohen kufizimet e përcaktuara me ligj?

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit do të diskutojnë për zgjidhjet praktike në mënyrë që gjatë punës së tyre ti kush-tojnë vëmendje të posaçme kufizimeve gjatë zbatimit të urdhër kontrolleve.

Përmbajtja

- * Procedura para fillimit të kontrollit dhe të drejtat e të pandehurit;
- * Kufizimet në kontroll;
- * Provat që nuk kanë lidhshmëri me bazën e kontrollit;
- * Kontrolli pa urdhër të gjykatës;
- * Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë procedurën para fillimit të urdhër kontrollit;
- * Vlerësojnë të drejtat e të pandehurit;
- * Identifikojnë kufizimet në urdhër kontroll;
- * Interpretojnë drejtë dispozitat lidhur me pranueshmërinë e provave.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Prokurorë dhe gjyqtarë të nivelit themelore si dhe hetues policorë.

17. Aktakuza

Aktakuza është akt procedural që prokurori i shtetit e ushtron kundër kryesve të veprave penale kur ekziston dyshimi i bazuar mirë, si rezultat i hetimeve të zhvilluara. Rëndësia e këtij akti akuzues qëndron në faktin se e vënë në lëvizje procedurën penale ndaj kryerësve të veprave penale dhe i hap rrugën gjykatës që ti sanksionoj kryerësit e veprave penale. Nga analizat e publikuara, rezulton se një numër i madh i aktakuzave hedhen nga ana e gjykatës, për arsye që nuk janë konform kushteve të parapara ligjore, andaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë për punën e prokurorëve, për faktin që e tëra puna e tij finalizohet me ngritjen e aktit akuzues.

Cilat elemente duhet të përmbaj aktakuza? Cila është procedura e ngritjes së aktakuzës? Cilat shkresa përcjellëse i bashkëngjiten aktakuzës? Cilat janë të drejtat e të akuzuarit pas pranimit të aktakuzës?

Programi është hartuar në mënyrë që ofroj udhëzime teorike dhe praktike për respektimin e saktë të procedurës së ngritjes së aktakuzës, dhe hartimit adekuat të aktakuzës në formën që plotëson kushtet ligjore.

Përmbajtja

- * Aktakuza;
- * Elementet e aktakuzës;
- * Ngritja e aktakuzës;
- * Ndryshimi, zgjerimi dhe hedhja e aktakuzës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Hartojnë drejt përmbajtjen e aktakuzës;
- * Vlerësojnë elementet e domosdoshme të aktakuzës;
- * Zbatojnë dispozitat ligjore për ngritjen e aktakuzës;
- * Identifikojnë rastet kur mund të bëhet ndryshimi, zgjerimi dhe hedhja e aktakuzës.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Prokurorët e nivelit themelor dhe prokurorët e PSRK si dhe gjyqtarët.

18. Terrorizmi

Terrorizmi paraqet një kërcënim serioz dhe një fenomen global i cili cenon rendin kushtetues për shtetin e së drejtës. Republika e Kosovës ka hartuar legjislacionin e nevojshëm për luftimin dhe parandalimin e veprave penale të kësaj natyre. Gjithashtu ekziston Strategjia për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Përfshirja e shtetaseve të Kosovës në organizata të ndryshme terroriste dhe pjesëmarrja në luftëra të huaja, kërkon një kujdes të posaçëm nga institucionet relevante për hetimin, ndjekjen dhe dënimin e këtyre personave. Për shkak të rëndësisë specifike të këtyre veprave, dhe për faktin që aktu-

alisht Kosova ballafaqohet me veprat e kësaj natyre, trajtimi i kësaj teme është më se i rëndësishëm.

Cili është legjislacioni i zbatueshëm në këtë fushë? Cilat janë format e veprave penale të terrorizmit? Si mund të forcohen kapacitetet vendore në luftimin e suksesshëm të kësaj dukurie?

Trajtimi i kësaj teme adreson format e paraqitjes së veprës penale të terrorizmit, karakteristikat e saj, sfidat dhe praktikatat më të mira të organeve të ndjekjes për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

Përmbajtja

- * Veprat penale të terrorizmit;
- * Format e kryerjes së veprave penale të terrorizmit;
- * Praktikatat më të mira në luftimin e kësaj dukurie.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zgjerojnë njohuritë për veprat penale të terrorizmit;
- * Analizojnë format e paraqitjes së veprës penale të terrorizmit;
- * Zbatojnë instrumentet e përshtatshme për luftimin kundër veprës penale të terrorizmit.

Kohëzgjatja

Një ditor

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti i krimeve të rënda si dhe prokurorët e PSRK.

19. Veprat penale sipas Kodit Doganor

Veprat Penale kundër doganës janë fenomen negativ, kërcënues dhe shqetësues i shoqërisë, dhe si të tilla janë të përcaktuara në Kodin Doganor dhe të akcizave si dhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Të gjitha format e kriminalitetit ekonomik i tejkalojnë kufijtë kombëtar dhe lufta kundër tyre është e vështirë të bëhet brenda juridiksionit kombëtar të një vendi. Duke pasur parasysh peshën e këtyre veprave penale dhe paraqitjen e tyre në forma të ndryshme, është me një rëndësi të veçantë për shoqërinë dhe detyrim i institucioneve relevante luftimi i kësaj dukurie nëpërmjet masave, veprimeve dhe mekanizmave përkatës me qëllim të parandalimit, meqë këto veprat rrezikojnë ekonominë e vendit.

Cilat vepra penale hyjnë në kategorinë e veprave penale sipas Kodit Doganor? Kush mund të jetë kryerës i këtyre veprave penale? Cili është dallimi nga veprat penale kundër ekonomisë të parapara në KPRK?

Trajtimi i kësaj teme adreson dilemat se cilat vepra konsiderohen vepra penale sipas Kodit Doganor, specifikat e këtyre veprave penale, dhe çfarë është objekt mbrojtës i veprave penale sipas Kodit Doganor.

Përmbajtja

- * Veprat penale sipas Kodit Doganor dhe akcizave në Kosovë;
- * Specifikat e veprave penale sipas Kodit Doganor dhe akcizave në Kosovë;
- * Veprat penale doganore të parapara sipas Kodit Penal të Kosovës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zgjerojnë njohuritë për veprat penale sipas Kodit Doganor;
- * Analizojnë format e paraqitjes së këtyre veprave penale;
- * Zbatojnë veprat penale sipas Kodit Doganor dhe KPRK;
- * Identifikojnë instrumentet për luftimin dhe parandalimin e këtyre veprave.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët nga të gjitha instancat si dhe prokurorët e PSRK.

20. Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale

Mbrojtja e të drejtave të njeriut është parim bazë i përcaktuar në dokumentet kryesore ndërkombëtare gjithashtu edhe me Kushtetutën dhe ligjet pozitive në vendin tonë. Është e domosdoshme që të mbrohet dinjiteti i njeriut si dhe të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe të drejtat tjera të personave që mund të jenë objekt i hetimit dhe akuzimit për veprat penale. E drejta e të dyshuarit respektivisht të pandehurit në procedurën penale për tu informuar në kohë sa më të shpejtë, në lidhje me veprën për të cilën dyshohet, akuzën dhe provat tjera është një nga të drejtat themelore të tij. Me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit dhe të drejtave themelore të personave të dyshuar, është detyrë e institucioneve të drejtësisë që të kujdesen për garantimin dhe ruajtjen e të drejtave të personave të pandehur gjatë gjithë fazave të procedurës duke filluar nga arrestimi i të pandehurit e deri në përfundimin e procedurës. Të pandehurit duhet të informohen me kohë dhe në hollësi mbi natyrën dhe shkakun e akuzimit kundër tij, dhe ti jepet kohë e mjaftueshme për të ushtruar të drejtat e tij të mbrojtjes në mënyrë efektive.

Cilat janë të drejtat që i gëzon i pandehuri? Cili është obligimi i gjykatave dhe prokurorive për njoftimin e të dyshuarit për të drejtat e tij? Kur duhet të informohet për të drejtat e tij? Kur duhet ti dorëzohet akuza dhe provat të pandehurit?

Trajnimi synon që përmes diskutimit të dilemave aktuale, të ofroj praktikat më të mira për informimin e shpejtë dhe efikas të pandehurit me të drejtat e tij gjatë fazave të procedurës.

Përmbajtja

- * Të drejtat e të pandehurit sipas legjislacionit aktual;
- * Fazat e procedurës kur i pandehuri duhet të njoftohet me të drejtat e tij;
- * Fazat e procedurës kur duhet të pandehurit ti jepet akuza dhe të gjitha provat.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejt kornizën ligjore për të drejtat e të pandehurit në procedurë;
- * Njohin dhe respektojnë të drejtat e të pandehurit gjatë procedurës penale;
- * Vlerësojnë fazat e procedurës kur i pandehuri njoftohet me të drejtat e tij.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor, prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarët policor.

21. Procedurat alternative

Procedurat alternative janë procedura të cilat kanë pësuar disa ndryshime në krahasim me kodin e mëparshëm të procedurës penale dhe këto procedura ofrojnë mundësi për zgjidhjen më të shpejtë të çështjeve. Kjo është veçanërisht e dobishme për të rritur efikasitetin dhe për të krijuar një sistem të drejtësisë penale që garanton një gjykim të drejtë të rasteve penale, por që e bënë këtë me shpejtësinë e duhur për mbrojtjen e të drejtave të gjitha palëve.

Sa po zbatohen në praktikë procedurat alternative? Si zhvillohet procedura e negocimit të marrëveshjes për

pranimin e fajësisë? Në cilat situata mund të pezullohet përkohësisht procedura?

Trajnimi është hartuar t'iu përgjigjet pyetjeve dhe dilemave të ngritura me fokus në analizimin e zbatimit të procedurave alternative në praktikë. Gjithashtu, synohet që përmes këtij trajnimi të adresohet rëndësia e procedurave alternative si mundësi më e shpejtë në zgjidhjen e rasteve penale.

Përmbajtja

- * Diversioni dhe pezullimi i përkohshëm i procedurës;
- * Ndërmjetësimi;
- * Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë nevojën e zgjidhjes së lëndëve përmes procedurave alternative;
- * Zbatojnë procedurat alternative.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.

22. Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale

Kodi i Procedurës Penale në frymën e tij të re hap horizontin e sjelljes së provave, nga palët në procedurë. Si rezultat i të provuarit nga ana e palëve do të nxirret edhe çështja e bindjes së gjyqtarit për pranimin, respektivisht besueshmërinë e një prove e cila argumenton ose jo një fakt të rëndësishëm juridik për vërtetimin ose gjetjen e përgjegjësive penale të pandehurve. Sipas Kodit të Procedurës Penale gjyqtarit i mbetet të vlerësoj në tërësi cilësinë e provës, duke fituar bindjen se sa është e besueshme ajo provë, çfarë rëndësie dhe vlere provuese ka ajo provë për

vërtetimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike në procedurë penale.

Si do të sigurohet një provë? Kush do ta sigurojë këtë provë? Çfarë cilësie do të jetë ajo provë dhe cila do jetë vlera provuese e asaj prove?

Ky trajnim është hartuar të përgjigjet në pyetjet dhe dilemat e ngritura, duke analizuar kornizën ligjore dhe praktikën në interpretimin e drejtë të çështjeve që kanë të bëjnë me cilësinë dhe vlerësimin e provave.

Përmbajtja

- * Mënyra e sigurimit të provave;
- * Subjektet për sigurimin e provave;
- * Rregullat e përgjithshme për vlerësimin e provave.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë provat e pranueshme nga provat e papranueshme;
- * Interpretojnë në mënyrë të drejtë besueshmërinë dhe rëndësinë e provave;
- * Zbërthejnë vlerën provuese të provave.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.

23. Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor

Kodi i Procedurës Penale, përveç tjerash, ka pësuar ndryshime të mëdha edhe në dispozitat që e rregullojnë procedurën pas ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, duke parashikuar, shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë. Në anën tjetër, pas hyrjes në fuqi të KPP, në praktikën gjyqësore, janë paraqitur mjaft vështirësi dhe konfuzione me rastin e aplikimit të dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë. Përveç këtyre, edhe dispozitat që e rregullojnë shqyrtimin gjyqësor kanë pësuar ndryshime të theksuara.

Në cilat situata do të duhej të caktohet shqyrtimi i dytë dhe në cilat situata mund të kërkohet vetëm paraqitja e kërkesës për hedhjen e aktakuzës ose të kundërshtimit të provave? Si do të veprohet nëse i pandehuri e pranon fajësinë gjatë shqyrtimit të dytë? Cili do të jetë roli i gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues gjatë shqyrtimit fillestar ose gjatë shqyrtimit të dytë? Si do të rrjedh seanca për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin?

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, do të analizohen situata të ndryshme në të cilat do të mund të gjendeshin gjyqtarët gjatë shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë apo të shqyrtimit gjyqësor.

Përmbajtja

- * Zhvillimi dhe rrjedha e procedurës në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimin e dytë;
- * Roli i gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit të dytë;
- * Seanca për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin;
- * Shqyrtimi gjyqësor.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Organizojnë zhvillimin e procedurës në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimin e dytë;
- * Vlerësojnë rolin e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar dhe të dytë;
- * Zbatojnë drejt seancën për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin dhe seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.

24. Veprat penale kundër jetës dhe trupit

E drejta e njeriut për jetë është e drejta më e rëndësishme në grupin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo e drejtë është absolute, pa marrë parasysh interesin jetësor të individit, aftësinë për jetë, moshën dhe gjendjen shëndetësore të njeriut. Për këtë arsye, kjo e drejtë është e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare, por garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përveç këtyre, mbrojtjen e të drejtës në jetë e sanksionon edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës, duke parashikuar disa forma të veprave penale të vrasjeve. Gjithashtu, përveç të drejtës në jetë, një rëndësi të veçantë duhet që t'i kushtohet edhe mbrojtjes së integritetit trupor të personit.

Si përkufizohet vrasja? Si kualifikohet dhe çka e karakterizon vrasjen e rëndë? Cilat janë elementet esenciale të veprat penale të vrasjes? Në cilat rrethana mund të kryhet vepra penale e vrasjes? Cilat janë veprat tjera penale që bëjnë pjesë në kuadër të veprave penale kundër jetës dhe trupit.

Ky program është i hartuar që përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, të ofrohen alternativa lidhur me kualifikimin e drejtë juridik të veprave penale të këtij kapitulli.

Përmbajtja

- * Vrasja dhe vrasja e rëndë;
- * Lëndimi i lehtë dhe lëndimi i rëndë trupor;
- * Veprat tjera penale të këtij kapitulli të KPK.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë format e paraqitjes së vrasjes dhe vrasjes së rëndë;
- * Zgjerojnë njohuritë lidhur me veprat penale të lëndimit të lehtë dhe të rëndë trupor;
- * Kuptojnë në mënyrë të drejtë veprat tjera të këtij kapitulli të KPK.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e çështjeve penale të të gjitha instancave si dhe prokurorët.

25. Parashkrimi

Parashkrimi apo vjetërsimi si institut juridik nënkupton pamundësinë e ndjekjes penale, shqiptimit të dënimit dhe ekzekutimit të sanksioneve penale apo masave të trajtimit të detyrueshëm për shkak të kalimit të afatit të caktuar ligjor. Ky afat është i ndryshueshëm dhe varet nga lloji i veprës penale, si dhe lartësia e dënimit. Parashkrimi i lëndëve në proceset penale paraqet një problematikë dhe sfidë për sistemin gjyqësor dhe prokurorial, marr për bazë numrin e madh të lëndëve të parashkruara. Ndër faktorët kryesor që ndikojnë në rritjen e lëndëve të parashkruara konsiderohet ngarkesa e madhe me lëndë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe faktorë tjerë që kanë të bëjnë me aspektin profesional të

zbatimit të dispozitave ligjore që kanë si pasojë mosrespektimin e afateve ligjore, andaj trajtimi i kësaj teme në kuadër të programit trajnues, rezulton shumë i nevojshëm.

Prej cilit moment fillon të rrjedhë afati i parashkrimit të ndjekjes penale? Në cilat raste mund të ndërpritet ekzekutimi i sanksioneve penale në raste të arritjes së afatit të parashkrimit?

Kjo temë ka për qëllim që të përgjigjet në pyetjet dhe dilemat e ngritura, duke analizuar kornizën ligjore dhe praktikën në interpretimin e drejtë të institutit të parashkrimit.

Përmbajtja

- * Fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale;
- * Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit, fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit;
- * Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë fillimin dhe ndërprerjen e parashkrimit;
- * Përcaktojnë afatin e parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale;
- * Vlerësojnë kushtet e parashkrimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë.

26. Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore

Personat me çrregullime mendore janë kategori e veçantë e kryerësve të veprave penale, kështu që edhe me KPP është parashikuar procedurë specifike tek rastet kur përfshihen këta persona si kryerës. Trajtimi i këtyre rasteve kërkon një kujdes të veçantë, për shkak të gjendjes mendore në të cilën gjenden në momentin e zhvillimit të procedurës ndaj tyre. Po ashtu, edhe vendimet pa dyshim se duhet të jenë të përshtatura gjendjes së tyre mendore, në mënyrë që masa e cila shqiptohet të ndikoj në përmirësimin e gjendjes së këtyre personave.

Si identifikohen këta persona? Çfarë veprimesh procedurale fillestare ndërmerren ndaj tyre? Cilat ekza-

minime duhet të kryhen? Cilat masa shqiptohen ndaj tyre dhe në cilin institucion duhet të vendosen? Sa zgjatë mbikëqyrja e zbatimit të këtyre masave nga gjykata?

Ky program është i hartuar që të përgjigjet pyetjeve duke analizuar procedurën e cila zhvillohet ndaj kryerësve me çrregullime mendore, ekspertizat të cilat duhet të kryhen për përcaktimin nëse një person a vuan nga ndonjë çrregullim mendor, kur mund t'i caktohet paraburgimi këtyre personave, kriteret të cilat merren parasysh për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm, si dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të këtyre masave.

Përmbajtja

- * Veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore;
- * Paraburgimi për personat me çrregullime mendore;
- * Zbatimi i ekzaminimit psikiatrik;
- * Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe në liri.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zgjerojnë njohuritë lidhur me veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore;
- * Vlerësojnë caktimin e paraburgimit si masë për personat me çrregullime mendore;
- * Analizojnë llojet e trajtimit të detyrueshëm me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e çështjeve penale të gjitha instancave si dhe prokurorët.

27. Mundësia hetuese e veçantë

Mundësia hetuese e veçantë zbatohet në rastet kur personat e autorizuar kërkojnë nga gjyqtari i procedurës paraprake të marr dëshmi nga dëshmitari ose të kërkojë ekspertizë me qëllim të ruajtjes së provës, kur ekziston një mundësi e veçantë për marrjen e provës së rëndësishme, ose kur ka rrezik të konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor. Me këtë rast gjyqtari i procedurës paraprake cakton dy gjyqtarë tjerë në Panelin për Mundësinë Hetuese të Veçantë. Provat e siguruara gjatë mundësisë hetuese të veçantë mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, urdhrat për paraburgim dhe ak-takuzën. Këto prova janë plotësisht të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor nëse së paku njëri nga gjyqtarët e kolegjit gjykues që ka dëgjuar dëshmitë është gjyqtar në trupin gjykues në shqyrtim kryesor.

Si zhvillohet seanca gjatë zbatimit të mundësisë hetuese të veçantë? Kush vendos lidhur me kërkesën për zbatimin e mundësisë hetuese të veçantë? Kush duhet të marrë pjesë në seancën e mundësisë hetuese të veçantë? Në cilat raste zbatohet mundësia hetuese e veçantë? Pse është i nevojshëm zbatimi i mundësisë hetuese të veçantë? Cila është pritshmëria e zbatimit të mundësisë hetuese të veçantë?

Përmes trajtimit të kësaj teme pjesëmarrësit do të qartësojnë mundësinë hetuese të veçantë dhe të tejkalojnë paqartësitë që ekzistojnë në praktikën gjyqësore në çështjet e marrjes në pyetje të palëve në procedurë, si dhe të analizojnë rastet kur dëshmia e marr në hetimet e veçanta është provë e pranueshme për gjykatën, në të cilën mund të bazohet aktgjykimi.

Përmbajtja

- * Rastet – veprat penale për të cilat mund të zbatohet mundësia hetuese e veçantë;
- * Inicimi i zbatimit të mundësisë hetuese të veçantë;
- * Pranueshmëria e provave të siguruara nga mundësia hetuese e veçantë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë mundësinë hetuese të veçantë nga hetimi i rregullt;
- * Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat që kanë të bëjnë me mundësinë hetuese të veçantë;
- * Vlerësojnë provat e siguruara përmes mundësisë hetuese të veçantë.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor.

28. Mjetet e rregullta juridike dhe bazat e ankesës

Ankesa, si mjet juridik i rregullt, devolutiv dhe suspensiv mund të paraqitet ndaj aktgjykimit për të gjitha bazat e parashikuara me Kodin e Procedurës Penale. Si mjet i rregullt juridik, konsiderohet edhe ankesa ndaj aktvendimit. Gjatë praktikës gjyqësore janë vërejtur vështirësi me rastin e ushtrimit të mjeteve të rregullta juridike, si për nga struktura ashtu edhe nga procedura.

Cilat janë elementet përmbajtjesore të ankesës? Cila janë bazat për ushtrimin e këtyre mjeteve juridike? Cila është procedura që duhet të respektohet me rastin e paraqitjes së mjeteve të rregullta juridike?

Ky trajnim është hartuar për t'u përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe dilemat që paraqiten në praktiken gjyqësore sa i përket mjeteve të rregullta juridike. Përmes ofrimit të rasteve nga praktika gjyqësore, si dhe qasjes interaktive me pjesëmarrësit, do të analizohen me hollësi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mjetet e rregullta juridike.

Përmbajtja

- * Rregullat e përgjithshme lidhur me mjetet juridike;
- * Ankesa ndaj aktgjykimit dhe aktvendimit;
- * Bazat për të cilat mund të paraqitet ankesa ndaj aktgjykimit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejtë rregullat e përgjithshme lidhur me mjetet e rregullta juridike;
- * Vlerësojnë bazat për të cilat mund të paraqitet ankesa ndaj aktgjykimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e çështjeve penale të të gjitha instancave si dhe prokurorët.

29. Përgjegjësia penale e personave juridik

Personi juridik është një organizëm kolektiv që e drejta e ka njohur si subjekt të veçantë, duke i dhënë zotësinë për të pasur të drejta dhe detyrime juridike. Kuptohet që zotësia juridike dhe për të vepruar e personit juridik është brenda limiteve të përcaktuar nga personat fizike me aktin e themelimit dhe statut si dhe ndryshon nga zotësia e këtyre të fundit. Në praktikën gjyqësore paraqiten probleme të shpeshta në përcaktimin e përgjegjësisë penale të kryesve të veprave penale të personave juridik.

Çfarë është përgjegjësia penale e personave juridik? Cili është kufiri i kësaj përgjegjësie? Çfarë janë sanksionet penale?

Ky trajnim është dizajnuar që të përgjigjet pyetjeve dhe dilemave që ekzistojnë në praktikë me fokus në elaborimin e legjislacionit vendor. Pjesëmarrësit do të kenë rastin që përmes diskutimeve, analizimit të rasteve hipotetike dhe punës në grupe të avancojnë njohuritë e tyre për këtë fushë.

Përmbajtja

- * Baza dhe kufiri i përgjegjësisë së personave juridik;
- * Masat e sigurisë;
- * Dënimet dhe sanksionet e tjera penalo-juridike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejtë institutin e përgjegjësisë penale të personave juridik sipas ligjit;
- * Bëjnë dallimin e veprave penale që kryhen nga personi përgjegjës i personit juridik;
- * Interpretojnë drejtë normat ligjore të këtij instituti.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtaret nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykatat Themelore departamenti i përgjithshëm që do të gjykojnë çështjet penale si dhe prokuroret nga Prokuroria Themelore - departamenti i përgjithshëm.

Civile

30. Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së

Ligji i Procedurës Kontestimore për mënyrën meritore të vendosjes së kontesteve gjyqësore ka paraparë disa lloje të aktgjykimeve të cilat mund të nxirren nga gjykatat në rrethana të caktuara dhe nën plotësimin e kushteve të veçanta procedurale. Vlerësimi i kushteve specifike për secilin lloj të aktgjykimit nga ana e gjykatave ka krijuar disa dilema të cilat po ndikojnë që në disa raste gjykatat t'i vlerësojnë në mënyrë të gabuar këto kushte e rrjedhimisht edhe të nxjerrin përfundime përkatësisht aktgjykime me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.

Cilët janë llojet e aktgjykimeve sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore? Cilat kushte duhet të plotësohen që të nxirret secili lloj i aktgjykimit? Çka duhet të përmbajë arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit?

Çështjet e lartpërmendura që do të trajtohen në këtë trajnim janë ndër pyetjet boshte ku do të bëhet përpjekje që tu jepet përgjigje adekuate që ndërlidhën me aktgjykimin si formë e vendosjes meritore në një çështje juridike kontestimore dhe llojeve të aktgjykimeve që mund të nxjerr gjykata në një çështje juridike kontestimore. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesi, diskutimeve, analizës së rasteve studimore t'i zbërthejnë dhe aplikojnë drejtë dispozitat e procedurës kontestime lidhur me aktgjykimin dhe llojet e tij.

Përmbajtja

- * Aktgjykimi;
- * Llojet e aktgjykimeve dhe kushtet për nxjerrjen e tyre;
- * Përmbajtja e aktgjykimit dhe arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbërthejnë dhe analizojnë aktgjykimin si formë të vendosjes meritore;
- * Vlerësojnë kushtet për nxjerrjen e llojeve të ndryshme të aktgjykimeve;
- * Hartojnë drejtë arsyetimin e secilit lloj të aktgjykimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore.

31. Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve

Në vendin tonë janë aktuale ndërtimet e shumta, dhe si rrjedhojë janë prezente edhe kontestet në mes bizneseve vendore, por edhe të bizneseve të huaja që rrjedhin drejtpërdrejtë nga investimet në fushën e ndërtimeve. Kontestet e tilla shpeshherë kanë vlera të larta monetare, janë të ndërlidhura dhe ngërthejnë në vete shumë palë dhe obligime. Andaj, për zgjidhjen e drejt të kontesteve të kësaj natyre kërkohet përgatitje adekuate e gjyqtarëve, si në aspektin teorik edhe në atë praktik.

Cilat kushte duhet të plotësohet që kontrata e ndërtimit të jetë e vlefshme? Si duhet të veprohet në

rast se paraqitet nevoja për punë të domosdoshme? Si ndikon rritja apo zvogëlimi i çmimeve në treg për materialin ndërtues?

Trajnimi është strukturuar në mënyrën që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave materiale juridike që i referohen kushteve për lidhjen e kontratës së ndërtimit dhe përgjegjësisë së kontraktuesve në raste të tilla. Në trajnim do të ofrohet edhe përvoja e dobishme nga praktika gjyqësore.

Përmbajtja

- * Karakteristikat dhe natyra juridike e kontratës së ndërtimit;
- * Shmangia nga projekti dhe punimet urgjente të paparashikuara;
- * Efekti i ndryshmit të çmimit të kontratës së ndërtimit dhe e drejta e porositësit për të kërkuar zbritjen e çmimit të kontraktuar;
- * Kontrata e ndërtimit me dispozitë të veçantë;
- * Përgjegjësia për të metat.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbërthejnë dhe vlerësojnë kushtet e nevojshme për lidhjen e kontratës së ndërtimit;
- * Kuptojnë natyrën e përgjegjësive të palëve kontraktuese;
- * Zbatojnë drejtë dispozitën e Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore.

32. Palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë

Praktika gjyqësorë shpeshherë nxjerrë probleme dhe dilema se kush mund ta ketë cilësinë e palës në procedurë, si dhe kush mund të jetë përfaqësues i palës i cili do të mbronte interesat e tij para gjykatës kompetente. Paqartësi paraqiten edhe lidhur me legjitimitetin e palëve në procedurë përkatësisht në kujdesin e gjykatës që paditësi dhe i padituri të jenë të legjitimuar si palë në një proces.

Kush mund të jetë palë në një proces civil? Çka kuptojmë me zotësinë për të qenë palë e çka me zotësinë procedurale dhe kur fitohen ato? Çka është përfa-

qësimi në një proces dhe sa lloje të përfaqësimit kemi? Cilat janë të drejtat dhe detyrat e palëve ndërgjyqëse në proces? Çka kuptojmë me legjitimitetin e palëve? Cili është roli i gjykatës në legjitimitetin e palëve? Çka kuptojmë me legjitimitetin aktiv e çka me atë pasiv?

Gjithashtu ky trajnim do të fokusohet në analizën e praktikës gjyqësore lidhur me procedurën, rolin, të drejtat dhe detyrat e palëve në një proces gjyqësor civil dhe përfaqësimin e tyre.

Përmbajtja

- * Palët, zotësia procedurale dhe zotësia për të qenë palë në procedurë;
- * Përfaqësuesit e palës (përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i personit juridik dhe përfaqësuesi me prokurë);
- * Përfaqësuesi i përkohshëm;
- * Legjitimiteti i palëve në procedurë (legjitimiteti aktiv dhe pasiv).

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Identifikojnë se kush mund ta ketë cilësinë e palës në procedurë;
- * Vlerësojnë se kush mund të jetë përfaqësues i palës dhe kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen në lidhje me këtë çështje;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat e LPK-se lidhur me palët në procedurë dhe përfaqësuesit e tyre.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore.

33. Renta, llojet dhe caktimi i saj

Në praktikën tonë gjyqësore paraqitën konteste të shpeshta për shkak të kompensimit të dëmit dhe njëra ndër kategoritë e dëmit material është edhe renta. Renta si formë e kompensimit të dëmit shpeshherë përbën sfidë për gjykatën në kuptimin e të vlerësuarit për nevojën e caktimit të rentës dhe në kuptimin e përcaktimit të vëllimit të saj. Përveç kësaj, sfiduese paraqitet edhe mënyra e të provuarit dhe forma e caktimit të saj. Në kuptim të këtyre vështirësive që paraqiten në praktikë është menduar se trajtimi i kësaj teme do t'i ndihmoj gjyqtarët që rastet e tilla t'i vendosin duke pasur në konsideratë specifikat e kësaj forme të kompensimit të dëmit.

Cilat kushte duhet të plotësohen që të caktohet renta? Kush mund të jetë përfitues i rentës? Si duhet të provohet e drejta për rentë? Në çfarë forme mund të realizohet renta?

Tematika e trajnimit është strukturuar në mënyrën që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave materialo juridike që i referohen rentës si kategori e dëmit material e po ashtu edhe duke ju referuar praktikës gjyqësore.

Përmbajtja

- * Kuptimi i rentës dhe kushtet që duhet të plotësohen për këtë kategori të dëmit;
- * Përfituesit e rentës;
- * Mënyra e vlerësimit, caktimi i lartësisë dhe format e realizimit të rentës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë kushtet e nevojshme për caktimin e kësaj forme të dëmit;
- * Kuptojnë dhe identifikojnë mënyrën e të provuarit dhe formën e vendosjes për këtë kategori të dëmit;
- * Zbatojnë drejtë dispozita e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore.

34. Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës

Seanca përgatitore është nën faza e fundit e fazës së përgatitjes së shqyrtimit kryesor, në të cilën bëhet sqarimi i çështjeve kontestuese dhe eliminohen pengesat procedurale që kanë të bëjnë me rrjedhën e mëtejme të procedurës. Në praktikën gjyqësore shpesh herë vërehen lëshime të gjykatave në këtë fazë të procedurës, e si rezultat i kësaj proceset gjyqësore përcillen me zgjatje të panevojshme të procedurës, duke krijuar kështu shpenzime të panevojshme procedurale dhe probleme tjera. Shqyrtimi kryesor është faza më e rëndësishme e procedurës kontestimore. Kjo fazë është institucioni qendror i tërë procedurës kontestimore në të cilën bëhet edhe marrja e provave për të vendosur meritorisht në një çështje konkrete.

A është e nevojshme mbajtja e seancës përgatitore? Cilat çështje duhet të qartësohen në seancën përgatitore? Cilat veprime duhet të ndërmerren për caktimin e seancës kryesore? Cilat veprime duhet t'i ndërmarr gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor?

Përmbajtja e trajnimit është strukturuar në mënyrën që të ju përgjigjet pyetjeve të lartpërmendura përmes analizës së të gjitha dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me seancën përgatitore, të shqyrtimit kryesor dhe marrjes së provave.

Përmbajtja

- * Caktimi dhe mbajtja e seancës përgatitore;
- * Veprimet dhe autorizimet e gjykatës;
- * Konvokimi i seancës për shqyrtim kryesor;
- * Zhvillimi i seancës për shqyrtim kryesor dhe mënyra e të provuarit të fakteve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Avancojnë shkathtësitë për mbajtjen e seancës përgatitore;
- * Ndërmarrin veprimet e duhura për konvokimin e seancës kryesore;
- * Zhvillojnë shqyrtimin kryesor pa pengesa dhe të udhëheqin suksesshëm drejtimin e procedurës dhe administrimin e provave.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore.

35. Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgatitja e shqyrtimit kryesor

Shqyrtimi paraprak i padisë është një fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesor lidhur me një çështje juridike. Shqyrtimi paraprak i padisë ka të bëjë me verifikimet se a janë plotësuar prezumimet procedurale për zhvillimin e procedurës kontestimore, nëse ato mund të konstatohen me leximin e padisë. Në këtë fazë të procedurës gjykata vlerëson nëse padia është e kuptueshme, jo e plotë, apo ka mungesa të tjera, në mënyrë që të sigurohet se një çështje kontestimore do të zhvillohet në rrjedha normale dhe të ligjshme. Në praktiken gjyqësore shpeshherë ndodh që për shkak të ngarkesës dhe faktorëve të tjerë gjykatat nuk e kanë vëmendjen e duhur me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, gjë që ndikon negativisht në rrjedhën e procedurës kontestimore dhe në disa raste edhe në

përfundimin e gabuar të gjykatës për çështjen kontestuese.

Cilat prezumime procedurale lidhen me gjykatën, palët dhe me objektin e kontestit? Cilat prezumime procedurale lidhen me rregullsinë e padisë? Cilat veprime duhet t'i ndërmarr gjykata varësisht nga të gjeturat e shqyrtimit paraprak të padisë? Si ndikon shqyrtimi paraprak i padisë në procedimin e mëtejme gjyqësor?

Trajnimi është hartuar të ju përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha prezumimeve procedurale që kanë të bëjnë me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë.

Përmbajtja

- * Padia dhe përmbajtja e saj;
- * Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, për shqyrtimin paraprak të padisë;
- * Veprimet dhe vendimet e gjykatës në shqyrtimin paraprak të padisë;
- * Llojet e vendimeve në këtë fazë të procedurës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zgjerojnë njohuritë lidhur me padinë dhe përmbajtjen e saj;
- * Interpretojnë dhe zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë;
- * Përcaktojnë veprimet për vendimet e gjykatës;
- * Njohin dhe dallojnë llojet e vendimeve në procedurë paraprake.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore.

36. Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit

Ligji i Procedurës Përmbarimore rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Ligji i Procedurës Përmbarimore parashihet prapësimin si mjet juridik me të cilin palët mund të atakojnë vendimin e organit përmbarues, me të cilin është lejuar përmbarimi. Zbatimi i procedurës së përmbarimit nga ana e përmbaruesve privat ka përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtarët dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave, që shpesh marrin një pjesë të rëndësishme të kohës së tyre.

Si vendos përmbaruesi privat lidhur me zbatimin e përmbarimit? Kush vendos lidhur me kundërshtimin kundër urdhrin përmbarues? Cila është kompetenca territoriale e përmbaruesve privat dhe gjykatave? Në cilat raste gjykata lejon dhe zbaton përmbarimin?

Trajnimi synon që përmes analizës së dispozitave ligjore dhe diskutimeve interaktive të ofroj alternativat dhe praktikat më të mira për dilemat që hasen nga gjyqtarët lidhur me çështjet e përmbarimit.

Përmbajtja

- * Bazat juridike për caktimin e përmbarimit;
- * Kushtet për lejimin e përmbarimit;
- * Kompetenca për vendosje lidhur me Prapësimin dhe shkaqet për paraqitjen e tij.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë se cilat janë dokumentet përmbaruese dhe dokumentet e besueshme;
- * Kategorizojnë dhe vlerësojnë rastet kur përmbarimin e zbaton përmbaruesi privat e kur gjykata;
- * Vlerësojnë mjetet juridike në procedurën përmbarimore.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe të Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

37. Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë

E drejta e pronësisë është një prej të drejtave elementare të garantuara me Kushtetutë dhe akte të tjera ndërkombëtare. Çdo cenim i të drejtës së pronësisë, pronarit i jep të drejtë që të kërkojë mbrojtje gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë. Trajtimi i kësaj teme për gjyqësorin shtrohet si domosdoshmëri për shkak të ndryshimeve në legjislacionin vendor dhe standardeve të përcaktuara me protokollin 1 të KEDNJ-së.

Cilat janë llojet e padive që paraqiten për mbrojtjen e pronësisë në të drejtën krahasuese dhe në legjislacionin vendor? Çfarë mbrojtje i jepet sipas Kushtetutës të drejtës së pronësisë? Cilat janë autorizimet dhe kufizimet e së drejtës së pronësisë?

Gjithashtu me këtë trajnim synohet të sqarohen dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore lidhur me paditë për mbrojtjen e pronësisë.

Përmbajtja

- * Mbrojtja e të drejtës së pronësisë në përgjithësi;
- * Paditë për mbrojtjen e pronësisë;
- * Padia e rivendikimit, padia negatorë dhe padia publiciane;
- * Protokollin 1 i KEDNJ-së.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë të drejtën e pronësisë, autorizimet, kufizimet si dhe mbrojtjen e saj;
- * Interpretojnë dhe krahasojnë llojet e padive për mbrojtjen e pronësisë;
- * Zbatojnë standardet dhe kërkesat nga praktika e GJEDNJ-së, lidhur me rastet e mbrojtjes së të drejtës së pronësisë.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit, si dhe bashkëpunëtorët profesional.

38. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj

Praktika gjyqësore shpesh ballafaqohet me rastet lidhur me caktimin e kontributit të pjesës së bashkëshortëve në pasurinë e fituar gjatë ekzistimit të bashkësisë martesore. Vendimi i gjykatës duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të drejtë të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Këto konteste kanë rëndësi të veçantë edhe për faktin se janë mjaft të ndjeshme, për këtë arsye natyra e vendosjes në mënyrë profesionale ka rëndësi si për palët ashtu edhe për shoqërinë.

Si caktohet kontributi i bashkëshortëve në fitimin e pronësisë së përbashkët të tyre? Cilat janë kriteret për caktimin e kontributit të bashkëshortëve? Kur mund të kërkohet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët, kush mund të kërkojë dhe në çfarë kohe? Si bëhet administrimi i kësaj pasurie para pjesëtimit të saj?

Tematika e trajnimit është strukturuar në mënyrën që të përgjigjet në dilemat që paraqiten në praktikën e gjykatave lidhur me dallimet në mes pronësisë së përbashkët e veçmas pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve. Fokusim i veçantë do të jetë pjesëtimi dhe ndarja e këtyre formave të pronësisë kur shumë subjekte kanë të drejtën e pronësisë në një send si dhe mënyra e administrimit të këtyre formave të pronësisë.

Përmbajtja

- * Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve;
- * Vërtetimi i kontributit të bashkëshortëve;
- * Administrimi i pasurisë së përbashkët dhe bashkëpronësisë;
- * Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë këto forma të pronësisë;
- * Përkufizojnë të drejtat e pronarëve të përbashkët, veçmas të drejtën dhe mënyrën e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët;
- * Vendosin drejtë në rast kontesti të këtyre formave të pronësisë.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.

39. Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj

Ligji për Trashëgiminë ka paraparë trashëgimtarët e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë dhe procedurën gjyqësore e cila ka të bëjë me shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit. Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë i takon vetëm trashëgimtarëve të domosdoshëm të trashëgimisë në pjesën që u takon sipas ligjit. Në praktikën gjyqësore ka vështirësi dhe sfida rreth përcaktimit të vëllimit të pjesës së domosdoshme dhe personave që e gëzojnë këtë të drejtë. Në këtë kontekst është i rëndësishëm edhe unifikimi i praktikës gjyqësore, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me faktin se kush ka të drejtë të vendos në lidhje me zhvillimin e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

Cila është pjesa e domosdoshme e trashëgimisë? Cili është rrethi i trashëgimtarëve që kanë të drejtë në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë? Si llogaritet pjesa e domosdoshme e trashëgimisë? Me cilat punë juridike mund të cenohet pjesa e domosdoshme e trashëgimisë?

Përmes trajtimit teorik të elementeve të trashëgimisë, bazave të trashëgimisë dhe procedurave që aplikohen në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore synohet që të eliminohen dilemat që shfaqen në këtë fushë. Po ashtu do të përdoren raste hipotetike dhe detyra për punë në grupe.

Përmbajtja

- * Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe trashëgimtarët;
- * Trashëgimtarët e domosdoshëm dhe llogaritja e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë;
- * Cenimi i pjesës së domosdoshme;
- * Rrethi i trashëgimtarëve që kanë të drejtë në pjesën e domosdoshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Përkufizojnë pjesën e domosdoshme të trashëgimisë;
- * Identifikojnë trashëgimtarët e domosdoshëm dhe llogarisin drejtë pjesën e tyre;
- * Identifikojnë dhe kategorizojnë cenimet e pjesës së domosdoshme;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit mbi Trashëgiminë.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.

40. Shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar

Zhvillimi ekonomik dikton nevojën e shpronësimeve të shpeshta. Zhvillimi i procedurës së rregullt gjyqësore sipas dispozitave ligjore, pronarëve ju garanton të drejtën në pronë përmes kompensimit real për shpronësim. Por në raste të shpeshta nuk arrihet marrëveshje jashtëgjyqësore për shkak të lartësisë së ofruar të kompensimit, prandaj këto raste kalojnë në gjykata.

Kur dhe në çfarë kushte mund të shpronësohet një paluajtshmëri? Cili organ zhvillon procedurën e

shpronësimit? Çka duhet t'i paraprijë shpronësimit? Kush e cakton kompensimin për paluajtshmëri të shpronësuar? Si caktohet dhe cilat janë kriteret për caktimin e kompensimit për paluajtshmëri të shpronësuar?

Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizoj dhe zbërthej procedurën e shpronësimit, të identifikoj kushtet paraprake për shpronësim, dhe rastet kur organi shpronësues është komuna dhe kur organ shpronësues është qeveria.

Përmbajtja

- * Organi kompetent për shpronësim;
- * Procedura e cila duhet t'i paraprijë shpronësimit;
- * Procedura e vlerësimit të pasurisë e cila është objekt i shpronësimit dhe caktimi i kompensimit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Identifikojnë organin kompetent për shpronësim;
- * Zbërthejnë dhe vlerësojnë procedurën e shpronësimit;
- * Analizojnë dhe zbatojnë drejtë procedurën e vlerësimit të pasurisë dhe caktimit të kompensimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit, bashkëpunëtorët profesional, si dhe zyrtar nga Ministria e Financave.

41. Sigurimi i kërkesëpadisë

Ligi për Procedurën Kontestimore në kreun XXI parasheh institutin e sigurimit të kërkesëpadisë, i cili i ofron mbrojtje juridike palëve në kontest në situatat kur ekziston rreziku se zbatimi i sanksionit juridik civil nuk jep rezultatin e duhur. Mbrojta e tillë juridike ofrohet me caktimin e masave të sigurisë të parapara me dispozitat e LPK-së, me të cilat sigurohet kërkesa e paditësit deri në përfundim të procedurës me vendim të formës së prerë. Masat e përkohshme për sigurimin e kërkesëpadisë janë veprimet e gjykatës me anën e të cilave sigurohet pala e cila pretendon se do të ketë sukses në procedurë dhe këtë e bën të justifikueshme me kërkesën e vet se kërkesa e saj mund të realizohet në të ardhmen duke ndërmarrë masat e duhura për pamundësinë e pengimit të realizimit të kësaj kërkesë.

Kush mund të parashtrijë propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë? Në cilën fazë të procedurës mund të paraqitet propozimi? Cila gjykatë është kompetente për të vendosur për masën e sigurisë varësisht prej fazës kur është paraqitur propozimi? Cili është dallimi në mes të masës së sigurimit të kërkesëpadisë dhe masës së përkohshme sigurorese?

Përmbajtja e trajnimit është strukturuar në atë mënyrë që të adresoj situata të ndryshme kur ballafaqohen gjyqtarët në rastet e trajtimit të kërkesëpadisë. Po ashtu përmes diskutimeve grupore dhe rasteve praktike do të ofrohen zgjidhje dhe alternativa më të mira për rastet e kësaj natyre.

Përmbajtja

- * Llojet e masave të sigurimit të kërkesëpadisë;
- * Kompetenca për të vendosur për masat e sigurimit të kërkesëpadisë;
- * Masat e përkohshme dhe kohëzgjatja e tyre;
- * Dallimi në mes të masës së përkohshme sigurorese dhe masës sigurorese;
- * Garancioni me rastin e caktimit të masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin dhe dallojnë llojet e masave të sigurimit të kërkesëpadisë;
- * Përcaktojnë kompetencën e gjykatës e cila duhet të vendos lidhur me këto masa;
- * Të identifikojnë masat e përkohshme dhe kohëzgjatjen e tyre;
- * Bëjnë dallimin e masave të përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë prej masave sigurorese.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional.

42. Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje

Dhuna në familje është ndër veprimet e dëmshme përmes të cilave shkelen të drejtat e njeriut si dhe rrezikohen vlera të çmueshme të individit dhe shoqërisë. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore të cilat i përkasin çdo qenie njerëzore. Dhunë në familje konsiderohet çdo shkelje e të drejtës së gruas, burrit dhe fëmijëve nga persona që janë pjesëtarë të familjes. Rastet e dhunës në familje bëhen edhe më të vështira dhe sfiduese për institucionet përgjegjëse kosovare në luftimin e kësaj dukurie edhe për shkak të ndikimit të mënyrës së jetës së familjeve kosovare të cilat çështjet familjare i trajtojnë si çështje të brendshme.

Çfarë është dhuna në familje? Cilët faktorë çojnë drejt dhunës në familje? Cilat janë pasojat e dhunës në familje? Kush mbrohet nga ligji? Kush mund të kërkojë një urdhër mbrojtjeje? Çfarë informacioni duhet të përfshijë kërkesa për urdhërmbrojtje? Kush njoftohet për urdhrin e mbrojtjes? Cilët janë urdhrat për mbrojtje?

Tematika e trajnimit është strukturuar në mënyrën që t'iu përgjigjet dilemave të cilat vazhdimisht i përcjellin gjyqtarët gjatë trajtimit të pretendimeve të palëve për dhunën në familje. Gjithashtu synohet që pjesëmarrësit të kenë mundësi që përmes elaborimit të rasteve studimore, diskutimeve dhe punës në grupe të avancojnë njohuritë në zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Përmbajtja

- * Dhuna në familje dhe urdhri për mbrojtje;
- * Procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje;
- * Llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre;
- * Ekzekutimi dhe pasojat e moszekutimit të urdhrin për mbrojtje.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Të përkufizojnë format e dhunës në familje dhe shpjegojnë urdhrin për mbrojtje;
- * Aplikojnë drejtë procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje;
- * Zbatojnë në mënyrë efektive dispozitat lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje;
- * Krahasojnë specifikat e formave të dhunës në familje në procedurë civile dhe penale.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit-divizioni civil, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni civil si dhe bashkëpunëtorët profesional.

43. Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes

Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër. Ndërsa fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese. Një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësive në pajtim me Ligjin. Nga fakti se nga hyrja në fuqi të Ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes është dekriminalizuar fyerja dhe shpifja, tani paraqiten sfida të reja për gjyqtarët që të gjykojnë

paditë që për bazë kanë kompensimin e dëmit në rastet e shpifjes dhe fyerjes.

Cilat janë masat për mbrojtje nga shpifja dhe fyerja? Kush mund të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje? Cilat janë rastet kur përjashtohet përgjegjësia për kompensimin e dëmit tek shpifja dhe fyerja? Cilat janë mënyrat e kompensimit në rastet e shpifjes dhe fyerjes? Cilat janë afatet ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes? Kush ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastet e cekura më lartë?

Përmbajtja e trajnimit është strukturuar në atë mënyrë që t'iu përgjigjet dilemave të cilat vazhdimisht i përcjellin gjyqtarët gjatë trajtimit të pretendimeve të palëve për shpifje dhe fyerje.

Përmbajtja

- * Masat për mbrojtjen nga shpifja dhe fyerja;
- * Përgjegjësia dhe rastet e përjashtimit nga përgjegjësia të shpifja dhe fyerja;
- * Kompensimi për shpifjen dhe fyerjen;
- * Afatet, mbrojtja e burimeve dhe gjykata kompetente.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes;
- * Analizojnë dhe interpretojnë drejtë dispozitat lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas padive për kompensimin e dëmit në rastet e shpifjes dhe fyerjes;
- * Zbatojnë standardet dhe kërkesat që dalin nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane, me rastin e vendosjes së kërkesëpadive tek fyerja dhe shpifja.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit - divizioni civil, gjyqtarët e gjykatave themelore - divizioni civil si dhe bashkëpunëtorët profesional.

44. Procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës

Meqenëse në gjykatë paraqiten raste të shumta, përmes të cilave palët (bashkëshortët) kërkojnë zgjidhjen e martesës së tyre, shpeshherë gjyqtarët hasin vështirësi në zhvillimin e kësaj procedure, për shkak se përveç zgjidhjes së martesës, të njëjtit duhet të vendosin edhe për të drejtat e fëmijëve të lindur në martesë, siç janë besimi i tyre në kujdes, mbajtje dhe edukim, caktimin e alimentacionit, si dhe vendosjen e kontakteve personale me prindin tjetër. Kjo edhe për faktin se procedura për zgjidhjen e martesës hyn në kategorinë e procedurës së veçantë, për zhvillimin e së cilës, përveç dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), si ligj procedural, zbatohen edhe dispozitat ligjore të Ligjit për Familjen, si ligj material, i cili në përmbajtje të tij ka edhe rregulla të veçanta, që rregullojnë kompetencën

e gjykatës (edhe asaj funksionale) me rastin e vendosjes së këtyre kontesteve dhe jo vetëm.

Në cilat raste mund të kërkohej anulimi i martesës dhe kush mund të iniciojë procedurën për anulim? A parashihet Ligji për Familjen ndonjë afat kohor se deri kur mund të parashihet padia për anulimin e martesës? Cilat janë shkaqet ligjore si rezultat i të cilave martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim?

Ky trajnim është strukturuar në atë mënyrë që të përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe dilemat, duke analizuar gjithanshëm edhe legjislacionin e zbatueshëm që i referohet procedurës gjyqësore për zgjidhjen e martesës.

Përmbajtja

- * Procedura e zgjidhjes së martesës me anulim;
- * Procedura e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim;
- * Parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit dhe kompetenca e gjykatës;
- * Mënyra e vendosjes dhe mjetet juridike tek shkurorëzimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me procedurën e zgjidhjes së martesës me anulim dhe shkurorëzim;
- * Interpretojnë drejtë parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit dhe kompetenca e gjykatës;
- * Zgjerojnë njohuritë lidhur me mënyrën e vendosjes dhe vlerësojnë mjetet juridike tek shkurorëzimi.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit-divizioni civil, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni civil si dhe bashkëpunëtorët profesional.

45. Anulimi i kontratave

Kontrata paraqet një nga burimet më të rëndësishme të detyrimeve dhe njëkohësisht institucionin qendror të komunikimit juridik në mes të palëve kontraktuese. Që kontrata të jetë e vlefshme, palët kontraktuese duhet të plotësojnë disa nga kushtet e parapara me ligj, ndërsa në rastet kur kontrata është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë, atëherë vije deri te nuliteti i kontratës. Në rastet kur kontrata është lidhur nga pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve atëherë vije deri tek rrëzueshmëria e kontratës. Në praktikë ka shumë raste kur palët kontraktuese nuk respektojnë kushtet e parapara për vlefshmërinë e kontratës dhe trajtimi i kësaj teme do të ndihmonte në analizimin dhe shtjellimin e shkaqeve në bazë të cilave mund të vije deri të anulimi dhe rrëzueshmëria e kontratës.

Cilat kontrata konsiderohen absolutisht nule e cilat të rrëzueshme? Mënyra e vendosje në këto raste? Në cilat raste bëhet konversioni? Kush mund të kërkojë nultitetin dhe anulimin e kontratave?

Kjo temë është strukturuar në atë mënyrë që të u jepet përgjigje pyetjeve lidhur me kushtet të cilat duhet plotësuar për të ardhur deri të anulimi i kontratave dhe rrëzueshmërisë së tyre, mënyrën e vendosjes dhe vlerësimi i afateve ligjore në raste të tilla.

Përmbajtja

- * Kontratat nule;
- * Kontratat e rrëzueshme;
- * Pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave;
- * Konversioni.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për tu konsideruar një kontratë nule dhe e rrëzueshme;
- * Njohin dhe identifikojnë pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat e LMD-së lidhur me pavlefshmërinë e kontratave.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit.

46. Bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë

Gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore në një çështje juridike kontestimore mund të ndodh që në anën e palëve të paraqiten më shumë subjekte të cilët në pikëpamje të objektit të kontestit janë në një bashkësi juridike ose detyrimet e tyre burojnë nga e njëjta bazë, apo detyrimet e të njëjtit lloj mbështeten në bazë faktike dhe juridike esencialisht të njëjtë. Përveç bashkëndërgjyqësisë në procedurën kontestimore ndodh që në anën e palës paditëse apo të paditur mund të ndërhyjnë persona të tretë të cilët i bashkëngjiten njërës palë për ta ndihmuar atë si ndërhyrës në procedurë ose kur personat e tretë ndërhyjnë si ndërhyrës kryesor me kërkesë të veçantë për të kundërshtuar kërkesat e të dy palëve. Çështja e bashkëndërgjyqësisë dhe personave të tretë në procedurë, në praktikën gjyqësore paraqet një fenomen procedural mjaft kompleks i cili krijon dilema për gjyqtarët të cilët i zhvillojnë procedurat kontestimore.

Cilat janë llojet e bashkëndërgjyqësisë? Si të vepohet në pikëpamje procedurale dhe si të vendoset në rastet e bashkëndërgjyqësisë? Cila është mënyra e ndërhyrjes së personit të tretë në procedurë dhe çfarë lloje të ndërhyrjeve ekzistojnë? Cilat veprime procedurale mund t'i ndërmarrin personat e tretë në mënyrë te pavarur nga palët ndërgjyqësore?

Kjo temë është hartuar në atë mënyrë që tu jep përgjigje të gjitha pyetjeve që ndërlidhen me bashkëndërgjyqësinë, llojet e bashkëndërgjyqësisë, efektet që krijojnë secili lloj i bashkëndërgjyqësisë në procedurën kontestimore, mënyrën e vendosjes për secilën formë të bashkëndërgjyqësisë, pjesëmarrjen e personave të tretë në procedurën kontestimore, llojet e ndërhyrjes dhe veprimet që mund të ndërmerren nga ndërhyrësit.

Përmbajtja

- * Bashkë-ndërgjyqësit;
- * Llojet e bashkë-ndërgjyqësisë;
- * Efektet e veprimeve procedurale të bashkë-ndërgjyqësve;
- * Pjesëmarrja e personave të tretë në kontest civil dhe ndërhyrësit;
- * Efekti i aktgjykimit ndaj bashkë-ndërgjyqësve dhe ndërhyrësve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë bashkë-ndërgjyqësit dhe llojet;
- * Vlerësojnë efektet e veprimeve procedurale të bashkë-ndërgjyqësve;
- * Identifikojnë personat e tretë në konteste civile dhe ndërhyrësit;
- * Njohin efektin e aktgjykimit tek bashkë-ndërgjyqësit dhe ndërhyrësit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni civil.

47. Kompensimi i dëmit jomaterial

Përveç kompensimit të dëmit material, që paraqet shkeljen e të mirave pasurore, ekziston edhe dëmi jo material që paraqet shkeljen e të mirave jo pasurore. Dëmi si një nga burimet e veçanta materiale të marrëdhënieve të detyrimeve, lind nga fakti se tjetrit i është shkaktuar dëmi dhe paraqitet nevoja që ai t'i shpërblehet atij. Në bazë të kompensimit të dëmit jo material, nuk rivendoset gjendja e cila ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit por ndikon në zbutjen e dhimbjeve shpirtërore të pësuar për shkak të shkeljes së të mirave jo materiale. Duke u nisur nga fakti se numri i rasteve gjyqësore dhe dilemave në prak-

tikë, që i referohen kërkesave për kompensim të dëmit (jomaterial) është i lartë, bëjnë që kjo temë të jetë e rëndësishme për trajtim.

Çka kuptojmë me dëmin jo material? Cilat kritere duhet të merren për bazë për caktimin dëmit? Cilat janë bazat e përgjegjësisë?

Kjo temë është përzgjedhur dhe strukturuar në mënyrën që t'iu përgjigjur pyetjeve dhe dilemave të ngritura e duke analizuar rastet nga praktika gjyqësore lidhur me kompensimin e dëmit jo material.

Përmbajtja

- * Bazat e përgjegjësisë për dëmin jomaterial;
- * Kriteret për përcaktimin e dëmit jomaterial;
- * Shpërblimi (kompensimi) i dëmit jomaterial.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Interpretojnë drejt dispozitat lidhur me përgjegjësinë dhe format e dëmit jomaterial;
- * Vlerësojnë kriteret për përcaktimin e dëmit jomaterial;
- * Zbatojnë dispozitat për lartësinë për shpërblimin e dëmit jomaterial.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore - divizioni civil.

48. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndër të tjera, rregullon edhe përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme, përgjegjësinë për marrjen e kundërligjshme të sendit të rrezikshëm nga zotëruesi, përgjegjësinë për dorëzimin e sendit personit të tretë, përgjegjësia për të metat e produkteve dhe rastet e veçanta të përgjegjësisë. Marr për bazë numrin e rasteve dhe dilemave në praktikën gjyqësore që i referohen kërkesave për kompensim të dëmit nga këto baza, bëjnë që kjo temë të jetë e rëndësishme për trajtim.

Çka kuptojmë me dëmin nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme? Cilat kushte duhet plotësuar për të ardhur në shprehje përgjegjësia e tillë? Në cilat raste mundë të kemi lirim nga kjo përgjegjësi?

Kjo temë është caktuar për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe dilemave të ngritura e duke analizuar rastet nga praktika gjyqësore, lidhur me kompensimin e dëmit nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme që ndryshe njihet si përgjegjësi objektive dhe rastet e lirimit nga kjo përgjegjësi.

Përmbajtja

- * Përgjegjësia për dëmin nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme dhe llojet;
- * Kushtet për kompensimin e këtij dëmi;
- * Kushtet për lirim nga përgjegjësia për dëmin nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Interpretojnë drejt dispozitat lidhur me përgjegjësinë për dëmin nga sendi dhe veprimtarin e rrezikshme;
- * Analizojnë dhe zbërthejnë situatat kur nuk ka përgjegjësi civile mbi këtë bazë;
- * Vlerësojnë lartësinë e shpërblimit mbi bazën e përgjegjësisë objektive.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore.

49. Procedura e vendosjes sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme

Ligji i Procedurës Kontestimore ka paraparë mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve. Ankesa është mjet i rregullt juridik me të cilën palët gëzojnë të drejtën e kontestimit të vendimeve gjyqësore që nuk kanë marrë formën e prerë. Ndërsa me mjetet e jashtëzakonshme juridike, siç janë revizioni kundër aktgjykimit dhe ai kundër aktvendimit, kërkesa për përsëritjen e procedurës, dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, goditen vendimet e formës së prerë. Në praktikën gjyqësore shpeshherë paraqiten këto mjete juridike pa i plotësuar kushtet formale dhe ligjore lidhur me përmbajtjen dhe lejueshmërinë e tyre.

Çka duhet të përmbajnë mjetet e rregullta dhe ato të jashtëzakonshme? Cilat janë shkaqet me të shpeshta për paraqitjen e tyre si dhe efektet? Cila është procedura e pranimit dhe shqyrtimit të këtyre mjeteve? Cilat vendime mund t'i marrin gjykatat lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike?

Kjo tematikë ka përmbajtje dhe është strukturuar në atë mënyrë që jepen shpjegime dhe sqarime lidhur me të drejtën dhe mundësinë e ushtrimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme si dhe vlerësimit dhe respektimit të afateve ligjore për këto mjete.

Përmbajtja

- * Ankesa si mjet i rregullt juridik dhe shkaqet ankimore;
- * Kufijtë e ekzaminimit dhe vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me vendosjen për ankesën;
- * Revizioni dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
- * Përsëritja e procedurës;
- * Vendosja sipas mjeteve të jashtëzakonshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë ankesën si mjet juridik dhe vlerësojnë shkaqet ankimore;
- * Vlerësojnë kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën;
- * Zbërthejnë mjetet e jashtëzakonshme juridike;
- * Vlerësojnë revizionin, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe propozimin për përsëritjen e procedurës.

Kohëzgjatja



Përfituesit



Një ditë

Gjyqtarët e gjykatave themelore - divizioni civil.

Drejtësia për Fëmijë - Lëmia penale

50. Masat e Diversitetit

Të miturit si kryerës të veprave penale kanë pjesëmarrje bukur të theksuar në kriminalitetin e përgjithshëm, gjë që dëshmohet nga statistikat në nivel shtetëror, e cila kërkon mobilizim të gjitha strukturave të shtetit që të miturve tu kushtohet kujdes më i madh. Duke marrë për bazë interesin më të mirë të të miturit, Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë masat e diversitetit që mund t'iu shqiptohen kryesve të mitur të veprave penale me qëllim të parandalimit të fillimit të procedurës përgatitore për të mitur, ekskluzivisht në rastet kur kryesit e mitur kanë kryer veprën penale për të cilën parashihet dënimi me gjobë ose dënimi me burg deri në tri vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.

Cilat janë llojet e masave të diversitetit? Cilat janë kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit? Si zhvillohet procedura për shqiptimin e masave të diversitetit? Si ndikojnë këto masa në ri-integrimin e të miturit?

Kjo temë është hartuar të ofrojë njohuritë dhe shkathtësitë adekuate në zbatimin e dispozitave ligjore me rastin e shqiptimit të masave të diversitetit për të mitur në frymën e konventave dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Përmbajtja

- * Masat e diversitetit të parapara me Kodin e Drejtësisë për të Mitur;
- * Kushtet të cilat duhet plotësuar që të miturit t'i shqiptohet ndonjëra prej masave të diversitetit;
- * Llojet e masave të diversitetit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë drejt dispozitat e Kodit për Drejtësinë për të Mitur për shqiptimin e masave të diversitetit;
- * Vlerësojnë kushtet ligjore për shqiptimin e këtyre masave.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe prokurorët e prokurorive themelore - Departamenti për të Mitur.

51. Dënimet që u shqiptohen të miturve

Kodi i Drejtësisë për të Mitur përcakton kushtet kur një të mituri mund t'i shqiptohen dënimet. Kodi parasheh gjobën, urdhrin për punë në dobi të përgjithshme dhe burgun për të mitur, si sanksione që mund tu shqiptohen të miturve si kryerës të veprave që bien ndesh me ligjin. Kodi garanton që interesi më i lartë i fëmijës të përcaktohet me kujdes në sistemin e drejtësisë si dhe do ta sjellë sistemin e drejtësisë për të miturit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Cilat janë llojet e dënimeve të cilat mund tu shqiptohen të miturve? Cilat janë kushtet për shqiptimin e sanksioneve ndaj të miturve? Si ndikon privimi i lirisë në rehabilitimin e të miturit? A mund të parashkruhet ekzekutimi i burgut për të mitur?

Kjo temë është hartuar të ofrojë njohuritë dhe shkathësitë adekuate në zbatimin e dispozitave ligjore me rastin e shqiptimit të dënimeve për të mitur në frymën e konventave dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Përmbajtja

- * Llojet e dënimeve të cilat mund tu shqiptohen të miturve;
- * Kushtet të cilat duhet plotësuar që të miturit t'i shqiptohet ndonjëra prej dënimeve;
- * Përcaktimi i kohëzgjatjes së urdhrin për punë në dobi të përgjithshme;
- * Përcaktimi i kohëzgjatjes së burgut për të mitur.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë llojet e dënimeve për të mitur;
- * Identifikojnë kushtet ligjore për shqiptimin e këtyre dënimeve;
- * Shqiptojnë drejtë kohëzgjatjen e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme;
- * Dallojnë kushtet për caktimin dhe kohëzgjatjen me rastin e caktimit të paraburgimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe prokurorët e prokurorive themelore - Departamenti për të Mitur.

52. Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve

Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve dallon nga ekzekutimi i dënimeve ndaj madhorëve. Gjykata ka një rol shumë të madh në ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj të miturit. Kodi i Drejtësisë për të Mitur parasheh dispozita të qarta lidhur me ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për të mitur. Në praktikën gjyqësore janë vërejtur vështirësi gjatë ekzekutimit të masave dhe dënimeve për të mitur, andaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të posaçme në unifikimin e praktikave me rastin ekzekutimit të masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve.

Si të veprohet në rastet kur i mituri nuk përmbush detyrimet e caktuara? Si zhvillohet procedura e ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturit? Roli i shërbimit sprovues në ekzekutimin e masave dhe dënimeve që shqiptohen ndaj të miturve?

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, do të analizohen situata të ndryshme me të cilat do të mund të ballafaqohen gjyqtarët në praktikë.

Përmbajtja

- * Ekzekutimi i masave të diversitetit dhe masave edukative;
- * Ekzekutimi i gjobës dhe urdhrit për punë në dobi të përgjithshme;
- * Procedura e shqyrtimit, zëvendësimit dhe pushimit të masave edukative;
- * Ekzekutimi i burgut për të mitur.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë drejtë rolin e gjyqtarit për të mitur në procedurën e ekzekutimit të masave dhe dënimeve për të mitur;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat e shqyrtimit, dhe zëvendësimit të masave dhe dënimeve;
- * Identifikojnë rastet kur të miturve duhet pushuar ekzekutimin masave dhe dënimeve.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave dhe prokurorët e nivelit themelor - Departamenti për të Mitur.

53. Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor

Në praktikë ka mjaftë raste kur të miturit kryejnë vepra penale së bashku me persona madhor. Mirëpo, procedura ndaj të miturit nuk është identike në procedurën ndaj personave madhor. Ajo përveç tjerash është urgjente, apo në të marrin pjesë persona dhe institucione që nuk marrin pjesë në procedurën ndaj madhorëve. Për më tepër afatet procedurale janë më të shkurtra.

Cila procedurë zbatohet kur i mituri kryen vepër penale me madhorin? A duhet zhvilluar procedurë e ndarë, a mund të bashkohet procedura, nëse po, në të cilat raste? Cilat dispozita zbatohen në procedurën e bashkuar?

Ky trajnim është organizuar të përgjigjet në pyetjet lidhur me këtë çështje duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje. Gjithashtu do të analizohen problemet praktike përmes diskutimeve dhe studimit të rasteve hipotetike.

Përmbajtja

- * Procedura penale në rastet kur i mituri kryen vepër penale me të rritur;
- * Bashkimi i procedurës së të miturit me madhor dhe dispozitat të cilat aplikohen në procedurën e bashkuar;
- * Përparësitë dhe mangësitë e procedurës së bashkuar.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zgjerojnë njohuritë lidhur me procedurën penale kur i mituri kryen vepër penale me të rritur;
- * Interpretojnë drejtë dispozitat lidhur me bashkimin e procedurës kur i mituri kryen vepër penale me të rritur;
- * Identifikojnë përparësitë dhe mangësitë e procedurës së bashkuar.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor.

54. Masat edukative ndaj të miturve

Drejtësinë për të mitur në Kosovë e përshkojnë një numër i madh i parimeve, disa prej të cilave janë universale. Ndër parimet e veçanta dhe specifike është që kryerësve të mitur sipas nevojës u shqiptohen masat e ndryshme në vend të dënimeve. Masat që mund t'i shqiptohen kryerësve të veprave penale nuk kanë kufizim nga ana ligjore, pra mund t'i shqiptohen çdo të mituri nga mosha 14–21 vjet. Edhe pse sipas parimeve të KDM-së shqiptimi i këtyre masave do të duhej të konsiderohej si alternativ e parë, në praktikë jo çdo herë janë të aplikueshme. Si faktorë për mos zbatim shpesh konsiderohet anketa sociale jo e plotë apo jo profesionale, dhe mos vlerësimi i drejtë i përfitimeve të këtyre masave.

Cilat janë llojet e masave edukuese të cilat mund tu shqiptohen të miturve? Si bëhet përzgjedhja e këtyre masave? Çka konsiderohet anketë e plotë sociale? Cilat janë përfitimet e këtyre masave? Si ta vlerësojmë arrijtjen e qëllimit të masave edukuese?

Ky trajnim është organizuar të përgjigjet në pyetjet lidhur me këtë çështje duke analizuar dhe sqaruar dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje. Gjithashtu do të analizohen problemet praktike përmes diskutimeve dhe studimit të rasteve hipotetike.

Përmbajtja

- * Llojet e masave edukuese të cilat mund tu shqiptohen të miturve;
- * Kushtet të cilat duhet plotësuar që të miturit t'i shqiptohet masë edukuese;
- * Përcaktimi i kohëzgjatjes së masave edukuese.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë masat edukuese të parapara me KDM;
- * Vlerësojnë drejtë kushtet për shqiptimin e këtyre masave;
- * Përcaktojnë kohëzgjatjen e masave edukuese.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur, zyrtarët nga Shërbimi Sprovues.

55. Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë

Me qëllim të sigurisë së prezencës së të miturit dhe efikasitetit të procedurës penale, ndaj të miturit mund të caktohen masat e parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Pra në kushte të veçanta ndaj të miturit mund të shqiptohet edhe paraburgimi. KDM i ka kushtuar rëndësi të posaçme interesit më të mirë të të miturit. Sipas këtij kodi, ndaj të miturit mund të urdhërohet arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi vetëm si masë e fundit për një kohë sa më të shkurtër. Në procedurën ndaj të miturve paraburgimi si masë e fundit shpesh nuk është caktuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara nga KDM.

Pse të miturit i caktohet paraburgimi kur me ligj mund t'i caktohen edhe masa tjera? Cilat janë kushtet të cilat duhet plotësuar me rastin e shqiptimit të paraburgimit apo masave tjera alternative?

Përmes këtij trajnimi synohet që përfituesit të mund të analizojnë masat e sigurisë së të miturit në procedurë dhe t'i tejkalojnë dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja

- * Masat për sigurimin e pranisë e të miturit në procedurë penale;
- * Kushtet të cilat duhet plotësuar me rastin e shqiptimit të paraburgimit apo masave tjera alternative kundruall paraburgimit;
- * Shqiptimi i paraburgimit si masë e fundit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Interpretojnë drejtë rregullat me rastin zgjedhjes së masave për prezencën e të miturit në procedurë;
- * Përcaktojnë drejtë masën e kufizimit të lirisë;
- * Vlerësojnë drejtë kohëzgjatjen e masave të privimit nga liria.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor - Departamenti për të Mitur.

56. Shqyrtimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturve

Shqyrtimi gjyqësor për të mitur zbatohet përshtatshëm me dispozitat e KPPK, por gjithsesi me disa karakteristika që aplikohen në procedurën ndaj të miturve. Në praktikën gjyqësore, janë paraqitur mjaft vështirësi dhe konfuzione me rastin e aplikimit të dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit gjyqësor në procedurën penale ndaj të miturve, andaj trajnimi i kësaj teme vlerësohet i rëndësishëm në drejtim të evitimit të paqartësive që hasen në praktikën gjyqësore aktuale.

Cila është rrjedha e shqyrtimit gjyqësor në procedurën ndaj të miturve? Cili është roli i gjyqtarit dhe prokurorit në këtë fazë? Si do të rrjedh seanca për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me shqiptimin e sanksionit penal për të mitur?

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, do të analizohen situata të ndryshme të cilat mund të hasen gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përmbajtja

- * Shqyrtimi gjyqësor në procedurën për të mitur;
- * Roli i gjyqtarit dhe prokurorit gjatë procedurës së të miturve;
- * Vërtetimi i fakteve relevante për shqiptimin e sanksionit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zhvillojnë drejtë shqyrtimin gjyqësor ndaj të miturve;
- * Zbatojnë drejtë rolin e gjyqtarit dhe/apo prokurorit për të mitur gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- * Zbatojnë drejtë afatet ligjore për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor - Departamenti për të Mitur.

57. Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve

Fëmijët janë kategoria më e ndjeshme e shoqërisë për të cilët shteti me mekanizmat e tij është i obliguar të kujdeset dhe të ju ofroj mbrojtje. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në kuadër të kapitullit veprat penale kundër integritetit seksual ndër të tjera parashih edhe disa vepra që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët.

Cilat janë veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve sipas Kodit Penal të Kosovës? Cilat janë elementet dhe karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve?

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimit në grupe, do të ofrohen alternativa për shumë çështje që kanë të bëjnë me veprat penale kundër integritetit seksual. Trajtimi i këtyre çështjeve do të bëhet përveç tjerash, edhe me një pjesëmarrje dhe diskutim interaktiv me pjesëmarrësit, për t'u përgjigjur edhe në të gjitha pyetjet dhe dilemat që mund të paraqiten në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja

- * Veprat penale kundër integriteti seksual sipas Kodit Penal;
- * Elementet dhe karakteristikat e veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve;
- * Sulmi seksual te fëmijët.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zgjerojnë njohuritë lidhur me procedurën penale kur fëmija është viktimë;
- * Analizojnë format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera të ngjashme lidhur me integritetin seksual të fëmijëve;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat lidhur me këto vepra penale.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të Mitur.

Drejtësia për Fëmijë - Lëmia Civile

58. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror

Kosova është një nga shtetet e cila është angazhuar mjaft në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve fillimisht duke sanksionuar në Kushtetutë se krahas marrëveshjeve dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet. Në këtë program ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve (adoptimin, kujdestarinë etj.), të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Më tutje do të flitet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, si dhe rreth parimit të interesit më të lartë të fëmijës, roli i gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar.

Kush konsiderohet fëmijë pa përkujdesje prindërore sipas ligjit të zbatueshëm? Cilat janë format e veçanta për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror? Cilat janë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për tu lejuar adoptimi i fëmijës? Cila është procedura ligjore që duhet të ndiqet nga prindi adoptues për të adoptuar një fëmijë? Cila gjykatë ka kompetencë lëndore për të themeluar adoptimin? A mund të adoptohen fëmijët shtetas të Kosovës nga shtetasit e huaj? Cilat janë aktet ndërkombëtare që zbatohen në procedurën e themelimi të adoptimit?

Ky program është hartuar të përgjigjet në pyetjet dhe dilemat, duke analizuar legjislacionin e zbatueshëm që i referohet procedurës gjyqësore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Përmbajtja

- * Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- * Adoptimi;
- * Vendosja e fëmijës në familjen tjetër;
- * Kujdestaria;
- * Ushtrimi, pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi i të drejtës prindërore;
- * Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë rastet lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- * Analizojnë dispozitat lidhore mbi adoptimin;
- * Përcaktojnë kriteret e vendosjes së fëmijës në familje tjetër;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore mbi kujdestarinë, të drejtën prindërore në frymën e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit-divizioni civil, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni civil, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

59. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare

Numri i kontesteve martesore-familjare vazhdimisht është në rritje e sipër në gjykatat tona. Është me rëndësi të trajtohet kjo temë për arsyen se marrëdhëniet martesore – familjare rrjedhimisht kontestet martesore – familjare janë mjaft komplekse për shkak të natyrës së tyre dhe se roli i gjykatës në këto konteste nuk është vetëm shqyrtues por edhe hetues. Krahas analizimit të rolit të gjykatës në kontestet martesore-familjare me rëndësi është edhe elaborimi i temës së rrëmbimit të fëmijëve pasi që rastet e rrëmbimit të fëmijëve kanë ndodhur edhe në të kaluarën por legjislacioni ynë tek në vitin 2010 këtë çështje e ka rregulluar me ligj, që është një risi për sistemin tonë gjyqësor.

Cilat janë parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi? Cili është legjislacioni ndërkombëtar i aplikueshëm në këto raste? Mbi çfarë kritere vendos gjykata?

Ky program është hartuar me qëllim që të përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe dilemat, duke analizuar legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore–familjare. Njëkohësisht përmes rasteve studimore do të synohet që pjesëmarrësit të tejkalojnë paqartësitë në vendosjen për këto çështje.

Përmbajtja

- * Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar;
- * Kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve;
- * Parimet për përcaktimin e alimentacionit;
- * Roli aktiv që duhet të ketë gjykata në këto çështje/konteste;
- * Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve në çështjet civile-procedura.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë mbrojtje efikase dhe efektive të të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit;
- * Zbatojnë drejtë ligjin me rastin e besimit, ruajtjes dhe kujdesit të fëmijëve;
- * Vendosin për alimentacion duke respektuar drejtshmërinë.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit-divizioni civil, gjyqtarët e gjykatave Themelore-divizioni civil, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

60. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre

Fëmijët janë kategoria më e ndjeshme e shoqërisë për të cilën shteti me mekanizmat e tij është i obliguar të kujdeset për krijimin e kushteve për mirëritjen dhe mirëqenien e tyre, pavarësisht statusit të tyre. Këto detyrime dalin nga aktet ndërkombëtare të cilat janë të miratuara nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti, por edhe nga infrastruktura ligjore e miratuar nga vet shtetet veç e veç.

Kush ka të drejtë të parashtrojë padinë në gjykatë për vërtetimin e atësisë dhe amësisë së fëmijës dhe padinë për kundërshtimin e atësisë apo amësisë? A

është i lidhur me afat parashtrimi i padisë për çështjet e cekura më lartë? Cilat janë efektet e njohjes apo kundërshtimit të atësisë/amësisë në raport me fëmijën? Cili është legjislacioni i zbatueshëm në rastet e cekura më lartë? Cili është roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën gjyqësore në rastet e ndryshimit të statusit të tyre?

Ky program është hartuar të përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe dilemat, duke analizuar në thellësi legjislacionin e zbatueshëm që i referohet procedurës gjyqësore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre.

Përmbajtja

- * Amësia dhe atësia;
- * Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë;
- * Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e dhunës në familje;
- * Parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- * Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë dispozita ligjore lidhur me atësinë dhe amësinë;
- * Zbatojnë parimin e interesit më të lartë të fëmijës;
- * Aplikojnë mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurën gjyqësore.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit-divizioni civil, gjyqtarët e gjykatave Themelore-divizioni civil, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

E Drejta Komerçiale

61. Të drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit

E drejta e autorit gjithnjë e më tepër po tregohet si një faktor i rëndësishëm zhvillimor në ekonominë e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj respektimi dhe zbatimi i drejtës së autorit është i një rëndësie të veçantë. Përveç zhvillimit ekonomik zbatimi i të drejtës së autorit ndikon po ashtu në stimulimin e krijimtarisë kulturore dhe kreative. Edhe pse në Kosovë ekziston infrastruktura ligjore për mbrojtjen e të drejtës së autorit, si në aspektin civil ashtu edhe penal, megjithatë ende nuk është arritur që të krijohen mekanizma funksional për parandalimin e shkeljes së kësaj të drejte, andaj rrjedhimisht titullarëve të këtyre të drejtave të vetmen mundësi të mbrojtjes efektive të së drejtave e kanë mbrojtjen gjyqësore. Si rezultat i të cekurave, në gjykatë janë paraqitur një numër i caktuar i rasteve por ky numër pritet të rritet shumë në të ardhmen e afërt.

Çka është e drejta e autorit? Cili është legjislacioni i zbatueshëm në këtë fushë? Sa është në përputhje praktika gjyqësore me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane? Cilat janë përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon? Si të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë?

Tema e tillë është për zgjedhë me qëllim që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe prezantimit të rasteve praktike.

Përmbajtja

- * Kuptimi i të drejtave të autorit dhe autorizimet e titullarit të së drejtës;
- * Mbrojtja juridike në aspektin civile dhe penal;
- * Mbrojtja alternative e të drejtave të autorit – shoqatat profesionale;
- * Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së autorit;
- * Kontrata për bartjen e të drejtës së autorit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë çka përfshinë e drejta e autorit;
- * Vlerësojnë pretendimet për shkelje të së drejtës së autorit;
- * Zbatojnë procedurat ligjore në mbrojtjen e kësaj të drejte;
- * Njohin mënyrat dhe punët juridike për bartjen e së drejtës së autorit nga një titullar në tjetrin.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtarët dhe prokurorët nga lëmia penale.

62. Kontratat në ekonomi

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari ekonomike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizmin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët. Kontratat mbi ndërtimin dhe Kontratat e Inxhinjeringut aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit. Ndërsa shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje Ndërkombëtare të Mallrave. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Cilat janë procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e kontratave në ekonomi? Cilat janë mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.

Përmbajtja

- * Kuptimi i kontratës mbi ndërtimit dhe kontratës për inxhinjeringun dhe specifikat e tyre;
- * Kuptimi i kontratës publike dhe specifikat e tyre;
- * Kuptimi i kontratës për shitje ndërkombëtare të mallrave dhe specifikat e tyre;
- * Konventa ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në Kosovë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë kontratën e ndërtimit, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- * Njohin kontratën e inxhinjeringut, kontratat publike dhe karakteristikat e tyre;
- * Zbërthejnë Konventën ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në raportet afariste me element të huaj.

Kohëzgjatja



Tre ditore

Përfituesit



Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Administrative.

63. Shoqëritë tregtare

Shoqëritë tregtare janë bartës i zhvillimit ekonomik në vendet me ekonomi të tregut. Kosova në përpjekjet e saj për zhvillim ekonomik ka ndërmarrë masa të ndryshme për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për krijim e parakushteve për zhvillimin e biznesit. Në këtë drejtim Kosova ka miratuar Ligjin për Shoqëritë Tregtare i cili përbën një bazament të mirë për krijimin e një ekonomie të tregut dhe mundësimin e investime të huaja në Kosovë. Ky ligj përcakton llojet e shoqërive tregtare, kushtet e regjistrimit, themelimin dhe shuarjen e shoqërive, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga veprimtaria afariste e shoqërive tregtare është i kon-

siderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Cilat janë llojet e shoqërive tregtare? Cilat janë vështirësitë në zbatimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë? Cilat janë përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon? Si të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe prezantimit të rasteve praktike.

Përmbajtja

- * Llojet e Shoqërive Tregtare;
- * Kapaciteti dhe struktura juridike e shoqërive tregtare;
- * Kushtet e regjistrimit, themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare;
- * Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin mënyrat e themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare, llojet e tyre si dhe pasojat juridike që krijojnë;
- * Avancojnë njohuritë lidhur me mënyrat e organizimit, strukturën e kapitalit, dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat dhe procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga shoqëritë tregtare.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Administrative.

64. Risitë e Ligjit për Falimentimin

Ligji i ri për falimentimin u shfaq si nevojë e domosdoshme për rregullimin e procedurës së likuidimit dhe riorganizimit të shoqërive tregtare, pasi ligji i mëparshëm ishte i pakompletuar. Ligji i ri për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencën, i cili i pasqyron praktikatat më të mira ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik. Ky ligj rregullon procedurat e likuidimit dhe riorganizimit të të gjitha shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe bizneset individuale, ortakëritë dhe shoqëritë komandite, që përbën ndryshim thelbësor nga ligji i vjetër. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji pritet një rritje e dukshme e rasteve, prandaj duke pasur parasysh risitë që sjell

ky ligj dhe rritja e rasteve që pritet të paraqiten para gjykatave, trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve.

Cilat janë risitë e ligjit të ri për falimentimin në raport me ligjin e mëparshëm? Cilat janë përvojat dhe praktikave me të mira të shteteve në rajon? Si të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, me fokus në ndryshimet e ligjit të ri për falimentimin dhe efektet e tij.

Përmbajtja

- * Procedurat e përshpejtuara (NVM dhe pakot);
- * Fillimi, hapja e rasteve dhe pasojat;
- * Kërkesat e kreditorëve;
- * Riorganizimi dhe Likuidimi;
- * Lirimi individual dhe mbyllja e rastit;
- * Dispozitat ndërkufitare.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Identifikojnë risitë dhe ndryshimet e ligjit të ri për falimentimin;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit të ri për falimentimin.

Kohëzgjatja



Tre ditore

Përfituesit



Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

65. Markat tregtare

Markat tregtare janë kategori e rëndësishme nga të drejtat e pronësisë intelektuale që luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut, pasi që ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre përdorin markat tregtare me qëllim të dallimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve, si dhe për mbrojtjen e produkteve të tyre. Mbrojtja e markave tregtare garantohet me Ligjin për Markat Tregtare, Kodin Penal si dhe me masat tjera administrative duke përfshirë ato doganore, megjithatë në praktikën juridike hasen vështirësi të shumta në zbatimin e dispozitave ligjore dhe ofrimin e mbrojtjes efektive. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga markat tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për të rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Sa gëzojnë mbrojtje markat tregtare në vendin tonë? Cili është roli i gjykatës në mbrojtjen e markave tregtare? Sa është në përputhje praktika gjyqësore me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane? Cilat janë instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë?

Trajnimi do të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktiken gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve të interaktive dhe prezantimit të rasteve praktike.

Përmbajtja

- * Kuptimi i markave tregtare - llojet: imagjinare, sugjeruese, përshkruese, gjenerike;
- * Kushtet e regjistrimit të markës tregtare dhe mbrojtja juridike që gëzojnë;
- * Mbrojtja gjyqësore dhe procedura për mbrojtjen e markave tregtare;
- * Kriteret e vlerësimit të shkeljes së markës tregtare.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë markën tregtare, llojet e markave dhe nevojën për mbrojtje juridike;
- * Njohin mënyrat e regjistrimit dhe humbjes së të drejtës nga marka tregtare;
- * Zbatojnë dispozitat për procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare;
- * Identifikojnë kriteret në rastet kur titullari pretendon për shkelje të markës së tij tregtare.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Administrative.

66. Zgjidhja Alternative e Kontesteve

Aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve (Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi) është e një rëndësie të veçantë pasi që rrisin sigurinë juridike dhe mundësojnë tërheqjen e investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik, sepse në botën bashkëkohore të afarizmit bizneset janë të pritura për t'i zgjidhur kontestet e tyre jashtë procedurave gjyqësore. Kosova në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson zgjidhjen alternative të kontesteve. Përkundër përparësive të ekzistimit të sistemeve alternative, krahas atyre gjyqësore, në praktikën juridike këto dy sisteme e interferojnë apo komplementojnë njëra tjetrën, andaj paraqiten situata të cilat kërkojnë përgjigje nga doktrina juridike dhe praktika gjyqësore. Po ashtu, në praktikën juridike paraqiten konteste me element ndërkombëtar, që shfaqin nevojën e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me rregullat ndërkombëtare, për tu siguruar se gjatë zbatimit të dispozitave, interpretimi i tyre të jetë në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Sa zbatohen procedurat alternative në praktikë? Cilat janë kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit dhe ndërmjetësimit? Cilat janë përvojat dhe praktikën me të mira të vendeve në rajon në aplikimin e procedurave alternative? Sa është i harmonizuar legjislacioni vendor me atë ndërkombëtar?

Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike.

Përmbajtja

- * Arbitrazhi - llojet dhe karakteristikat;
- * Ndërmjetësimi - arritja e marrëveshjes dhe përmbushja-ekzekutimi i saj;
- * Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit dhe kompetencat e gjykatave lidhur me ndërmjetësimin.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zbatojnë zgjidhjet Alternative të Kontesteve (ZAK);
- * Dallojnë kompetencat e gjykatës lidhur me arbitrazhin dhe ndërmjetësimin;
- * Zbatojnë drejtë legjislacionin që rregullojnë këtë materie.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

E Drejta Administrative

67. Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për regjistrimin civil

Organizimi i këtij trajnimi do të ketë në fokus trajtimin e regjistrave të gjendjes civile – korigjimin dhe plotësimin në regjistrin qendror të gjendjes civile, regjistrimi i lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes dhe regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi. Dispozitat e Ligjit për Regjistrimin Civil do të analizohen dhe shpjegohen në hollësi duke pasqyruar se ky ligj rregullon të dhënat e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Kryesisht do të trajtohen pyetjet dhe dilemat që ndërlidhen me regjistrimin e emrit, mbiemrit apo ndryshimin e tyre në regjistrat civil konform Ligjit për Regjistrin Civil. Pastaj do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me regjistrat e gjendjes civile – korigjimin dhe plotësimin në regjistrin qendror të gjendjes civile, çështje që janë të diskutueshme lidhur me regjistrimin e lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes dhe çështje dhe situata nga regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi.

Në këtë trajnim do të përdoren metodat e ligjërimit të pjesëshëm, diskutime interaktive, dhe shembuj nga praktika si në gjykatë ashtu edhe në OSHP. Gjithashtu do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit të përcjella me shembuj praktik.

Përmbajtja

- * Regjistrat e gjendjes civile-korigjimi dhe plotësimi në Regjistrin qendror të gjendjes civile;
- * Regjistrimi i lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes;
- * Regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Avancojnë njohuritë lidhur me Ligjin për Gjendjen Civile;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore përkatëse lidhur me regjistrimin e lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes;
- * Dallojnë procedurat në mes të regjistrimit të mëvonshëm dhe ri-regjistrimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës së Apelit dhe zyrtarët e Departamentit për Regjistrim Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

68. Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Në këtë trajnim do të trajtohet procedura që zhvillohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (KPMK) dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës me përqendrim tek shërbyesit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në procedurën që zhvillohet me rastin e cenimit të drejtave të shërbyesve civil si në KPMK dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka dilema dhe paqartësi lidhur me kompetencën për të vendosur në këto kontest. Po ashtu ka vështirësi që kanë të bëjnë me moszbatimin e disa vendimeve të Këshillit, përmbardimin e vendimeve nga gjykatat, zbatimin e standardeve kushtetuese për të drejtën në punë dhe zbatimin e kërkesave të KEDNJ-së.

Si zhvillohet procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës? Cila është procedura e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente ndaj vendimit të KPMK?

Këto dilema do të shtjellohen përmes diskutimeve dhe shembujve nga praktika gjyqësore, me angazhimin edhe të pjesëmarrësve për zgjedhjen e rasteve të cilat rëndom ndodhin në procedurat gjyqësore në gjykata.

Përmbajtja

- * Dispozitat ligjore për shërbyesit civil;
- * Procedura ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij;
- * Përmbardimi i vendimeve të KPMK-së;
- * Raste nga praktika gjyqësore lidhur me procedurën në çështjet që lidhen me shërbyesit civil.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë dispozitat ligjore për shërbyesit civil;
- * Shqyrtojnë mjetet juridike kundër vendimeve të KPMK-së;
- * Zbatojnë drejtë dispozitat e LSHC në konteste për shërbyesit civil;
- * Zbërthejnë procedurën në çështjet që lidhen me shërbyesit civil.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës së Apelit dhe zyrtarët e KPMK-së.

69. Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës

Në këtë trajnim do të trajtohen statusi dhe qëndrimi i të huajve, procedura ligjore e mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për të Huajt. Duke marr parasysh se ky ligj rregullon hyrjen në territorin e Kosovës, daljen prej saj si dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është e domosdoshme që procedurat që zhvillohen lidhur me këto të trajtohen në gjerësi dhe nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore, si dhe dispozitave për integrimin e të huajve në shoqërinë kosovare.

Sa janë nën kontroll lëvizjet emigranteve nga institucionet relevante pas identifikimi dhe regjistrimit të tyre? Cilat janë vështirësitë në zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për të Huajt?

Dilemat dhe pyetjet në këtë trajnim do të adresohen përmes ligjërimit të pjesshëm teorik, diskutimeve interaktive, të cilët do të argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika.

Përmbajtja

- * Hyrja, qëndrimi dhe dalja nga territori i Republikës së Kosovës;
- * Procedura ligjore e mbajtjes dhe dëbimit të të huajve nga Republika e Kosovës konform Ligjit për të Huajt, nr.04/4-217;
- * Qëndrimi i paligjshëm, kthimi dhe dëbimi i të huajve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Interpretojnë dispozitat ligjore për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e të huajve nga territori i Republikës së Kosovës;
- * Vlerësojnë drejtë zbatimin e procedurës ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të të huajve nga Republika e Kosovës konform Ligjit për të Huajt.
- * Njohin procedurën lidhur me qëndrimin e paligjshëm, kthimin dhe dëbimin e të huajve.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës së Apelit, Zyrtarë të Departamentit të Policisë Kufitare; DSHAM-MPB (Divizioni për kthim dhe përfaqësues nga Qendra e Mbajtjes për të huaj) si dhe MPJ, zyrtarë të UNHCR-it; IOM-it dhe shoqërisë civile (KRTC dhe CRPK).

70. Tryezë e rrumbullakët “Trajtimi i dilemave aktuale në Ligjin për Konfliktet Administrative”

Në këtë tryezë do të trajtohen propozimet për plotësimet që duhet të bëhen në Ligjin për Konfliktet Administrative. Pas tryezave të mbajtura gjatë vitit të kaluar në IGJK në tematikën e gjyqësisë administrative dolën në pah dilemat që duhet trajtuar në kuptim të plotësimin dhe ndryshimit të Ligjit për Konfliktet Administrative. Andaj në këtë tryezë do të shtjellohen pyetjet dhe dilemat që ndërlidhen me plotësimin e dispozitave nga neni 9, 32, 34 (parg.4), neni 46 (parg.4 dhe 5), neni 51, 54 dhe neni 63 të LKA-së, etj., duke synuar që këto të riformulohen në formë të propozimeve të mundshme për zgjidhje të reja brenda ligjit të ri për konfliktet administrative që është duke u hartuar. Fokusi do të jetë edhe në çështjet e harmonizimit të ligjeve tjera materiale si: (Ligji për Shërbimin Civil, Ligji për Administratën Tatimore, etj.) me ligjin për konfliktet administrative.

Në këtë tryezë pjesëmarrësit do të kenë mundësinë që përmes kontributeve personale të artikulojnë në formë propozimesh zgjidhje konkrete për dilemat që janë evidentuar nga gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe atij të Gjykatës së Apelit në praktikën gjyqësore, duke shfrytëzuar këtë periudhë në të cilën ligji i ri për konfliktet administrative është duke u hartuar.

Përmbajtja

- * Trajtimi i dilemave që janë paraqitur në praktikë gjatë zbatimit të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative;
- * Çështjet aktuale nga praktika dhe nevoja e harmonizimit të ligjeve materiale me Ligjin për konfliktet administrative;
- * Propozimet përfundimtare për plotësimin e ligjit aktual për konfliktet administrative.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Veçojnë dilemat që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative;
- * Identifikojnë çështjet aktuale nga praktika dhe nevojat e harmonizimit të ligjeve materiale me Ligjin për Konfliktet Administrative;
- * Formulojnë propozimet përfundimtare për plotësimin e ligjit aktual për konfliktet administrative.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe profesionistë tjerë nga fusha administrative.

Lëmia e Kundërvajtjes

71. Administrimi i provave - parimet udhëheqëse

Jo gjithëherë ushtruesit e kërkesave për fillim të procedurës për kundërvajtje i propozojnë apo edhe i ofrojnë provat e duhura me anë të cilave do të identifikohet kundërvajtja konkrete e kryer. Për gjykatën provat janë të domosdoshme që të konstatojë ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe kryesin e kundërvajtjes. Ngritja e njohurive themelore për identifikimin dhe administrimin e provave në procedurën për kundërvajtje, me theks vlerësimi i drejtë i tyre, janë kusht për marrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Cili është kuptimi i provës dhe faktit? Cili është dallimi në mes të provave të pranueshme dhe të pa pranueshme? Cilat janë llojet e provave që mund të administrohen në rastet konkrete?

Trajnimi është dizajnuar në mënyrë që të trajtohen administrimi i provave në procedurën kundërvajtëse duke dhënë përgjigjet në çështjet e shtruara më lartë.

Përmbajtja

- * Administrimi i provave në procedurën kundërvajtëse;
- * Parimet udhëheqëse gjatë administrimit të provave, në procedurën kundërvajtëse.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë provat e pranueshme nga ato të papranueshme në procedurën kundërvajtje;
- * Vlerësojnë drejtë provat;
- * Zbatojnë drejtë parimet lidhur me mënyrën dhe trajtimin e provave në procedurë.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje.

72. Aktvendimi dhe arsyetimi ligjor

Aktvendimet e marra nga gjykatat, shpesh herë nuk janë konform strukturës së përcaktuar, sidomos janë identifikuar mangësi në arsyetimin ligjor të aktvendimit. Në këtë kontekst është e rëndësishme ngritja e shkathësive për përpilimin e drejtë të aktvendimeve në procedurën kundërvajtëse, me theks në arsyetimin e drejtë, të qartë dhe ligjorë të aktvendimit. Përpilimi i aktvendimeve të drejta sipas llojit dhe arsyetimi i ligjshëm i tyre është nevojë dhe obligim i domosdoshëm i gjykatës, në mënyrë që aktvendimi, qoftë dënues apo lirues, përveç i drejtë,

të jetë i qartë si për palët në procedurë, ashtu edhe për personat e tretë.

Cilat janë llojet e aktvendimeve në procedurën për kundërvajtje? Si duhet përpiluar drejtë një aktvendim me arsyetim ligjorë? Cilat janë mënyrat e rregullta të dorëzimit të aktvendimit?

Trajnimi është dizajnuar në atë formë që përmes demonstrimit të përpilimit të aktvendimit, të kontribuohet në krijimin e praktikave uniforme.

Përmbajtja

- * Aktvendimi dhe arsyetimi ligjor;
- * Mënyrat e përpilimit të aktvendimit, me theks të veçantë në përpilimin e diapozitivit dhe të arsyetimit ligjor;
- * Koha dhe mënyrat e dorëzimit të rregullt të aktvendimit palëve në procedurë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Hartojnë drejtë aktvendimin dhe arsyetimin ligjor të tij;
- * Identifikojnë llojet e aktvendimeve dhe mënyrën e arsyetimit të tyre;
- * Zbatojnë drejtë mënyrën e përcaktuar ligjore të dorëzimit të shkresave.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje.

73. Personat juridik dhe procedura kundërvajtese

Personi përgjegjës i personit juridik, nga gjykata mund të shpallet përgjegjës dhe mund t'i shqiptohet sanksioni, edhe në rastet kur ai nuk mbanë përgjegjësi për kundërvajtjen konkrete dhe shumë shpesh identifikohet me subjektin afarist. Në praktikën gjyqësore janë vërejtur mangësi në disa raste kur gjykatat e shkallës së parë nuk e zhvillojnë në mënyrë të drejtë procedurën për kundërvajtje ndaj personave juridik kur këta paraqiten si palë në procedurë.

Ku qëndron dallimi mes subjektit afarist si person juridik dhe subjektit afarist si biznes individual? Në cilat raste nuk mbanë përgjegjësi për kundërvajtje personi përgjegjës i personit juridik? Si zhvillohet procedura kundërvajtje ndaj subjektit afarist si biznes individual?

Programi synon që përmes elaborimit të legjislacionit të zbatueshëm që ka të bëjë me statusin juridik të subjekteve afariste në procedurën gjyqësore, shembujve praktik përkitazi me ndjekjen dhe gjykimin e kundërvajtjeve të personit juridik dhe bizneseve individuale, dhe diskutimeve interaktive të kontribuoj në unifikimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Përmbajtja

- * Mënyra e zhvillimit të procedurës për kundërvajtje ndaj subjektit afarist me cilësi të personit juridik dhe ndaj personit përgjegjës në personin juridik;
- * Përgjegjësia e personit juridik dhe e personit përgjegjës të personit juridik;
- * Subjektet afariste si biznese individuale dhe zhvillimi i procedurës ligjore ndaj tyre;
- * Përgjegjësia e personit fizik.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Përkufizojnë qartë dhe drejtë subjektet afariste si persona juridik dhe personin përgjegjës të personit juridik;
- * Zhvillojnë drejt dhe në mënyrë ligjore procedurën për kundërvajtje ndaj personave juridik dhe personave përgjegjës në personin juridik;
- * Zbatojnë dispozitat ligjore në përcaktimin e përgjegjësisë për personin juridik, për personin përgjegjës të personit juridik, dhe për personin fizik.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarët e nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje.

74. Kundërvajtjet nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, (neni 4, 5 dhe 16 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike)

Ligji i zbatueshëm për Rendin dhe Qetësinë Publike si i tillë është shumë i varfër dhe nuk përfshinë shumicën e kundërvajtjeve nga kjo lëmi, e të cilat manifestohen në jetën e përditshme. Nga praktika gjyqësore, në vendimet e gjykatave, është vërejtur se në raste të shpeshta nuk bëhet dallimi mes kundërvajtjes “*Sjellje arrogante (neni 4)*” nga njëra anë, dhe “*Sulmit verbal (neni 5)*” në anën tjetër. Po ashtu kundërvajtja “*Mosrespektimi i urdhrin të personit të autorizuar zyrtar nga neni 16 të LRQP*”, shpesh ngatërrohet me kundërvajtjen nga Ligji për sigurinë e komunikacionit rrugor “*Mosveprimi sipas urdhrin të personit zyrtar në trafik*”. Marr për bazë këto dilema në praktikë kjo temë ka nevojë të elaborohet.

Cilat janë dallimet e veprës kundërvajtje nga vepra penale? Ku qëndrojnë dallimet mes nenit 4 dhe nenit 5 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike? Çka nënkuptojmë me vend publik? Çka nënkupton urdher i personit zyrtar?

Trajnimi do të fokusohet në elaborimin e hollësishëm të dispozitave të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike, ku përmes shembujve praktik dhe diskutimeve interaktive, do të ofrohen alternativa për paqartësitë dhe vështirësitë e hasura në praktikë.

Përmbajtja

- * Kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike;
- * Sjellja arrogante dhe sulmi verbal;
- * Mosveprimi sipas urdhrin të personit të autorizuar zyrtar sipas LRQP-së;
- * Mosveprimet sipas urdhrin të personit të autorizuar zyrtar lëminë e komunikacionit rrugor;
- * Ndëshkimet për kryesit e kundërvajtjeve prishje e rendit dhe qetësisë publike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Identifikojnë veprimet inkriminuese nga lëmia e rendit dhe qetësisë publike;
- * Përkufizojnë qartë sjelljen arrogante dhe sulmin verbal;
- * Aplikojnë drejt dispozitat ligjore nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarët e nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje.

75. Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje

Me Ligjin për kundërvajtje (Ligji nr. 05/1-087) i cili do të hyjë në fuqi më 2017, rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. Duke u mbështetur në këto fakte është e nevojshme dhe e rëndësishme trajtimi i kësaj teme në drejtim të zhvillimit të drejtë të procedurës kundërvajtëse që do të zhvillohet ndaj personave përgjegjës që kanë kryer vepra kundërvajtëse.

Kur kemi të bëjmë me përgjegjësi kundërvajtëse? Cilat janë llojet, mënyra e përcaktimit dhe shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse? Çka është procedura e kundërvajtjes dhe si zhvillohet ajo sipas ligjit të ri për kundërvajtje?

Trajnimi do të fokusohet në elaborimin e hollësishëm të dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje, (Ligji nr. 05/1-087), ku përmes shembujve praktik dhe diskutimeve interaktive, do të ofrohen alternativa për paqartësitë dhe vështirësitë e zbatimit në praktikë.

Përmbajtja

- * Përgjegjësia kundërvajtëse;
- * Sanksionet kundërvajtëse;
- * Masat e veçanta të kundërvajtjes;
- * Parashkrimi i zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes;

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë rastet se kur kemi të bëjmë me përgjegjësi kundërvajtëse;
- * Kategorizojnë sanksionet kundërvajtëse;
- * Aplikojnë drejt masat e veçanta të kundërvajtjes;
- * Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me parashkrimin e veprave kundërvajtëse.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje.

E drejta Kushtetuese

76. Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës

Kushtetuta ka përcaktuar se çdo gjykatë, pavarësisht nga hierarkia e saj në sistemin e drejtësisë në Kosovë, ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të adresuar pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, në qoftë se zgjidhja e rastit konkret varet nga përputhshmëria e ligjit të referuar me Kushtetutën. Ky mekanizëm i kontrollit kushtetues, në teorinë e rishikimit kushtetues njihet si referim i rastit ose referim incidental. Sipas modelit të drejtësisë kushtetuese në Kosovë, gjyqtarët nuk mund të vendosin vetë për kushtetutshmërinë e një ligji, i cili është i nevojshëm për vendimin e tyre. Andaj, gjykatat vetëm mund të ndërpresë procedurat gjyqësore dhe t'ia kalojë çështjen Gjykatës Kushtetuese, e cila më pas do të vendosë nëse ligji i kontestuar është kushtetues.

Çfarë është “pyetja ose kërkesa preliminare” që i referohet Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e rregullta? Cilat janë kriteret që duhet të plotësohen për të referuar çështje preliminare para Gjykatës Kushtetuese? Cilat janë afatet kohore? A duhen pezulluar edhe gjykatat tjera çështje të ngjashme pas referimit preliminar para Gjykatës Kushtetuese?

Ky trajnim do të përqendrohet në analiza teorike dhe normative duke u përqendruar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese si dhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të gjykatave tjera kushtetuese në rajon dhe me gjerë.

Përmbajtja

- * Definimi i “referimit paragjykimor (incidental)” në doktrinën kushtetuese;
- * Subjektet e autorizuara për të referuar çështje paragjykimore;
- * Afatet kohore dhe kriteret për referim;
- * Efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- * Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë drejtë referimin incidental si mekanizëm i kontrollit kushtetues;
- * Njohin kriteret e përcaktuara për referim të një çështje në Gjykatën Kushtetuese;
- * Zbatojnë dispozitat për referimin incidental të rasteve në Gjykatë Kushtetuese;
- * Respektojnë praktikën e Gjykatës Kushtetuese për raste të ngjashme.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, Apelit dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

77. Kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Juridiksioni ekskluziv i Dhomës së Posaçme është i rregulluar me nenin 4 të Ligjit për DHPGJS, i cili parasheh se DHP ka kompetencë të vendosë mbi të gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me kundërshtimet ndaj një vendimi apo veprimi të AKM-së, tani AKP-së, apo kërkesat e palëve që pretendojnë ndonjë të drejtë, titull apo interes me të cilën administron Agjencia Kosovare e Privatizimit. Çështja e Kompetencës është e rëndësishme të diskutohet, pasi që në kohët e fundit janë vërejtur disa raste kur Gjykatat Themelore kanë kthyer lëndët në Dhomën e Posaçme, edhe pse DHP më parë kishte lëshuar vendimin e saj rreth mungesës së Juridiksionit. Shikuar në këtë aspekt është e rëndësishme të shtjellohet edhe çështja se a kemi të bëjmë me konflikt të kompetencës, apo është DHPGJS ajo e fundit për të përcaktuar kompetencën e saj.

Çka është kompetenca në përgjithësi? Cilat janë llojet e kompetencës? Cila është kompetenca ekskluzive, sipas nenit 4 të ligjit të DHPGJS? Çka është kompetenca funksionale në përgjithësi? Cilët persona mundën më qenë parashtrues dhe palë kundërshtare para Dhomës së Posaçme?

Trajnimi do të fokusohet në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me kompetencat e DHPGJS, respektivisht për kërkesat të cilat mund të ngritin dilemat edhe tek vet gjyqtarët se a hyn në juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme.

Përmbajtja

- * Llojet e kompetencës;
- * Kompetenca funksionale me fokus në Dhomën e Posaçme;
- * Parashtruesit dhe palët kundërshtare në Dhomën e Posaçme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Bëjnë ndarjen e kompetencave;
- * Kuptojnë rregullat me të cilat bëhet ndarja e veprimeve procedurale, apo e punëve ose e fazave të ndryshme të zhvillimit nëpër të cilat kalon procesi;
- * Identifikojnë personat kompetent që mund të jenë parashtrues dhe palë kundërshtare në procedurë para Dhomës së Posaçme.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni civil si dhe zyrtarët e AKP-së.

78. Procedura gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Procedurat pranë Dhomës së Posaçme përbëhen nga procedurat me shkrim dhe procedurat verbale. Kërkesa apo ankesa dorëzohet me shkrim në Dhomën e Posaçme e cila duhet të përmbajë: emrin dhe adresën e parashtruesit(ve), emrin dhe adresën e avokatit, nëse ka, që vepron në emër të parashtruesit, emrin (emrat) dhe adresën (adresat) e palës kundërshtare apo secilit person që identifikohet si palë kundërshtare, lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetët kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtruesi synon t'i paraqesë. Nëse kërkohet kompensim financiar, paraqitet një listë e dëmeve që përcakton natyrën e humbjes apo dëmit, shumën e parave që pretendohet për çdo lloj humbje apo dëmi, si edhe provat që duhet të paraqiten për mbështetjen të atij lloji të humbjes apo të dëmit, dhe nëse kërkohet kompensim jo financiar.

A duhet që kërkesa e parë që paraqitet në Gjykatë të jetë e nënshkruar nga parashtruesi apo përfaqësuesi i tij? Në kontekst të nenit 24 të shtojcës së Ligjit të DHP a mund të thuhet se personat fizik lejohen gjithëherë ta përfaqësojnë vetveten? A duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë si paditësi dhe i padituri para gjykatës sa i përket përfaqësimit dhe a është kjo e drejtë e garantuar me Kushtetutë?

Trajnimi do të fokusohet në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me aplikimin e dispozitës së nenit 24 të shtojcës së ligjit, i cili rregullon çështjen e përfaqësimit të paditësit dhe të paditurës para Dhomës së Posaçme.

Përmbajtja

- * Procedura gjyqësore dhe obligimi i palëve në procedurë;
- * Mbrojtja e palëve në procedurë para Dhomës së Posaçme;
- * Procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë drejtë obligimin e palëve në procedurë para Dhomës së Posaçme;
- * Identifikojnë personat që mund të përfaqësojnë para Dhomës së Posaçme;
- * Respektojnë afatet me rastin e ushtrimit të mbrojtjes nga palët kundërshtare, përgjigjja e parashtruesit, kundërpërgjigjja e palës.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizioni civil dhe zyrtarët e AKP-së.

79. Pranueshmëria e kërkesës/ankesës në Dhomën e Posaçme

Shtojca e ligjit të DHPGJS e rregullon çështjen e pranueshmërisë së kërkesës/ankesës. Pas pranimi dhe regjistrimit të një kërkesë apo ankese, dhe pas dërgimit të saj në kolegjin gjegjës të specializuar, kolegji i specializuar është ai që vendos nëse kërkesa/ankesa është e pranueshme. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse Dhoma e Posaçme ka juridiksion për ta trajtuar, parashtruesi ka të drejtë të nisë procedurat, kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, si dhe nëse kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuar. Bazuar në kritere të cilat i parasheh ligji, kolegjet janë ato që vlerësojnë se a janë plotësuar kushtet për pranimin e kërkesës për të vazhduar më tutje me procesin gjyqësor.

A duhet që kriteret për pranueshmërinë e kërkesës të përmbushen në tërësi, që të mund të procedohet më lëndën apo jo? Cilat nga kriteret e pranueshmërisë gjykata i ka respektuar fuqishëm? A mundet që gjykata me rastin e pranueshmërisë së kërkesës të merr parasysh vetëm kriteret e caktuara nga Shtojca e ligjit të DHP, apo duhet të merr parasysh edhe kriteret tjera të parapara me LPK? A lejohet të pranohet një kërkesë në Gjykatë edhe pse nuk është e nënshkruar nga personi i autorizuar?

Trajnimi do të fokusohet në diskutimet dhe çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit rreth dilemave lidhur me përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë të cilat i parasheh shtojca e ligjit të DHP dhe se a do të jenë vetëm këto kritere që duhet të zbatohen fuqishëm për çështjet e pranueshmërisë apo mund të vlejnjë edhe kriteret e tjera të cilat i parasheh LPK.

Përmbajtja

- * Parashtrimi i kërkesës/ankesës në DHP;
- * Afatet për parashtrimin e kërkesave/ankesave në DHP.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë kriteret e pranueshmërisë sipas shtojcës së Ligjit të DHP;
- * Kuptojnë rastet kur gjykata duhet të kërkojë nga paraqitësi i kërkesës/ankesës të plotësojë kërkesën e tij;
- * Zbatojnë kriteret që i parasheh LDH apo mund ti marrë parasysh edhe kriteret tjera që parashihen me LPK.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelore-divizionit civil dhe zyrtarët e AKP-së.

80. Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe pronësore në procesin e likuidimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së vendimit për likuidim, publikon apo kërkon nga Autoriteti i Likuidimit të publikojë njoftimin për likuidim. Publikimi i njoftimit për likuidim bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse. Çdo person që parashtron një pretendim apo pohon një interes të tillë i cili nuk pajtohet me përcaktimin e autoritetit të likuidimit që prekë atë pretendim apo interes të pohuar, ka të drejtën që t'i sfidojë ato përcaktime pranë Dhomës së Posaçme. Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas ligjit për AKP-në apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi.

A duhet që parashtruesi i kërkesës të shtjerr mjetet juridike pranë AKP-së, në mënyrë që pastaj të drejtohet Gjykatës? A është ky një kriter i cili duhet përmeshur në mënyrë që të shkohet tutje apo jo? A duhet personat e interesuar që kanë pretendime pronësore apo kreditore ndaj një NSH-je të presin fillimin e likuidimit, në mënyrë që të drejtohen komisionit të Likuidimit, apo mund të drejtohen gjykatës për realizimin e kërkesave të tilla? A është obligim i ankuesit që me rastin e kundërshtimit të vendimit të AKP-së, në gjykatë të dorëzojë edhe një kopje të vendimit të kundërshtuar apo jo?

Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit do të trajtohen përmes diskutimeve gjatë trajnimit, në mënyrë që dilemat e tilla të eliminohen.

Përmbajtja

- * Paraqitja e kërkesave/ankesave kreditore dhe pronësore në Komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme;
- * Procedura e trajtimit të kërkesave pronësore dhe kreditore në komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin procedurën e paraqitjes së një kërkesë në Komisionin e Likuidimit për realizimin e kërkesave pronësore dhe kreditore;
- * Kuptojnë procedurën që duhet ndjekur në komisionin e Likuidimit dhe në Gjykatë;
- * Respektojnë afatet kohore për paraqitjen e kërkesave/ankesave pranë komisionit të likuidimit dhe në Gjykatë.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelore-divizionit civil dhe zyrtarët e AKP-së.

81. Procedura për privatizimin e subjekteve nga AKP

Duke pasur parasysh se rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës si dhe mirëqenia e qytetarëve të saj ishte më rëndësi jetike, lindi edhe nevoja për privatizimin dhe likuidimin adekuat dhe me kohë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Marr parasysh se pasiguria e vazhdueshme juridike lidhur me pronësinë e këtyre ndërmarrjeve dhe aseteve ishte duke i penguar në masë të madhe investimet dhe funksionimin e këtyre ndërmarrjeve dhe aseteve, po ashtu duke kuptuar se kjo pasiguri juridike ishte duke ndikuar në mënyrë serioze dhe negative në situatën e përgjithshme ekonomike dhe sociale në Kosovë u shtrua edhe nevoja e nxjerrjes së ligjeve, akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e procesit të Privatizimit.

A ka shkelje të procedurave nga AKP, me rastin e aprovimit apo refuzimit të ofertave? Në çfarë gjendje ndodheshin NSH-të në Kosovë pas luftës, sa ishin borxhet e tyre? Cilat janë vështirësitë e gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve të kësaj natyre që paraqiten para saj?

Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit do të trajtohen përmes diskutimeve, në mënyrë që të arrihet një përfundim i cili do të ishte adekuat për raste të tilla.

Përmbajtja

- * Roli i Agjencisë në procesin e privatizimit;
- * Verifikimi dhe shpallja e fituesit të përkohshëm;
- * Aprovimi dhe refuzimi i ofertës;
- * Ofertuesit me ndalesa ofertimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit në Kosovë;
- * Kuptojnë drejtë rrjedhën e procedurave për privatizimin e subjekteve;
- * Identifikojnë se cilët janë personat me ndalesa ofertimi.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelore-divizionit civil dhe zyrtarët e AKP-së.

KEDNJ

82. Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovës

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e inkorporuar si pjesë e të drejtës së brendshme në Republikën e Kosovës sipas nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës. Meqë shkalla e referimit në dispozita të Konventës Evropiane është ende e vogël, ky trajnim ka për qëllim të avancoj me tej aftësitë e gjyqtarëve lidhur me zbatimin gjyqësor të KEDNJ në procesin e zgjedhjes së rasteve gjyqësore. Për më tepër, ky trajnim ka për qëllim që të analizoj edhe mënyrën dhe procedurat e referimit të gjykatave të Republikës së Kosovës në përvojën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës.

Fillimisht, trajnimi do të analizoj se cili është efekti i KEDNJ në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sistemin e saj kushtetues? Cila është struktura e Konventës Evropiane? Si bëhet interpretimi i Konventës

Evropiane? Cilat janë obligimet që burojnë nga Konventa Evropiane për shtetet anëtare? Si zbatohet Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin juridik të Republikës së Kosovës dhe cilat janë problemet në zbatimin e Konventës në Republikën e Kosovës? Cila është raporti në mes Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjykatave të shteteve anëtare? Çfarë është përmbajtja e Konventës Evropiane dhe si mund të zbatohet Konventa në mënyrë direkte nga gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë? Cilat janë efektet e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së?

Në trajnim pyetjet e shtruara do të adresohen përmes shpjegimit teorik por duke u bazuar në raste gjyqësore dhe duke përdorur shembuj konkret nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përmbajtja

- * KEDNJ dhe Protokollet e saj dhe mënyrat e zbatimit në praktikë;
- * Standardet e përcaktuara nga GJEDNJ-ja në lidhje me zbatimin e Konventës dhe të jurisprudencës së GJEDNJ nga ana e gjykatave kombëtare;
- * Si veprojnë gjykatat vendore me praktikën gjyqësore të KEDNJ-së dhe çfarë është ndikimi i vendimeve të GJEDNJ-së në jurisprudencën vendore?
- * Hyrje në portalin e HUDOC (Dokumentacioni për të Drejtat e Njeriut) si mjet për zbatimin e Konventës Evropiane dhe të praktikës gjyqësore të saj.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Të analizojnë efektin e KEDNJ-së në sistemin kushtetues të Kosovës;
- * Të njohin strukturën e Konventës Evropiane;
- * Të interpretojnë drejtë Konventën Evropiane.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

83. Nenit 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe zbatimi i tij

Sipas nenit 6 të KEDNJ çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Për më tepër ky nen i garanton secilit person të akuzuar për një vepër penale që të prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht duke i garantuar të drejtat minimale.

Si të bëhet arsyetimi i mjaftueshëm i vendimeve gjyqësore si bazë e procesit të drejtë gjyqësor. Sa zbatohet kërkesa për prezumim të pafajësisë sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e

Njeriut? Si zbatohen garancionet e nenit 6 të Konventës në sistemin gjyqësor të Kosovës: sfidat dhe problemet? Cili është roli i Gjykatës Supreme në zbatimin e standardeve të nenit 6 nga ana e gjykatave të rregullta në Kosovë? Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në zbatimin e standardeve të nenit 6 nga ana e gjykatave të rregullta në Kosovë?

Dilemat dhe pyetjet gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe përdorur shembuj konkret. Do të përdoren ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik për të zbërthyer kuptimin e drejtë të dispozitave të nenit 6 të KEDNJ, lidhur me paraburgimin - paragr.1 pika c e nenit 5 dhe analiza e gradacioneve procedurale që përmban neni 6 i KEDNJ.

Përmbajtja

- * Analiza e dispozitave të nenit 6 të KEDNJ. Mbrojtjet procedurale sipas dispozitave të nenit 6 të KEDNJ;
- * E drejta e dëgjimit të drejtë dhe publik;
- * E drejta për t'u gjykuar pa vonesë të tepruar;
- * E drejta e të akuzuarit të pyesë ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të marrë pjesë dhe të ekzaminohë dëshmitarët nën emrin e tij;
- * E drejta e të akuzuarit për të marrë ndihmën falas të një përkthyesi në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në gjyq;
- * Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave në kontekst të nenit 6 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ;
- * Raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ lidhur me nenin 6 të KEDNJ.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë dispozitat e nenit 6 të KEDNJ;
- * Zbatojnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ lidhur me nenin 6 të KEDNJ.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

84. Neni 10 i Konventës Evropiane

E drejta e lirisë së shprehjes, si një ndër themelet e domosdoshme të shoqërisë, është e mbrojtur me nenin 10 të KEDNJ-së dhe siguron që secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë apo për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike pa marrë parasysh kufijtë. Siç e dimë, në Kosovë, KEDNJ është e inkorporuar si pjesë e të drejtës së brendshme. Kosova është një situatë specifike, ku KEDNJ gjen zbatim të drejtpërdrejtë, pa qenë nënshkruese e saj. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë nevojë që në masë edhe më të madhe t'iu referohen dispozitave të Konventës dhe praktikës së GJEDNJ, andaj trajnimi i kësaj teme është i rëndësishme në mënyrë që gjyqtarët dhe prokurorët të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me mënyrën e adoptimit të

KEDNJ, specifikisht dispozitat e neni 10 të KEDNJ, në sistemin nacional.

Si bëhet interpretimi i neni 10 të Konventës Evropiane? Si bëhet zbatimi gjyqësor i neni 10 në Kosovë dhe si vihet në jetë praktika gjyqësore e GJEDNJ-së lidhur me këtë nen? Cilat janë sfidat/vështirësitë që ka një zbatim jo të kënaqshëm të këtij neni?

Në trajnim dilemat dhe pyetjet do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste dhe përdorur shembuj konkret. Do t'iu jepet përgjigje pyetjeve rreth mënyrave të zbatimit të neni 10 të KEDNJ-së në sistemin nacional, përmes rasteve nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

Përmbajtja

- * Kuptimi dhe natyra juridike e lirisë së shprehjes;
- * Analizë e neni 10 të KEDNJ-së;
- * Efektet që prodhon neni 10 i KEDNJ-së në sistemin nacional;
- * Balancimi i të drejtës së lirisë së shprehjes ndaj së drejtës për liri në jetën private sipas GJEDNJ.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë natyrën juridike të lirisë së shprehjes;
- * Analizojnë drejtë dispozitat mbi të drejtën e lirisë së shprehjes;
- * Njohin efektet që prodhon neni 10 i KEDNJ-së në sistemin nacional;
- * Vlerësojnë balancimin e të drejtës së lirisë së shprehjes ndaj së drejtës për liri në jetën private sipas GJEDNJ.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

85. Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin

Raportet e mekanizmave ndërkombëtar, institucioneve dhe organizatave të ndryshme vendore që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit LGBTI, kanë vënë nevojën, në mes tjerash, për adresimin e çështjes së moszbatimit të mirëfilltë të legjislacionit për trajtim të barabartë.

Sa gjen zbatim legjislacioni mbi mos diskriminimin në Kosovë? Sa pranohet diversiteti në shoqëri? A ka paragjykime?

Ky trajnim synon qartësimin dhe zbërthimin e kompleksitetit të legjislacionit për mos diskriminim dhe ngacmim si dhe qasjen dhe trajtimin e barabartë nga gjyqësori.

Përmbajtja

- * Elaborimi i neneve kryesore të ligjit që rregullojnë çështjen e orientimit seksual, identitetit gjinor, diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, ngacmimit;
- * Aktivitete, ushtrime ndërgjegjësimi për diversitet, paragjykime, mosdiskriminim dhe barazi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Krijojnë një pasqyrë më të qartë dhe të gjerë për diversitetin, tolerancën dhe barazinë;
- * Zbërthejnë në detaje kompleksitetin e legjislacionit për diskriminim dhe ngacmim;
- * Përvetësojnë njohuri për qasjen dhe bashkëveprimin me pjesëtarët e komunitetit LGBT për realizimin e të drejtave të tyre.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë në nivelit themelor dhe të apelit.

E Drejta Ndërkombëtare dhe BE-së

86. Zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve me strukturën e sistemit juridik të Bashkimit Evropian dhe rolin e gjykatave nacionale në sistemin gjyqësor të Bashkimit Evropian. Synim tjetër është edhe analiza dhe shtjellimi i burimeve të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe parimeve të përgjithshme të saj.

Në fokus do të jenë edhe dilemat dhe pyetjet që kanë të bëjnë me parimet e së Drejtës së BE-së, burimet e së drejtës evropiane dhe llojet e tyre, efekti i së drejtës evropiane dhe zbatimi i së i saj në nivel nacional parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian dhe efektin e kësaj të drejte në nivel nacional.

Metodat që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegimi teorik, duke përdorur ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik për të zbërthyer strukturën e sistemit juridik të BE dhe rolin e gjykatave nacionale në sistemin gjyqësor të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

- * Marrëveshja për Stabilizim – Asocimin dhe e drejta e BE-së (efektet dhe implikimet për legjislacionin e Republikës së Kosovës., efekti i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes);
- * Sistemi gjyqësor i Bashkimit Evropian dhe roli i gjykatave nacionale;
- * Pasqyra e instrumenteve juridike të BE-së;
- * Ndikimi i së drejtës evropiane në gjyqësorin e Republikës së Kosovës;
- * Interpretimi i së drejtës nacionale në pajtim me Urdhëresat (Direktivat);
- * Zbatimi i parimeve të Bashkimit Evropian nga ana e gjyqtarëve vendor; epërsia, efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Të interpretojnë drejtë Marrëveshjen për Stabilizim –Asocim dhe të drejtën e BE-së;
- * Të zbërthejnë sistemin gjyqësor të Bashkimit Evropian dhe rolin e gjykatave nacionale, si dhe instrumenteve juridike të BE-së;
- * Njohin efektin dhe ndikimin e së drejtës evropiane në gjyqësorin e Republikës së Kosovës;
- * Të zbatojnë parimet e Bashkimit Evropian dhe interpretojnë epërsinë dhe efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të tyre.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore, të Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

87. Zbatimi Gjyqësor i Konventës së Arhusit (e drejta në informacion, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi mjedisore)

Konventa e UNECE (KEEOKB-Komisioni Ekonomik për Evropën e OKB-së) lidhur me të drejtën në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi në çështje mjedisore vendos një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore për të fuqizuar demokracinë mjedisore. Konventa përmban tre shtylla themelore: 1. E drejta e publikut për të pasur e për të kërkuar informacion mjedisor; 2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit; 3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit. Ndonëse Kosova nuk është palë e Konventës së Arhusit, nga të dhënat e mbledhura rezultojnë se zbatimi gjyqësor i kësaj Konvente në trajtimin e kontesteve administrative dhe civile është ende i mangët. Rrjedhimisht, gjyqtarët por edhe prokurorët kanë nevojë të konsiderueshme që të thellojnë njohuritë e tyre rreth zbatimit të kësaj Konvente.

Cilat janë problemet në zbatimin e Konventës në Republikën e Kosovës? Si mbrohen të drejtat e individëve për qasje në informacione mjedisore dhe pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes? Si mund të zbatohet Konventa në mënyrë direkte? Përgjegjësia penale për ndotjen e mjedisit?

Dilemat dhe pyetjet gjatë trajnimit do të adresohen përmes analizës teorike dhe normative të Konventës por duke u mbështetur edhe në raste konkrete nga vendi dhe vendet në rajon. Për më tepër, në kuadër të trajnimit do të përdoren ushtrime, diskutime dhe shembuj praktik duke u mbështetur në Konventën Aarhus, Direktivën 2003/4/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (28 Janar 2003) mbi qasjen publike në informata mjedisore dhe Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Përmbajtja

- * Qasja në informacion mjedisor;
- * Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje;
- * Qasja në drejtësi mjedisore;
- * Përgjegjësia penale në fushën e mjedisit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë të drejtat për qasje në informacionet mjedisore;
- * Çmojnë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës;
- * Analizojnë përgjegjësinë penale për ndotjen e ambientit.

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Kompetenca interdisiplinare

88. Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve

Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë ka për qëllim të përcaktoj rregullat e sjelljes së gjyqtarëve në Republikën e Kosovës si dhe të vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet ta ketë gjyqtari. Rregullat e sjelljes së gjyqtarëve janë të sendërtuara mbi parimet bazë të etikës profesionale si: Pavarësia, Paanshmëria, Barazia, Integriteti, Profesionalizmi dhe përgjegjësia në punë, Konfidencialiteti dhe raportet me publikun e mediat. Rregullorja për përcaktimin e sjelljes së pa hijshme përcakton sjelljet e pahijshme të gjyqtarëve, kategorizimi i tyre si dhe përcaktimi në parim i sanksioneve disiplinore për shkeljet e kryera për të cilat gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore.

Cilat janë ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë, në raport me kodin paraprak? Si kategorizohen sjelljet e pa hijshme dhe cilat janë sanksionet që përmban Rregullorja për përcaktimin e sjelljeve të pa hijshme?

Trajnimi është hartuar në atë formë që, përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtoj në mënyrë të hollësishme ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë dhe Rregulloren për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme.

Përmbajtja

- * Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë;
- * Rregullorja për përcaktimin e sjelljeve të pa hijshme.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Identifikojnë ndryshimet dhe risitë e Kodit të ri të Etikës profesionale për gjyqtarë;
- * Njohin Rregulloren për përcaktimin e sjelljeve të pa hijshme.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë të të gjitha niveleve.

89. Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën penale

Shkrimi dhe arsyetimi ligjor ka për qëllim të ndihmoj gjyqtarët dhe prokurorët, në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në hartimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Hartimi i vendimeve gjyqësore kërkon që krahas zotërimit të shkathtësive në shkrim dhe argumentim të përdoren edhe metoda të caktuara të cilat përdoren në përpilimin e këtyre vendimeve. Nga monitorimi i gjykatave rezulton se është i nevojshëm avancimi i shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përpilimin e vendimeve gjyqësore konform metodës IRAC, si një ndër metodologjitë ma bashkëkohore e cila gjen zbatim në praktika ligjore të shumë vendeve të cilat kanë sistem të përparuar të drejtësisë sa i përket shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

Si mund të zbatohet metoda IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore? Cila është struktura e vendimeve që e përcakton kjo metodë? Cilat janë vështirësitë në aplikimin e metodës IRAC në vendimet gjyqësore të lëmisë penale?

Ky trajnim është hartuar të elaboroj udhëzimet teorike dhe praktike në hartimin e vendimeve gjyqësore sipas metodës IRAC, me qëllim që një vendim të jetë sa më profesional dhe me një arsyetim të detajuar dhe mirë të argumentuar.

Përmbajtja

- * Hartimi dhe arsyetimi ligjor;
- * Zbatimi i metodës IRAC të vendimet penale.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Hartojnë vendimet gjyqësore sipas standardeve më të larta;
- * Zbatojnë metodën IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore të lëmisë penale.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë.

90. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me një çështje civile, vendimet i merr në formë të aktgjykimit dhe aktvendimit. Një nga pjesët kryesore të vendimit gjyqësorë është arsyetimi, i cili duhet të përpilohet në mënyrë të qartë, të përmbaj kërkesat e palëve, provat e administruara, faktet veç e veç dhe provat për vërtetimin e tyre, si dhe dispozitat materiale dhe vlerësimet e gjykatës. Gjatë praktikës gjyqësore vërehet se mangësitë më të mëdha në hartimin e vendimeve gjyqësore paraqiten në arsyetimin e tyre, ku shpeshherë nuk paraqiten arsye për faktet vendimtare ose arsyet e paraqitura janë kundërthënëse dhe në kundërshtim me provat e administruara. Është shumë e rëndësishme pjesa arsyetuese e vendimeve gjyqësore, andaj është adekuate të aplikohen teknikat e hartimit dhe arsyetimit gjyqësor. Një nga metodat shumë të rëndësishme në përpilimin e vendimeve gjyqësore është metoda IRAC (anglisht), ku aplikimi i kësaj metode dhe përpilimi i vendimeve në bazë të saj ka dëshmuar që vendimet gjyqësore janë më profesionale dhe me arsyetim të detajuar.

Çka është metoda IRAC? Si mund të zbatohet metoda IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore? Cilat janë vështirësitë në aplikimin e metodës IRAC? etj.

Kjo temë do të trajtohet me qëllim të avancimit të njohurive të gjyqtarëve dhe përfitimit e zotërimit të shkathëtësive në shkrim dhe argumentim të vendimeve gjyqësore, në mënyrë që ato të jenë të përpiluara në formë profesionale dhe me një arsyetim bindës dhe të argumentuar mirë.

Përmbajtja

- * Metoda IRAC dhe përmbajtja e saj;
- * Zbatimi i metodës IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore;
- * Arsyetimi i vendimeve gjyqësore;
- * Teknikat e hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Të zbatojnë në mënyrë efektive metodën IRAC;
- * Zbatojnë drejtë teknikat kryesore të hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore;
- * Njohin esencën e problemeve ligjore dhe joligjore lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- * Krijojnë një formë të unifikuar dhe standardizuar të vendimeve gjyqësore nëpër gjykata të regjioneve të Kosovës.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore - divizioni civil.

91. Menaxhimi i Rasteve

Zbatimi i teknikave të menaxhimit të rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët në krahasim me menaxhimin e fluksit të rasteve me të cilat merren gjykatat dhe prokuroritë paraqesin sfida të cilat janë mjaft problematike në punën e përditshme. Ndikim në këtë problem kanë edhe ndryshimet në strukturën organizative që janë bërë në gjykata dhe prokurori e të cilat do të kenë një efekt pozitiv në përmirësimin e menaxhimit të rasteve.

Cila është natyra dhe rëndësia e menaxhimit të rasteve në punën praktike të gjykatave dhe prokurorive?

Cilat janë vështirësitë që kanë të bëjnë me menaxhimin e rasteve?

Ky trajnim është hartuar t'i përgjigjet pyetjeve të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe administrimin e lëndëve në gjykata dhe prokurori. Fokusi qëndron në adresimin e problemeve dhe strategjive të reja me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të efektivitetit të punës dhe evitimit të problemeve praktike.

Përmbajtja

- * Menaxhimi të rasteve;
- * Parimet themelore të menaxhimit të rasteve;
- * Teknikat kryesore të menaxhimit të rasteve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Avancojnë njohuritë në menaxhimin e rasteve;
- * Respektojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- * Demonstrojnë teknikat e menaxhimit të rasteve.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë.

92. Menaxhimi i stresit

Menaxhimi i stresit është i një rëndësie të veçantë. Stresin mund ta menaxhojmë vetëm nëse jemi shpirtërisht dhe fizikisht në nivelet tona optimale të energjisë, përndryshe nuk do të jemi në gjendje ta menaxhojmë nervozen dhe stresin ditor. Kur jemi nervoz dhe nën stres nuk jemi kreativ, jemi në gjendje të vetëmbrojtjes dhe jemi të barikaduar ndaj zgjidhjeve kreative që do të mund të zgjedhin situatën tonë. Prandaj, kuptohet lehtë që në këtë gjendje “menaxhimi i kohës” është një stresues shtesë dhe nuk kemi kurrfarë force ndaj saj. Stresi nuk do të adresohet dhe menaxhohet nëse vazhdimisht tentojmë që fajin t’ua lëmë të tjerëve. Situatat stresuese do të vazhdojnë deri sa ne nuk të njohim veten dhe të menaxhojmë veten në relacion me të tjerët.

Por, si të menaxhohet stresi? Si do të identifikoni elementet e këqija të cilat ndikojnë në shtimin e stresit? Si të zbatohen rregullat e ndryshme të cilat ndikojnë në mënjanimin e stresit dhe forcimit të personaliteti dhe ngritjen e energjisë pozitive? Cila është gjëja më e vlefshme që kërkon shfrytëzimin e kohës kur jeni nën ndikim të presionit?

Trajnimi fokusohet në shtjellimin e praktikave më të mira që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të stresit i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet e punës.

Përmbajtja

- * Kuptimi dhe rëndësia e menaxhimit të kohës;
- * Identifikimi i elementeve të stresit;
- * Teknikat për menaxhimin e stresit;
- * Mënyra e përcaktimit të shkallës së stresit;
- * Trajtimi i stresit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë rëndësinë e menaxhimit të kohës;
- * Identifikojnë elementet e stresit;
- * Menaxhojnë stresin.

Kohëzgjatja



Dy ditor

Përfituesit



Gjyqtarë dhe prokurorë.

Programet e Specializuara

93. Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit

Ky program i specializuar trajnimi synon që në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse t'i adresojë nevojat për zhvillim profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me luftimin e veprave penale korruptive.

Programi do të trajtojë sfidat rreth zbatimit të legjislacionit vendor në luftimin efikas të korrupsionit duke u fokusuar në aspekte specifike që paraqiten si problematike në praktikë. Krahas tyre, po ashtu do të trajtohet legjislacioni ndërkombëtar në këtë fushë me fokus në atë të BE-së, përfshirë standardet dhe praktikatat e suksesshme të vendeve që kanë arritur sukses në luftimin e kësaj dukurie.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut do të jetë në kuadër të këtij programi. Po ashtu në fokus do të jenë aspekte të avancimit të hartimit të akteve ligjore. Format e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit janë ndër temat që përfshihen në këtë program ku gjithsesi do të trajtohen edhe aspektet e menaxhimit efikas të rasteve të korrupsionit. Pjesë shumë e rëndësishme e programit është edhe diskutimi rreth aspekteve të kodeve të etikës për gjyqtarë dhe prokurorë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- * Demonstronjë përdorimin e saktë të koncepteve dhe parimeve në luftimin më efikas të veprave korruptive;
- * Zbatonjë ligjet dhe teorinë në situata praktike;
- * Vlerësojnë relevancën e të dhënave dhe burimeve në qasjen ndaj kësaj dukurie.

Struktura

Struktura e këtij programi realizohet në tri sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarë policor të departamenteve për luftimin e korrupsionit, zyrtarë doganorë.

Përmbajtja

Sesioni I

Kohëzgjatja

Dy ditore

1. Identifikimi dhe Vlerësimi i Korrupsionit të mundshëm zyrtar

- * Struktura ligjore vendore dhe ndërkombëtare si dhe praktikant;
- * Njohja dhe vlerësimi i çështjeve potenciale korruptive.

2. Analizimi i informatave publike të disponueshme

- * Planet hetuese dhe hapat e pare;
- * Qasja në dokumente dhe informata jo publike;
- * Zhvillimi i një plani hetues;
- * Marrja dhe kërkimi i evidencave elektronike.

Sesioni II

Kohëzgjatja

Dy ditore

1. Analizat forenzike

- * Përdorimi i mjeteve të institucioneve relevante për luftimin e korrupsionit në qasjen në të dhënat financiare.

2. Analizimi i transaksioneve të rrishtit të lartë

- * Përdorimi i mjeteve të institucioneve relevante për luftimin e korrupsionit në qasjen në rekordet financiare;
- * Analizimi i transaksioneve të rrishtit të lartë.

3. Intervistat dhe përgatitja për gjykim

- * Teknikat e intervistimit dhe sfidat;
- * Radhitja e provave;
- * Intervistimi i dëshmitarëve potencial;
- * Argumentet e mundshme të mbrojtjes dhe sfidat në gjyq.
- * Intervistimi i objektivëve të mundshëm;

Sesioni III

Kohëzgjatja

Dy ditore

- * Zgjidhja e rasteve të korrupsionit zyrtar;
- * Masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtar.
- * Shkuarja në gjyq - paraqitja e rastit;
- * Zgjidhjet e mundshme alternative;

94. Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës

Bazuar në raportet e institucioneve dhe organizatave që monitorojnë gjyqësorin në Kosovë vlerësohet se prokurimi publik është një prej fushave ku ka korrupsion dhe se ka nevojë për zhvillim të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për këtë fushë. Po ashtu është kërkesë e vazhdueshme e gjyqtarëve dhe prokurorëve që të diskutojnë me të gjithë akterët relevant në vend rreth procedurave të prokurimit publik dhe problemeve të zbatimit të tyre në praktikë.

Ky program adreson kërkesat e lartpërmendura duke u fokusuar në elaborimin praktik të të gjitha fazave të prokurimit publik. Në këtë kuadër do të analizohen rastet nga praktika rreth mënyrës së vlerësimit të nevojave dhe përcaktimit të kërkesave, dosja e tenderit dhe procesi i vlerësimit të një tenderi. Në fokus të këtij programi do të jenë edhe faza e implementimit të kontratës dhe po ashtu hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij programi trajnues, përfituesit do të jenë në gjendje të:

- * Analizojnë procesin e planifikimit të prokurimit;
- * Kuptojnë dhe zbërthejnë dosjen e tenderit;
- * Vlerësojnë specifikacionet teknike dhe njoftimin indikativ;
- * Kuptojnë elementet për zgjedhjen e kontraktorit dhe dhënies së çmimit;
- * Identifikojnë indikatorët e korrupsionit që lidhen me prokurimin publik;
- * Të hartojnë një plan për hetimin e veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik.

Struktura

Struktura e këtij programi realizohet në dy sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, hetues policor, zyrtarë doganorë, zyrtarë nga ATK dhe NJIF.

Përmbajtja

Sesioni I

Kohëzgjatja Dy ditore

Vlerësimi i nevojave/Përcaktimi i kërkesave

- * Planifikimi i prokurimit;
- * Njoftimi indikativ;
- * Specifikimi teknik.

Përgatitja/Procesi i dizajnit dhe përgatitja e dokumenteve të ofertimit

- * Dosja e tenderit;
- * Dorëzimi i dosjes së tenderit (sqarimet);
- * Hapja publike.

Zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit

- * Komisionet vlerësuese;
- * Kriteret e vlerësimit;
- * Rekomandimi i operatorit fitues.

Sesioni II

Kohëzgjatja Dy ditore

Faza e implementimit të kontratës

Rreziqet indikativë të korrupsionit në fazat e prokurimit

- * Vlerësimi i Nevojave/përcaktimi i kërkesave;
- * Përgatitja/Procesi i dizajnit dhe përgatitja e dokumenteve të ofertimit;
- * Zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit;
- * Faza e implementimit të kontratës.

Skemat korruptive dhe problemet e ndërlidhura me mashtrim

- * Pagesa e haraçit;
- * Konflikti i interesit;
- * Skemat e kurdisjes së ofertave;
- * Ofertomi konspirativ;
- * Skemat mashtruese.

Planifikimi i hetimit dhe ndjekja

- * Përmbajtja e planit të hetimit;
- * Identifikimi i burimeve të informacionit;
- * Planifikimi i kontrollit të shtëpisë dhe përgjimi;
- * Planifikimi i përdorimit të informatorëve;
- * Planifikimi i gjurmimit të aseteve.

95. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik

Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe veçanërisht i internetit ka marrë një rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Ky fenomen prek jo vetëm aktivitetet e një organizmi qoftë ai shtetëror apo privat, i përfshirë në sferën e biznesit apo të një aktiviteti jo fitimprurës, por mund të prekë dhe njeriun e thjeshtë në aktivitetin e tij të përditshëm, në sferën e tij private apo profesionale. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime, por në të njëjtën kohë dhe një sërë problemesh. Krimi kibernetikë është një fenomen kompleks dhe e vetmja mënyrë për t'i bërë ballë do të ishte trajtimit globalë i këtij problemi. Për këtë duhet një bashkëpunim i të gjitha institucioneve relevante dhe ekspertëve të fushave të ndryshme për të shmangur zgjidhjet segmentare. Për këtë është e rëndësishme të konceptojmë një arkitekturë globale të sigurisë së informacionit që të marrë në konsider-

atë brenda saj dimensionin teknik dhe operacional, dimensionin juridik dhe rregullator, dimensionin organizativ dhe ekonomik duke mos harruar dimensionin human.

Çka është krimi kibernetikë? Nga vjen? Çfarë e ndihmon të jetë kaq i përhapur? Si të luftohet dhe të parandalohet krimi kibernetikë? Sa jemi të rrezikuar nga ky krim? Kush janë viktimat e mundshme të krimit kibernetikë? Cili është legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar që e sanksionon krimin kibernetikë?

Programi trajnues është hartuar në mënyrë që të ofroj njohuri për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me tendencat aktuale të krimit kibernetikë dhe teknikave kyçe për luftim të suksesshëm të veprave të kësaj natyre.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë rrishtun potencial të krimit kibernetikë dhe zhvillojnë teknikat për luftimin e tij;
- * Menaxhojnë hetimet për krimin kibernetikë;
- * Identifikojnë dhe parandalojnë më mirë veprat penale të kësaj natyre;
- * Njohin tendencat e krimit kibernetikë.

Struktura

Struktura e këtij programi realizohet në tri sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarë policor të departamenteve përkatëse për luftimin e krimit kibernetikë.

Përmbajtja

Sesioni I

Kohëzgjatja Dy ditore

- * Teknologjia dhe krimi;
- * Interneti dhe krimi;
- * Kërcënimet, tendencat dhe sfidat e krimit kibernetikë;
- * Krimi kibernetikë si vepër penale dhe sfidat në luftimin e tij.

Sesioni II

Kohëzgjatja Dy ditore

- * Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut;
- * Luftimi i rreziqeve të sigurisë virtuale: email, viruset dhe hakerat;
- * Zbulimi dhe parandalimi i pastrimit të parave;
- * Roli i forenzikës në zbulimin e krimit kibernetikë;
- * Marrja e provave elektronike;
- * Provat elektronike – procedura dhe praktika.

Sesioni III

Kohëzgjatja Dy ditore

- * Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetikë; Skemat e kurdisë së ofertave;
- * Mundësitë e ndjekjes së suksesshme të e-krimit ndërkombëtar dhe krimit kibernetikë.

96. Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave

Shpëlarja e parave është vepër penale që hyn në grupin e veprave penale kundër ekonomisë dhe paraqet rrezik permanent për ekonominë e të gjitha vendeve. Operacionet e pastrimit të parave janë të dizajnuara për të marrë të ardhurat nga veprimtari të paligjshme, të tilla si fitimet nga mashtrimet, dhe duke fshehur ekzistencën, burimin, ose zbatimin e këtyre fondeve në mënyre që të ardhurat të duket se vijnë nga një burim legjitim. Me pak fjalë, “paratë e pista” janë bërë për të dalë i pastër. Pasi paratë e paligjshme janë pastruar, kryerësi është në gjendje të shpenzojë apo të investojë të ardhurat e paligjshme në asete të ligjshme. Kosova si një vend i dal nga lufta e me specifikat e veta, ka vështirësi në luftimin e ekonomisë joformale ku pjesa më e madhe e transaksioneve kryhet në para të gatshme, pa i përfillur dhe pa kaluar nëpër institucione financiare. Kjo në veçanti paraqet vështirësi në punën e institucioneve që kanë obligim raportimin e transaksioneve. Kësaj i kontribuon po ashtu edhe bashkëpunimi i dobët ndërkombëtar në këtë fushë dhe mosharmonizimi i legjislacionit vendor me Direktivën e BE-së.

Cilët janë faktorët për identifikimin e ekonomisë joformale? Cili është roli i NJIF-it? Ku qëndron raporti i legjislacionit vendor me atë të BE-së?

Trajnimi do të fokusohet në adresimin e këtyre dilemave dhe pyetjeve të ngritura duke analizuar në hollësi legjislacionin vendor dhe atë të BE-së përfshirë dhe praktikatat më të mira.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Klasifikojnë veprat penale të shpëlarjes së parave;
- * Krahasojnë legjislacionin vendor me atë të BE-së;
- * Njohin dhe analizojnë punën e institucioneve financiare dhe obligimet që i kanë këto institucione në luftimin e kësaj dukurie;
- * Përdorin teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave;
- * Njohin format e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- * Analizojnë paraqitjen e rastit në gjykatë.

Struktura

Struktura e këtij programi realizohet në tri sesione që zgjasin nga dy (2) ditë secili.

Përfituesit



Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Apelit, prokurorët e prokurorive themelore dhe të Apelit dhe të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, zyrtarë policor të departamenteve për luftimin e korrupsionit, Gjyqtarë dhe prokuror të nivelit themelor, prokuroria speciale dhe zyrtar nga Policia e Kosovës.

Përmbajtja

Sesioni I

Kohëzgjatja Dy ditore

- * Vepra penale e shpëlarjes së parave, financimi i terrorizmit dhe sanksionet;
- * Dobësitë e institucioneve financiare tek pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit;
- * Luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në praktikë;
- * Luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit - struktura ligjore;
- * Njësia për inteligjencë financiare dhe subjektet raportuese.

Sesioni II

Kohëzgjatja Dy ditore

- * Teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave;
- * Mbledhja e informatave;
- * Përgatitja e profilin personal;
- * Gjurmimi i fondeve nga ana e marrësit;
- * Gjurmimi i fondeve nga ana e paguesit;
- * Rikthim të pasurive të fshehura.

Sesioni III

Kohëzgjatja Dy ditore

- * Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave;
- * Shkuarja në gjyq - paraqitja e rastit;
- * Zgjidhjet e mundshme alternative;
- * Masat për parandalimin e pastrimit të parave.

Programi Orientues për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit të sapoemëruar

Për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapoemëruar në këto funksione, do të ofrohen trajnime adekuate me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të tyre të karakterit profesional, interdisiplinar dhe personal. Programi orientues i përcaktuar për këtë kategori përgatit përfituesit e tij për kryerjen e punës me sukses menjëherë pas marrjes së detyrës. Ky program ka për qëllim që të informoj përfituesit e tij lidhur me shkathtësitë praktike të të qenurit gjyqtar përkatësisht prokuror i shtetit me fokus në:

- * Ballafaqimin me paanshmërinë, qëndrimin dhe vlerat;
- * Sjelljen e përshtatshme brenda dhe jashtë gjykatës/prokurorisë;
- * Etiken profesionale;
- * Mësimin e komunikimit efektiv;
- * Shkathtësitë ne procedure gjyqësore dhe marrjen e vendimeve;
- * Implementimin e praktikave me te mira.

Gjatë zbatimit të programit lidhur me përcaktimin e moduleve trajnuese kujdes i veçantë do t'i kushtohet faktit se gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar kanë përfunduar apo jo Programin e Trajnimit Fillestar. Për këtë kategori fokusi i programit trajnues do të jetë tek; fusha penale materiale/procedurale, civile materiale/procedurale, administrative, drejtësia për fëmijë, e drejta ekonomike, shkrimi dhe arsyetimi gjyqësor, menaxhimi i rastit, shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim, etikë profesionale, e drejta ndërkombëtare (Acquis communautaire) dhe të drejtat e njeriut.

97. Programi Orientues për gjyqtarët/prokurorët që emërohen në këto pozita për herë të parë (pasi që kanë përfunduar trajnimet në PTF)

Faza e parë përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, e të cilat janë:

- * Kompetenca dhe juridiksioni në departamentin përkatës dhe;
- * Simulimi i gjykimit-metoda e studimit të rastit konkret (varësisht nga departamenti).

Faza e dytë përmban module që fokusohen në kompetencën interdisiplinare dhe personale, e të cilat janë:

- * Teknikat e përfaqësimit në gjykim;
- * Menaxhimi i rasteve;
- * Komunikimi.

98. Programi Orientues për gjyqtarët/prokurorët që emërohen në këto pozita për herë të parë (të cilët nuk kanë ndjekur trajnimet në PTF)

Faza e parë përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, e të cilat janë:

- * Kompetenca dhe juridiksioni në departamentin përkatës;
- * Simulimi i gjykimit;
- * Metoda e studimit të rastit konkret (varësisht nga departamenti).

Faza e dytë përmban module që fokusohen në kompetencën interdisiplinare dhe personale, e të cilat janë:

- * Shkrimi dhe arsyetimin gjyqësor;
- * Teknikat e përfaqësimit në gjykim;
- * Menaxhimi i rasteve;
- * Komunikimi;
- * Etika profesionale.

99. Gjyqtarët/prokurorët e avancuar nga një nivel në tjetrin dhe/apo që ricaktohen nga një departament në tjetrin si dhe ata që ndërrojnë profilet

Avancimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga një nivel në nivelin tjetër të gjykatave apo prokurorive shtojnë nevojën që këto ndryshime të shoqërohen edhe me ndjekjen e disa trajnimeve specifike nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat do t'i përshtaten veçorive të tyre. Në këtë drejtim IGJK ofron programe orientuese për secilën nga këto kategori, të cilat janë të gatshme për zbatim në çdo kohë kur ndodhin këto avancime brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial apo ndërrime të profileve.

Programet orientuese për gjyqtarët dhe prokurorët që avancohen nga një nivel në tjetrin fokusohen në zhvillimin e shkathtësive dhe praktikave si:

- * Ballafaqimi me procedurat e reja dhe juridiksionin e ri;
- * Roli i gjyqtarit apo prokurorit sipas kompetencës së nivelit ku janë avancuar;
- * Nxjerrja dhe arsyetimi i vendimeve të drejta;
- * Përfaqësimi i ndjekjes penale para Gjykatës së Apelit.

Ndërrimi i profilit nga gjyqtar në prokuror apo anasjelltas, po ashtu imponon nevojën e ndjekjes së trajnimeve specifike të cilat i përshtaten veçorive të funksioneve përkatëse. Programi orientues për këta përfitues i informon për karakteristikat e të qenurit gjyqtar/prokuror, natyrën dhe përgjegjësitë e njërit apo tjetrit funksion me fokus:

- * Ballafaqimin me pozitën e re dhe përgjegjësitë që dalin nga ky funksion;
- * Veprimet procedurale që ndërmerr gjyqtari apo prokurori;
- * Grumbullimin e provave dhe përfaqësimin e aktakuzës;
- * Analizimin dhe administrimin e provave.

100. Programi Orientues për Gjyqtarë/ prokurorë nga niveli themelor në atë të Apelit

Përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, e të cilat janë:

- * Kompetenca dhe juridiksioni ne nivelin e apelit;
- * Kompetenca dhe juridiksioni departamentin përkatës.

101. Programi Orientues për kategorinë që kalon nga pozita e gjyqtarit në atë të prokurorit dhe anasjelltas

Përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, e të cilat janë:

- * Kompetenca dhe juridiksioni ne nivelin themelor/apelit;
- * Kompetenca dhe juridiksioni departamentin përkatës;
- * Karakteristikat e rolit dhe funksionit te gjyqtarit;
- * Karakteristikat e rolit dhe funksionit të prokurorit.

102. Programi Orientues për Gjyqtarë/prokurorë nga një departament në tjetrin në kuadër të njëjtit nivel

Përmban module që fokusohen në kompetencën profesionale, e teëcilat janë:

- * Kompetenca dhe juridiksioni në departamentin përkatës.

Programi i Trajnimit Fillestar

Në kuadër të mandatit ligjor Instituti Gjqësor i Kosovës zhvillon edhe aktivitete nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF) i cili fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të profesionistëve që hyjnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në cilësinë e gjyqtarit apo prokurorit të shtetit.

Ndryshimet në ligjet e gjyqësorit, reflektojnë në PTF-në sipas të cilave gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit e ndjekin këtë program pas dekretimit. Periudha e trajnimit fillestar do të zgjasë dymbëdhjetë (12) muaj përfshirë trajnimin teorik dhe atë praktik. Përcaktimi kohor me ligj mundëson që trajnimi të jetë intensiv, pasi që gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk iu caktohen raste gjatë kohës së vijimit të trajnimit fillestar. Në përfundim të trajnimit fillestar gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit do të vlerësohen.

Mbështetur në këto zhvillime, IGJK ka ndryshuar dhe plotësuar aktet nënligjore të cilat rregullojnë përmbajtjen, kohëzgjatjen e trajnimit teorik dhe praktikë dhe vlerësimin gjatë trajnimit në PTF.

Në këtë vit dekretimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve nuk eshë në periudhën e njëjte, kjo ka imponuar që programet të hartohen ndaras. Programi i Trajnimit Fillestarë për prokurorët e sapoemëruar është hartuar dhe miratuar dhe do të zbatohet me gjeneratën e radhës, ndërkaq për programi për gjyqtarët është në proces të hartimit dhe do të jetë i gatshëm për zbatim në momentin e dekretimit të tyre.

Objektivë kryesore në kuadër të PTF-së, IGJK ka përcaktuar zhvillimin e kompetencave profesionale, personale, dhe interdisiplinare, si dhe zhvillimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapoemëruar.

Programi i Trajnimit fillestarë do të jetë sipas një modeli të kombinuar teorik dhe praktik, përmes aplikimit të metodologjisë bashkëkohore trajnuese ku përfshihen teknikat e mësimit për të rritur, po ashtu trajnimet ofrohen edhe përmes platformës së mësimit në distancë.

Ky program trajnues përfshinë trajnimet nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare, vizitë në institucionet jo-gjyqësore që lidhen me punën e gjyqtarit dhe prokurorit, si dhe pjesën praktike të trajnimit e cila zhvillohet në gjykatat apo prokuroritë ku janë emëruar, dhe ku realizojnë punën praktike në mbështetje të mentorit i cili është gjyqtar apo prokuror i shtetit.

Programi i Trajnimit Fillestar 2016/2017 për prokurorët e sapoemëruar është miratuar nga Këshilli Drejtues i IGJK-së, ndërsa Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar është në proces.

Programi për Hulumtime dhe Publikime

Instituti Gjyqësor i Kosovës në përmbushje të mandatit të tij për zhvillimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përveç trajnimeve ka në mandat edhe kryerjen e veprimtarive profesionale kërkimore të cilat i realizon përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime.

Bazuar në këtë mandat Programi për Hulumtime dhe Publikime gjatë vitit 2017 do të fokusohet në tri aspekte: hulumtime, publikime dhe ofrimin e qasjes në burime ligjore përmes bibliotekës së IGJK-së.

Qëllimi i PHP-së është:

- * Realizimi i hulumtimeve për zhvillimin e programeve trajnuese të IGJK-së;
- * Sigurimi dhe ofrimi i burimeve ligjore të nevojshme për përfituesit e vet;
- * Shfrytëzimi i resurseve ligjore për nevojat e gjyqësorit;
- * Përmirësimi i cilësisë së botimeve dhe publikimeve shkencore;
- * Inkurajimi dhe përfshirja e komunitetit ligjor veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve në publikime shkencore.

103. Hulumtimet

Hulumtimet gjatë vitit 2017 do të jenë të përkushtuara në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të programeve trajnuese si dhe për nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve trajnuese do të realizohen:

- * Analiza të programit trajnues si në aspektin e metodologjisë ashtu edhe në aspektin e përmbajtjes, përmes programeve të vlerësimit, pyetësorëve dhe takimeve me gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor të gjykatave dhe prokurorive;
- * Vlerësime të programeve dhe institucioneve trajnuese regjionale dhe ndërkombëtare;
- * Hulumtime rreth ndikimit të trajnimeve në punën e gjykatave dhe prokurorive;
- * Hulumtime rreth vështirësive në zbatim të legjislacionit në punën e gjykatave dhe prokurorive;
- * Identifikimin e problemeve praktike që do të rezultojnë me krijimin dhe zhvillimin e mjeteve juridike dhe hulumtime tjera sipas nevojave të gjyqtarëve.

Të gjitha këto analiza dhe hulumtime do të jenë ndihmesë dhe kontribuuese në zhvillimin dhe avancimin e programit trajnues për vitin 2018 dhe rritjen e performancës së IGJK-së në ofrimin e programeve trajnuese dhe performancës së punës së gjykatave dhe prokurorive.

104. Publikimet

Zhvillimi profesional i gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë arrihet edhe përmes publikimeve në fushën juridike veçanërisht në lëmin e gjyqësorit. Kjo komponentë pasuron kulturën juridike me njohuri praktike dhe teorike.

Publikimet e IGJK-së synojnë që të jenë burim informimi veçanërisht me risitë në legjislacion dhe në përgjithësi në lëmin e drejtësisë si dhe informues për aktivitetet trajnuese të IGJK-së.

Publikimet që IGJK planifikon t'i realizoj gjatë vitit 2017 janë:

Revista “Opinio Juris”, tashmë e konsoliduar si revistë e gjithë profesionistëve ligjor, e cila do të vazhdojë të nxisë komunitetin ligjor në publikimin e rezultateve hulumtuese, veçanërisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe profesionistëve tjerë në funksion të mbështetjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo revistë do të jetë një literaturë shtesë dhe lehtësuese veçanërisht për gjyqtarë dhe prokurorë.

Revista Justicia, do të përmbledhë punimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar të cilët vijojnë trajnimet në Programin e Trajnimit Fillestar.

Modulet trajnuese, janë përmbledhje e kurseve trajnuese të cilat realizohen në kuadër të programeve trajnuese. Sipas nevojës së përfituesve janë të mundshme edhe ribotimi i moduleve aktuale.

Raporti vjetor i cili pasqyron aktivitetet e IGJK-së brenda vitit.

Programi i Punës për vitin 2018 i cili përmban aktivitetet e IGJK-së që do të realizohen gjatë vitit 2018.

Programi Trajnues për vitin 2018 që reflekton nevojat e gjyqësorit për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Buletini mujor, do të vazhdojë të publikohet në baza mujore dhe të pasqyrojë aktivitetet e IGJK-së brenda muajit.

105. Biblioteka

Në përmbushje të mandatit për të ofruar burime ligjore për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë ligjor, IGJK edhe gjatë vitit 2017 do të vazhdojë me pasurimin dhe menaxhimin bibliotekës si fizike ashtu edhe asaj elektronike.

Aktivitetet e bibliotekës do të vazhdojnë si në vijim:

- * Identifikimi i titujve të ri në fushën juridike dhe sigurimi i tyre për bibliotekën e IGJK-së;
- * Njoftimi i rregullt i përfituesve me materialet e reja ligjore që posedon biblioteka e IGJK-së;
- * Do të vazhdohet me katalogimin dhe klasifikimin e materialeve të reja ligjore;
- * Ofrimi i qasjes në data baza të ndryshme ligjore deri në korrik 2018;
- * Krijimi dhe sigurimi i mjeteve që detektojnë plagjiaturën me qëllim të cilësisë së publikimeve të IGJK-së veçanërisht revistave shkencore.

Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

Menaxhmenti i gjykatave dhe prokurorive, i cili përfshinë: kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve, luajnë rol kyç në menaxhimin dhe udhëheqjen e institucionit që drejtojnë. Për udhëheqje të drejtë dhe efikase është e rëndësishme ngritja e vazhdueshme e performancës të kësaj kategorie përfituese. Mbështetur në këtë, IGJK organizon trajnime specifike për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive.

Qëllimi i këtyre trajnimeve është ngritja e shkathtësive praktike dhe performances së vazhdueshme nga ana e menaxherëve të gjykatave dhe prokurorive, në përputhje me politikat dhe standardet e aplikueshme, dhe me kërkesat ligjore.

106. Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur suksesin dhe për të arritur këtë qëllim. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e gjykatave dhe prokurorisë, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financave, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.

Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë apo prokurori? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës dhe prokurorisë?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e gjykatave dhe prokurorisë përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të gjykatave dhe prokurorisë. Gjatë tërë procesit do të behet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.

Përmbajtja

- * Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë;
- * Përgjegjësitë menaxheriale;
- * Burimet njerëzore dhe financat.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin parimet standarde të menaxhimit të mirë;
- * Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
- * Zbatojnë parimet dhe taktikat e planifikimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

107. Komunikimi në gjykata dhe prokurori

Komunikimi është transmetimi i informacionit ndërmjet anëtarëve të një institucioni dhe përfshin një gamë të gjerë të strategjive të brendshme si: komunikimin vertikal, horizontal, formal dhe joformal. Ekzistojnë dy elemente në strategjinë e komunikimit të brendshëm. Fillimisht, institucioni duhet të hartoj strategjinë dhe planin e veprimit për zbatimin e saj. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, komunikimi i brendshëm ka nevojë për një strategji të veten. Ai duhet të jetë i pozicionuar në një plan më shumë se të thjeshtë për të prekur intervenimet taktike në mbështetje të aktiviteteve të organizatës.

Çka është komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm? Cilat janë stilet e komunikimit? Sa është i rëndësishëm komunikimi në mbështetje të aktiviteteve të gjykatës apo prokurorisë?

Deri në fund të këtij trajnimi, menaxhmenti i gjykatave dhe prokurorive do të përmirësojnë aftësitë e tyre personale të komunikimit dhe do të jenë në gjendje të zgjedhin rrugën e duhur të komunikimit brenda gjykatës apo prokurorisë për të cilën ata janë përgjegjës.

Përmbajtja

- * Hyrje në strategjinë e komunikimit të brendshëm;
- * Komunikimi i menaxhmentit me mediat;
- * Shpërndarja e mesazhit;
- * Zgjedhja e kanaleve dhe kontrollit;
- * Komunikimi i projektit, komunikimi i ndryshimit, komunikimi i krizës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Avancojnë aftësitë e tyre personale të komunikimit;
- * Dallojnë komunikimin e jashtëm dhe të brendshëm;
- * Njohin stilet e komunikimit.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

Trajnimet për gjyqtarë porotë

Gjyqtarët porotë janë një kategori e rëndësishme në procese gjyqësore të kategorizuara sipas ligjit, të cilët vijnë nga radhët e profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe profesioneve tjera që kanë përvojë në edukimin e të miturve. Ata shërbejnë krahas gjyqtarëve profesionistë në trupe gjykuese në çështjet familjare dhe proceset gjyqësore që zhvillohen ndaj të miturve. Meqë

fushat prej nga ata vinë janë të ndryshme, rezulton nevoja e familjarizimit me praktikën dhe proceset që zhvillohen në gjykatë.

Qëllimi i trajnimeve për gjyqtarët porotë konsiston në nevojën për ngritje të njohurive lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisë që ju jep ligji.

108. Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurë gjyqësore

Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Ligji për Familjen parashohin kushtet ligjore kur gjyqtarët porotë janë pjesë përbërëse e trupit gjykues. Gjyqtarët porotë luajnë një rol të rëndësishëm në proceset gjyqësore, ku ata marrin pjesë, duke dhënë kontributin e tyre nga profile të ndryshme të cilave ju takojnë.

Cili është roli dhe detyra e gjyqtarëve porotë? Sa janë gjyqtarët porotë të familjarizuar me praktikën dhe proceset që zhvillohen në gjykatë?

Ky trajnim synon përmirësimin e shkathtësisë praktike të gjyqtarëve porotë në zbatimin e ligjit dhe etikes profesionale.

Përmbajtja

- * Roli dhe detyrat e gjyqtarit porotë në procedurën për të mitur;
- * Roli dhe pozita e gjyqtarit porotë në procedurën për çështje familjare;
- * Etika e gjyqtarit porotë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Vlerësojnë rëndësinë dhe peshën e vendimmarrjes nga ana e tyre;
- * Dallojnë trupin gjykues për të mitur dhe të rritur;
- * Njohin sjelljen e mirë dhe të pahijshme në bazë të parimeve dhe rregullave të etikes së gjyqtarëve porotë.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Gjyqtarët porotë.

Trajnimet për menaxhementin e administratës, dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Funksionimi i mirë i administratës gjyqësore dhe prokuroriale është një nga kushtet kryesore për një sistem të përmirësuar gjyqësor dhe prokurorial. Përdorimi i sistemeve efikase në administratën gjyqësore dhe prokuroriale në menaxhimin e punëve, i kontribuon forcimit të tërë sistemit gjyqësor e prokurorial dhe ngritë cilësinë dhe besimin e publikut në institucionet e drejtësisë. Administratorët dhe Ndihmës-administratorët kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e administratës dhe duhet të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të udhëhequr proceset brenda sistemit, për të zhvilluar plane dhe për të ndërmarrë veprime konkrete.

Komponentë tjetër e rëndësishme është edhe stafi tjetër administrativ i gjykatave dhe prokurorive. Ata kanë përgjegjësi në zhvillimin e veprimtarisë së gjykatave dhe prokurorive.

Trajnimet që u dedikohen këtyre kategorive kanë për qëllim të ofrojnë qasje të barabartë dhe kushte të përshtatshme për rritjen e kualifikimit profesional në drejtim të fuqizimit të administratës së gjykatave dhe prokurorive, sipas standardeve dhe parimeve profesionale të transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit.

109. Menaxhimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive

Administrata e gjykatave dhe prokurorive drejtohet nga administratorët dhe ndihmës administratorët. Një menaxhment funksional i administratës së gjykatave dhe prokurorive është një nga kushtet kryesore për një sistem të drejtë gjyqësor dhe prokurorial. Trajnimet për menaxhmentin e administratës së gjykatave dhe prokurorive do të sigurojnë kushte të përshtatshme për rritjen e kualifikimit profesional të çdo kategorie të stafit administrativ dhe do të ndërtojë një administratë të fuqishme profesionale të gjykatave dhe prokurorive.

Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të administratës së gjykatës dhe prokurorisë? Si të menaxhohet koha dhe situatat stresuese? Cilat janë dobitë që derivojnë nga puna ekipore?

Me këtë trajnim synohet rritja e njohurive dhe aftësive praktike të menaxhmentit të administratës së gjykatave dhe prokurorive me funksionet menaxhuese për përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe funksionimin e gjykatave, prokurorive dhe njësisë të ndryshme administrative.

Përmbajtja

- * Hyrje në menaxhimin e administratës së gjykatave dhe prokurorive, parimet dhe standardet për menaxhim të mirë;
- * Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- * Vlerësimi i stileve menaxheriale dhe prezantimi mbi specifikat e llojeve të ndryshme të menaxhimit;
- * Roli i administratorëve të gjykatave dhe prokurorive për zbatimin e planeve dhe politikave strategjike;
- * Lidershipi, planifikimi dhe ndërtimi i ekipit;
- * Menaxhimi i kohës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin parimet standarde të menaxhimit të mirë;
- * Vlerësojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
- * Organizojnë mirë menaxhimin e kohës;
- * Menaxhojnë situatat stresuese dhe konflikteve;

Kohëzgjatja

Një ditë

Përfituesit

Administratorët, Ndihmës administratorët e gjykatave dhe prokurorive dhe zyrtarët për personel.

110. Komunikimi i jashtëm dhe i brendshëm

Komunikimi nënkupton transmetimin e informacionit ndërmjet anëtarëve të një institucioni dhe përfshin një gamë të gjerë të strategjive të brendshme si: komunikimin vertikal, horizontal, formal dhe joformal. Komunikimi bashkëpunues karakterizon ndërveprimin me të tjerët, ndërton infrastrukturën dhe i krijon mundësi të tjerëve në staf për të bashkëpunuar me shumë efektivitet me njëri tjetrin.

Çka është komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm? Cilat janë stilet e komunikimit? Sa është i rëndësishëm komunikimi në mbështetje të aktiviteteve të gjykatës apo prokurorisë?

Ky trajnim synon përmirësimin e komunikimit brenda administratës, gjithashtu orienton pjesëmarrësit kah shkathhtësitë e komunikimit në ofrimin e shërbimeve gjyqësore efikase, efektive dhe transparente.

Përmbajtja

- * Komunikimi i jashtëm dhe politikat e standardet e aplikueshme;
- * Komunikimi i brendshëm: rrjedha e informacionit, hierarkia, puna ekipore dhe shkëmbimi i informacionit, konfidencialiteti i të dhënave dhe informatave, dhe sjellja dhe etika profesionale;
- * Delegimi i detyrave, monitorimit dhe mbikëqyrjes;
- * Planifikimi, vendosja e prioritetëve dhe caktimi i detyrave;
- * Raportimi.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Dallojnë komunikimin e jashtëm dhe të brendshëm;
- * Njohin stilet e komunikimit;
- * Kuptojnë drejtë planifikimin dhe caktimin e prioritetëve.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Administratorët, ndihmës administratorët dhe zyrtarët për informim të gjykatave dhe prokurorive.

111. Menaxhimi i rrjedhës së rasteve

Përdorimi i sistemeve efikase në administratën gjyqësore dhe në menaxhimin e rrjedhës së rasteve (lëndëve) kontribuon në forcimin e tërë sistemit gjyqësor dhe në ngritjen e cilësisë dhe besimit të publikut në drejtësi. Rëndësia e menaxhimit të drejtë të rasteve në institucionet e drejtësisë është shumë e madhe për faktin se një menaxhim i mirë, në rend të parë lehtëson punën në këto institucione, eliminon situatat jo të dëshirueshme, rrite efikasitetin e punës, eliminon humbjen e kohës, krijon një ambient të mirë kolegjal, rrite nivelin e llogaridhënies në punë, ndikon direkt në kryerjen e rasteve në afate ligjor

apo të arsyeshëm si dhe ndikon në rritjen e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë.

Cilat janë rregullat dhe praktikat ligjore të aplikueshme? Si të menaxhohen në mënyrë efikase numri i lëndëve të grumbulluara? Cilat janë sfidat dhe vështirësitë në menaxhim e rasteve?

Trajnimi do të jep udhëzimet e nevojshme për përgatitjen e menaxhimit të rasteve dhe përdorimin e sistemeve efikase në menaxhimin e mire të lëndëve.

Përmbajtja

- * Rregulloret, rregullat dhe praktikat ligjore të aplikueshme;
- * Specifikat në menaxhimin e rrjedhës së rasteve në gjykata dhe prokurori;
- * Aspektet procedurale dhe praktike të menaxhimit të rrjedhës së rasteve dhe roli i secilës kategori të stafit;
- * Përpunimi dhe raportimi i të dhënave, respektimi i afateve, monitorimi dhe sigurimi i uniformitetit në praktikat administrative;
- * Numri i rasteve dhe reduktimi i lëndëve të grumbulluara (rregullat e miratuara, qasjet praktike, dhe planifikimi i ndryshimeve dhe riorganizimit).

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë konceptin dhe rëndësinë e menaxhimit të rasteve;
- * Njohin rrjedhën e menaxhimit të lëndës;
- * Zbatojnë një menaxhim të mirë në praktikë gjatë punës së tyre.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Administratorët, ndihmës administratorët, dhe shefat e shkrimoreve të gjykatave dhe prokurorive.

112. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor

Shkrimi dhe arsyetimi i drejtë ligjor është i rëndësishëm për punën cilësore të stafit përgjegjës për hartimin e akteve të ndryshme në gjykata dhe prokurori, sigurimin e qasjes dhe standardeve uniforme për hartimin e të gjitha llojeve të akteve dhe dokumenteve të lëshuara nga gjykatat dhe prokuroritë dhe shtimin e njohurive dhe aftësive praktike për aplikimin e gramatikës së duhur dhe stilit të të shkruarit në hartimin e dokumenteve dhe akteve tjera në gjykata dhe prokurori.

Si të zbatohet metoda IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore? Cilat janë sfidat në aplikimin e kësaj metode? Sa ndikon aplikimi i kësaj metode në unifikimin e metodologjisë në hartimin e vendimeve gjyqësore?

Në trajnim do të jepen udhëzimet teorike dhe praktike në hartimin e vendimeve gjyqësore sipas metodës IRAC.

Përmbajtja

- * Llojet e akteve, dokumenteve dhe kumtesave të gjykatave/prokurorive;
- * Hyrje në kuadrin ligjor që rregullon formën dhe përmbajtjen e akteve të gjykatave dhe procedurat për elaborimin e tyre;
- * Standardet, format dhe procedurat e zbatueshme - analiza e mangësive;
- * Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të pjesëtarëve të administratës (sekretaret, regjistruarit etj.) që merren me lëndët civile dhe penale;
- * Puna me lëndë, mbajtjen e shënimeve, rrjedhën e komunikimit dhe raportimin;
- * Përdorimi i gjuhës së saktë dhe standardit të korrespondencës zyrtarë.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Analizojnë rregullat bazë për shkrimin e akteve dhe dokumenteve ligjore;
- * Avancojnë shkathhtësitë për arsyetimin e akteve dhe dokumenteve ligjore;
- * Hartojnë drejtë aktet ligjore dhe ti arsyetojnë sipas metodave me bashkëkohore të arsyetimit dhe shkrimit ligjor;
- * Zhvillojnë mendimin kritik;
- * Demonstrojnë aftësitë hulumtuese për çështjet ligjore.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave dhe prokurorive.

113. Kursi hyrës

Stafi administrativ i posa emëruar në gjykata dhe prokurori është e nevojshme që të kenë njohuri për organizimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, e më këtë edhe rolin dhe përgjegjësitë e tyre në sistemin në të cilin punojnë.

Cila është struktura funksionale e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë? Cila është korniza ligjore që rregullon organizimin e këtij sistemi? Cilat janë kompetencat e KGJK dhe KPK?

Kursi hyrës ka për qëllim që të japë informacion të përgjithshëm në lidhje me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor, parimet dhe detyrat kryesore në kryerjen aktiviteteve administrative në kuadër të sistemit. Ai gjithashtu synon nxitjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga pjesëtarët e administratës për qytetarët e vendit.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Familjarizohen me sistemin gjyqësor e prokurorial të Kosovës;
- * Njoftohen me informacion të përgjithshëm në lidhje me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor e prokurorial;
- * Identifikojnë ndryshimet e fundit legjislative lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- * Zbërthejnë strukturën aktuale të gjykatave dhe prokurorive dhe kompetencat e tyre në Republikën e Kosovës;
- * Njohin më mirë rolin dhe kompetencat e KGJK dhe KPK.

Përmbajtja

Moduli I

Kohëzgjatja Pesë ditore

- * Hyrje në sistemin gjyqësor të Kosovës, parimet dhe rregulloret Kushtetuese (Kapitulli 7), legjislacioni dhe institucionet relevante (KGJK-ja, KPK-ja, gjykatat, prokuroritë, Ministria e Drejtësisë, IGJK-ja, shoqatat profesionale);
- * Shqyrtimi i shkurtër i reformës gjyqësore në aspektin historik dhe ndryshimet e fundit legjislative që kanë të bëjnë me strukturën dhe funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- * Hyrje në administratën gjyqësore, legjislacioni përkatës, funksionet dhe përgjegjësitë;
- * Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale;
- * Qasja në informacion, konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit të klasifikuar, si dhe mbrojtja e të dhënave;
- * Koncepti i “Shërbimeve të Orientuara në Cilësi” dhe në shërbim të qytetarëve;
- * Hyrje në planifikim, menaxhim, menaxhimin e kohës dhe stresit.

Moduli II

- * Hyrje në punën e gjykatave dhe prokurorive; struktura, organogramet, kategoritë e stafit administrativ dhe të drejtat e detyrimit e tyre;
- * Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe puna në ekip;
- * Rregullat kryesore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve (lëndëve);
- * Specifikat e punës në çështjet civile, çështjet penale dhe çështjet administrative - llojet e rasteve, aktet gjyqësore dhe seancat gjyqësore;
- * Procedurat gjyqësore dhe detyrat përkatëse të personelit administrativ, dërgimi i thirrjeve, afatet;
- * Prezantimi i llojeve të regjistrave dhe dokumenteve të mirëmbajtura nga stafi administrativ – rregullat dhe mostrat.

Kohëzgjatja



Tre ditore

Përfituesit



Pjesëtarët e sapo-emëruar të administratës së gjykatave/prokurorisë (stafi me më pak se gjashtë muaj përvojë).

114. Etika dhe sjellja profesionale

Qëllimi më i lartë i administratës gjyqësore në Kosovë, për të gjithë stafin që i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve etike të rëndësishme siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paaësia, konfidencialiteti, llogaridhënia.

Cilat janë standardet që i përcakton Kodi i Etikës? Si ndikon sjella e stafit administrativ në krijimin e besimit të publikut në institucione gjyqësore? Sa zbatohen rregullat etike në punën e përditshme të stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive?

Trajnimi është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale.

Përmbajtja

- * Hyrje në Kodin e Etikës;
- * Parimet kryesore në kryerjen e detyrave në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial (profesionalizmi, disiplina në punë, paaësia, konfidencialiteti, llogaridhënia);
- * Aspekte të konfliktit të interesit dhe të sjelljes jo të duhur personale.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Kuptojnë Kodin e Etikës dhe parimet e tij;
- * Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje etike;
- * Njohin llojet e shkeljeve etike të cilat janë të sanksionuara.

Kohëzgjatja



Një ditë

Përfituesit



Stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive.

115. Menaxhimi i stresit dhe kohës

Menaxhimi i kohës dhe i stresit është i një rëndësie të veçantë. Stresin munda ta menaxhojmë vetëm nëse jemi shpirtërisht dhe fizikisht në nivelet tona optimale të energjisë, përndryshe nuk do të jemi në gjendje nervozen dhe stresin ditor. Rritja e aftësive profesionale të pjesëtareve të administratës për menaxhim më të mirë të kohës, është një parakusht për funksionim me efikas dhe me efektiv të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Si të menaxhojmë mirë stresin dhe kohën? Cilat janë elementet që ndikojnë në rritjen e stresit? Cilat janë teknikat që ndihmojnë në menaxhimin e kohës dhe të stresit?

Ky program interaktiv u ofron stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive mundësinë për të identifikuar shkallën e stresit në jetën e tyre, përdorimin e metodave për reduktimin dhe kontrollimin e stresit të ndërlidhur me punën në kryerjen e detyrave të tyre.

Përmbajtja

- * Rregullat e aplikueshme në lidhje me orarin e punës dhe vijueshmërinë;
- * Përmirësimi i menaxhimit të kohës dhe të kryerjes së detyrave për çdo kategori të stafit administrativ;
- * Delegimi i detyrave, monitorimi dhe respektimi i afateve dhe vendosja e prioritetëve;
- * Matja e reagimit tuaj ndaj stresit;
- * Lodhja nga puna;
- * Zhvillimi i një jetese me mirëqenie;
- * Ushtrimet në zyre, teknikat e meditimit dhe relaksimit;
- * Menaxhimi i kohës.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin praktikat dhe mjetet që ndihmojnë në organizimin e mirë të orarit të punës;
- * Menaxhojnë situata specifike me të cilat ata përballen gjatë punës dhe jetës private;
- * Identifikojnë shenjat e ndryshme të stresit;
- * Aplikojnë teknikat që ndikojnë në reduktimin e stresit.

Kohëzgjatja



Një ditor

Përfituesit



Stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive.

Programi për trajnimin e trajnuesve

Trajnuesi gjyqësor duhet të ketë aftësitë e nevojshme didaktike dhe roli i tij gjatë trajnimit është ti përmirësojnë kapacitetet dhe ti ngritë njohuritë profesionale të pjesëmarrësve. Në varësi nga rrethanat, trajnuesi i mirë gjyqësor duhet të ketë njohuri të gjerë dhe përvojë në zbatimin e një shumëllojshmëri të nevojave bashkëkohore të trajnimit. Programi i Trajnimit për Trajnues përcakton objektiva të qarta dhe rolin e trajnimit në rritjen e efikasitetit të performancës së punonjësve gjyqësor. IGJK do të avancoj me tutje programin për trajnimin e trajnuesve, në drejtim të përmirësimit të metod-

ologjisë trajnuese dhe realizimit të trajnimeve sa më atraktive, praktike dhe efektive.

Qëllimi i programit për trajnimin e trajnuesve është që të ofroj baza teorike për punën që bëjnë trajnuesit dhe do t'u mundësojë atyre të reflektojnë tek pjesëmarrësit se si teoria mund ta frymëzojë praktikën e tyre dhe anasjelltas. Po ashtu programi synon që të zhvilloj edukimin e vazhdueshëm profesional të trajnueseve si dhe avancoj metodologjitë bashkëkohore trajnuese.

116. Struktura adekuate e trajnimit

Strukturë adekuate e trajnimit nënkuton hartim të detajuar të materialeve trajnuese, përcaktimin e saktë të objektivave trajnuese, si dhe hartimin e planit të zbatimit të trajnimit i cili përfshinë dinamikën e zhvillimit të trajnimit. Po ashtu rastet praktike dhe rastet studimore janë elemente me rëndësi që përdoren gjatë trajnimit, në mënyrë që të trajtohen dilemat aktuale nga praktika gjyqësore.

Cila është struktura adekuate për hartimin e materialit trajnues? Cilat janë kriteret për përcaktimin e objektivave të një trajnimit? Si menaxhohen grupet dhe diskutimet e pjesëmarrësve gjatë trajnimit?

Trajnimi do të ofroj teknikat e avancuara të trajnimit, me fokus qasja interaktive si dhe format për një strukturë adekuate të trajnimit.

Përmbajtja

- * Hartimi i materialit trajnues dhe shfrytëzimi i burimeve;
- * Përcaktimi i objektivave të trajnimit;
- * Plani i zbatimit të trajnimit (dinamika e prezantimeve);
- * Rastet praktike.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Zhvillojnë teknikat e mësimit për ofrimin e trajnimeve efektive dhe cilësore;
- * Hartojnë materialin trajnues dhe të caktojnë objektivat e trajnimit.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Trajnuesit e IGJK-së.

117. Avancimi i metodologjisë trajnuese

Teknikat e avancuara dhe bashkëkohore trajnuese janë të rëndësishme me qëllim të ngritjes së shkathtësive dhe aftësive profesionale të trajnuesve për ofrimin e trajnimeve cilësore dhe atraktive për pjesëmarrësit. Qasja interaktive e trajnuesve lejon që pjesëmarrësit të shfaqin nga këndvështrimi i tyre interesin për tema të caktuara të cilat paraqesin sfidat aktuale dhe nevojat për trajnim. IGJK në vazhdimësi i kushton vëmendje avancimit të metodologjisë trajnuese, si një ndër elementet kyçe në ofrimin e trajnimeve adekuate.

Cilat janë metodologjitë e avancuara të trajnimit? Sa janë të rëndësishme metodologjitë adekuate në arritjen e objektivave trajnues? Si të aplikohen drejtë teknikat e avancuar të trajnimit?

Trajnimi ka për qëllim avancimin e metodologjisë trajnuese, në një metodologji të avancuar që përmbushin standardet ndërkombëtare të aplikuara edhe në qendrat rajonale dhe ndërkombëtare të trajnimit gjyqësor.

Përmbajtja

- * Komunikimi jo verbal;
- * Arti i mësimdhënës (të folurit dhe toni i trajnuesit, përdorimi i humorit);
- * Përdorni i mjeteve vizuale;
- * Komunikimi efektiv;
- * Dëgjimi aktiv;
- * Udhëheqja e debateve dhe diskutimeve.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- * Njohin metodologjitë e avancuara të trajnimit;
- * Aplikojnë metodologjitë e avancuara të trajnimit.

Kohëzgjatja



Dy ditore

Përfituesit



Trajnuesit e IGJK-së.

Mësimi në distancë (E – learning)

Mësimi në distancë (e-learning) nënkupton të mësuarit nga distanca duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike, jashtë një salle tradicionale të trajnimit, të cilat ju ofrohen përfitueseve përmes: kurseve dhe moduleve trajnuese, incizimeve audio dhe videove. Përparësitë e aplikimit të kësaj forme të të mësuarit janë të shumta, duke kursyer në masë të madhe kohën dhe koston e rrugëtimit, si dhe orarin e përshtatshëm ku pjesëmarrësit në çdo kohë mund të ndjekin një trajnim të caktuar. Kjo metodologji trajnimit, e cila tani gjen zbatim të gjerë në institucionet trajnuese, do të përfshijë module trajnuese nga lëmi të ndryshme, të cilat do të jenë të disponueshme për përfituesit. Kohëzgjatja e një kursi trajnues është dy muaj për një grup, ndërsa përfitues janë të gjyqtarët,

prokurorët dhe stafi administrativë i gjykatave dhe prokurorive.

Qëllimi i kësaj platforme konsiston në ofrimin e mundësisë, që gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, në kohë të përshtatshme dhe të herëpashershme të vijojnë kurset trajnuese, me interes për ta, në mënyrë elektronike. Po ashtu, përmes kurseve trajnuese në këtë platformë, synohet zhvillimi i mëtejshëm profesional për të gjitha kategoritë përfituese të IGJK-së.

IGJK ka në funksion platformën e mësimin në distancë, e cila në një masë të madhe përbushë nevojat dhe kërkesat për trajnime.

Përmbajtja

Në kuadër të platformës së mësimin në distancë/ e-learning, gjatë vitit 2017 do të organizohen këto kurse trajnues:

- * Anglishtja ligjore;
- * Drejtësia për fëmijë;
- * Fazat e aktakuzës dhe deklarimit për fajësinë;
- * Kundërkorrupcioni;
- * Menaxhimi dhe udhëheqësia e gjykatave;
- * Menaxhim i stresit;
- * Teknologjia Informative;
- * Kontabiliteti për gjyqtarë në rastet e falimentimit.

Po ashtu në këtë periudhë do të zhvillohen edhe kurset trajnues si më poshtë:

- * Komunikimi;
- * Krimi Kibernetik;
- * E Drejta e Autorit.

PROGRAMI TRAJNIMIT TË VAZHDUESHËM	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
Shqyrtimi Fillestar, Shqyrtimi i Dytë dhe Shqyrtimi Gjyqësor	18						
Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës	20						
Mundësia hetuese e veçantë	25						
Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje	27						
Krimi i organizuar		1					
Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin		2					
Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë		3					
Risitë e Ligjit për Falimentimin		8					
Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës – Sesioni I		10,11					
Procedurat alternative (penale)		15					
Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje		16					
Hetimi i krimeve financiare		22					
Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror		24,25					
Kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës			1				
Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve			3				
Bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë			8				
Zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës			10				
Parashkrimi (penale)			15				
Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civilë të Republikës së Kosovës			17				
Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes			22				
Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale			24				
Shoqëritë tregtare			29				
Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovës			31				
Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit- Sesioni I			31	1			

PROGRAMI TRAJNIMIT TË VAZHDOESHËM	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme				5			
Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve				7			
Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale				12			
Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve				14			
Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale				19			
Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj				21			
Shqyrtimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturve				26			
Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për regjistrimin civil				28			
Krimet e luftës					3		
Renta, llojet dhe caktimi i saj					5		
Masat e Diversitetit					11		
Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetikë- Sesioni I							
Menaxhimi i stresit					17,18		
Terrorizmi					19		
Administrimi i provave - parimet udhëheqëse (kundervatjtje)					24		
Aktakuza					26		
Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës					31		
Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve						2	
Veprat penale sipas Kodit Doganor						7	
Pranueshmëria e kërkesës/ankesës në Dhomën e Posaçme						9	
Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së						14	
Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave- Sesioni I						16,17	
Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë						21	
Procedura për privatizimin e subjekteve nga AKP						23	
Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile						28	
Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor						29	
Palet dhe perfaqesimi i tyre në procedurë							5
Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrant							6,7



Formular për Aplikim në PTV

Janar - Korrik 2017

Emri dhe Mbiemri: _____

Gjykata/Prokuroria: _____

Departamenti: _____

Divizioni: _____

Tel: _____

e-mail: _____

<input type="checkbox"/>	Shqyrtimi Fillestar, Shqyrtimi i Dytë dhe Shqyrtimi Gjyqësor Data: 18/01/2017	<input type="checkbox"/>	Hetimi i krimeve financiare Data: 22/02/2017
<input type="checkbox"/>	Seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës Data: 20/01/2017	<input type="checkbox"/>	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror Data: 24-25/02/2017
<input type="checkbox"/>	Mundësia hetuese e veçantë Data: 25/01/2017	<input type="checkbox"/>	Kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Data: 01/03/2017
<input type="checkbox"/>	Kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit të ri për kundërvajtje Data: 27/01/2017	<input type="checkbox"/>	Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve Data: 03/03/2017
<input type="checkbox"/>	Krimi i organizuar Data: 01/02/2017	<input type="checkbox"/>	Bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrësit në procedurë Data: 08/03/2017
<input type="checkbox"/>	Mbrojtja dhe promovimi i diversitetit, tolerancës dhe barazisë në kontekst të legjislacionit mbi mos diskriminimin Data: 02/02/2017	<input type="checkbox"/>	Zbatimi i së drejtës evropiane nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës Data: 10/03/2017
<input type="checkbox"/>	Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë Data: 03/02/2017	<input type="checkbox"/>	Parashkrimi (penale) Data: 15/03/2017
<input type="checkbox"/>	Risitë e Ligjit për Falimentimin Data: 07-09/02/2017	<input type="checkbox"/>	Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës Data: 17/03/2017
<input type="checkbox"/>	Procedurat alternative (penale) Data: 15/02/2017	<input type="checkbox"/>	Mbrojtja gjyqësore në rastet e fyerjes dhe shpifjes Data: 22/03/2017
<input type="checkbox"/>	Mbrojtja gjyqësore në rastet e dhunës në familje Data: 16/02/2017	<input type="checkbox"/>	Cilësia dhe vlerësimi i provave në procedurë penale Data: 24/03/2017

<input type="checkbox"/>	Shoqëritë tregtare Data: 29/03/2017	<input type="checkbox"/>	Terrorizmi Data: 19/05/2017
<input type="checkbox"/>	Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sistemin kushtetues të Kosovës Data: 31/03/2017	<input type="checkbox"/>	Administrimi i provave - parimet udhëheqëse (kundërvajtje) Data: 24/05/2017
<input type="checkbox"/>	Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi dhe veprimtaria e rrezikshme Data: 05/04/2017	<input type="checkbox"/>	Aktakuza Data: 26/05/2017
<input type="checkbox"/>	Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve Data: 07/04/2017	<input type="checkbox"/>	Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 par. 8 i Kushtetutës së Kosovës Data: 31/05/2017
<input type="checkbox"/>	Të drejtat e të pandehurit nga ndalimi i parë deri në përfundim të procedurës penale Data: 12/04/2017	<input type="checkbox"/>	Kontrata për ndërtim dhe përgjegjësia e kontraktuesve Data: 02/06/2017
<input type="checkbox"/>	Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullorja për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve Data: 14/04/2017	<input type="checkbox"/>	Veprat penale sipas Kodit Doganor Data: 07/06/2017
<input type="checkbox"/>	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështjet penale Data: 19/04/2017	<input type="checkbox"/>	Pranueshmëria e kërkesës/ankesës në Dhomën e Posaçme Data: 09/06/2017
<input type="checkbox"/>	Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë dhe cenimi i saj Data: 21/04/2017	<input type="checkbox"/>	Aktgjykimi dhe llojet e tij sipas LPK-së Data: 14/06/2017
<input type="checkbox"/>	Shqyrtimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturve Data: 26/04/2017	<input type="checkbox"/>	Ngrirja e përkohshme asetëve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë Data: 21/06/2017
<input type="checkbox"/>	Regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi sipas Ligjit për regjistrimin civil Data: 28/04/2017	<input type="checkbox"/>	Procedura për privatizimin e subjekteve nga AKP Data: 23/06/2017
<input type="checkbox"/>	Krimet e luftës Data: 03/05/2017	<input type="checkbox"/>	Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile Data: 28/06/2017
<input type="checkbox"/>	Renta, llojet dhe caktimi i saj Data: 05/05/2017	<input type="checkbox"/>	Gjykimi i të miturve dhe madhorëve në një proces gjyqësor Data: 30/06/2017
<input type="checkbox"/>	Masat e Diversitetit Data: 11/05/2017	<input type="checkbox"/>	Palët dhe përfaqësimi i tyre në procedurë Data: 05/07/2017
<input type="checkbox"/>	Menaxhimi i stresit Data: 17-18/05/2017	<input type="checkbox"/>	Trafikimi me njerëz dhe kontrabandimi me migrant Data: 06-07/07/2017

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

<https://igjk.rks-gov.net>

infokji@rks-gov.net

Rr. "Muharrem Fejza" – Prishtinë

Tel: +381 38 200 18 662



Formular për Aplikim ne Programet e Specializuara

- Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës

Sesioni I - *Data:10-11/02/2017*

- Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën Kundër Korrupsionit

Sesioni I - *Data:31/03 – 01/04/2017*

- Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik

Sesioni I - *Data:12-13/05/2017*

- Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes e parave

Sesioni I - *Data:16-17/06/2017*

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

<https://igjk.rks-gov.net>

infokji@rks-gov.net

038 200 18 660

Adresa “Lagjja e Spitalit”

Rr. Muharrem Fejza p.n

Prishtinë, Republika e Kosovës